



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.02.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për pyetjen e dëshmitarëve:

1. Fareudin Arapi – Administrator i Shoqërisë “*Integrated Technology Service*”
2. Arjan Baçi – Administrator i Shoqërisë “*Albtech Energy*”
3. Z. Luigj Aleksi – Shoqata e ndërtuesve
4. Z. Jetmir Olldashi – Gazetar Boldnews.al
5. Znj. Aleksandra Bogdani – Gazetare Reporter.al
6. Z. Artan Rama – Gazetar investigative (free Lancer)
7. Z. Pëllumb Abeshi – Ish anëtar i Komisionit të Prokurimit, Inceneratorit të Elbasanit
8. Znj. Etleva Kondi - Ish anëtare e Komisionit të Prokurimit, Inceneratorit të Elbasanit
9. Znj. Ledia Karalliu - Ish anëtare e Komisionit të Prokurimit, Inceneratorit të Elbasanit
10. Z. Bardh Çapiri - Ish anëtar i Komisionit të Prokurimit, Inceneratorit të Elbasanit
11. Z. Serafin Papa - Ish anëtar i Komisionit të Prokurimit, Inceneratorit të Elbasanit

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi, Besion Ajazi, Etjen Xhafaj, Edmond Spaho, Dhurata Tyli (Çupi), Belind Këlliçi, Luçiano Boçi, Lefter Gështenja, Helidon Bushati dhe Denis Deliu.

Mungojnë:

Ermonela Valikaj (Felaj).

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Fillojmë mbledhjen e radhës së komisionit hetimor për inceneratorët për impiantet e trajtimit të mbetjeve.

Ditën e parë ne filluam me dëshmitarët dhe sot kemi dy zotërinj. Unë dua që të fillojmë me rendin e ditës.

Sot kemi thërritur zotin Fareudin Arapi dhe zotin Arjan Baçi, të cilët janë administratorë të shoqërive, përkatësisht “*Integrated Technology Service*” dhe “*Albtech Energy*”. Të dy zotërinjtë janë administratorë të këtyre shoqërive prej një muaji e gjysmë, që në momentin kur inceneratori i Elbasanit u vendos në sekuestro pas provimit të veprës penale të korrupsionit për zotin Lefter Koka, njëkohësisht edhe të veprës penale të korrupsionit për procedurat e koncesionit për inceneratorin e Elbasanit.

Përpara se të fillojmë, unë dua t’u kujtoj dy zotërinjve që, bazuar në rregulloren e brendshme të komisionit, neni nr. 18, dëshmia nga ju do të merret pasi ne të kryejmë betimin.

Neni 360 i Kodit të Procedurës Penale “Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit”. Ju lutem përsërisni pas meje!

“Betohet se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë. Betohem!”

Fareudin Arapi – Betohem!

Arjan Baçi – Betohem!

Jorida Tabaku – Të nderuar zotërinj, dua t’ju kujtoj se dëshmia e rreme konsiderohet një veprë penale dhe dënohet, sigurisht jo nga ky komision, por nga strukturat përkatëse ligjore deri në 6 vjet heqje lirie.

Pasi kemi përfunduar këtë procedurë të parë, dua të fillojmë pyetjet me zotërinjtë.

1. Kush ju ka emëruar në detyrën e administratorëve të këtyre dy kompanive?

Fareudin Arapi – Unë jam Fareudin Arapi, administrator i shoqërisë “*Integrated Technology Services*”, ose Studimet Teknologjike të Integruara. Jam emëruar me një vendim të gjykatës, konkretisht me vendimin nr. 448, datë 13.12.2021, prej asaj kohe deri më tash vazhdoj ta kryej këtë detyrë të administratorit të kësaj shoqërie në përputhje me ligjin themeltar nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurime të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit nëpërmjet masave parandaluese”.

Në funksion të këtyre, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të konfiskuara, personalisht unë bashkë me kolegun tim, kemi marrë përsipër të miradministrojmë me efikasitet dhe ekonomikitet pasuritë e zotërinjve, të cilët tashmë janë në ndjekje, Klodian

Zoto dhe Stela Gugallja, konkretisht “*Albtech Energy*” sh.p.k. dhe jemi në atë fazë kur pothuajse përfundimisht, pas informacioneve që u kemi dhënë institucioneve përkatëse të prokurorisë dhe gjykatës, i kemi marrë në administrim plotësisht të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, siç përcaktohet në vendimin e gjykatës dhe në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit. Jemi të gatshëm të vazhdojmë dhe t’u përgjigjemi pyetjeve konkrete që do të keni.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Arjan Baçi është administrator aktualisht i kompanisë “*Albtech Energy*”.

Arjan Baçi – Jam emëruar me vendimin nr. 484, datë 13.12.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Kemi bërë marrjen në dorëzim të shoqërisë “*Albtech*”, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe pasurive të tjera që ka, si licenca dhe leje, në datën 14 dhjetor 2021. Nga ajo kohë e tani po bëjmë administrimin e këtyre.

Jorida Tabaku – Për sqarimin e kolegëve, të dy administrojnë dy kompanitë, që ishin përfituese “*jonit venture*” e koncesionit të Elbasanit, kompanisë që zotërohej nga zoti Klodian Zoto, dhe kompanisë që zotërohej nga zonja Stela Gugallja. Tashmë kemi dy administratorë shtetërorë.

A i njihni shtetasit Mirel Mërtiri, Klodian Zoto, Stela Gugallja?

Fareudin Arapi – Personalisht jo dhe i kam dëgjuar për herë të parë pasi u njoha me vendimin e gjykatës.

Arjan Baçi – Jo, nuk i njoh personalisht.

Jorida Tabaku – Atëherë, që nga momenti kur keni marrë kompaninë në administrim, inceneratori a është në funksion? A e kryen procesin e incenerimit, domethënë të mbledhjes, diferencimit, riciklimit dhe incenerimit të plotë?

Arjan Baçi – Në momentin e marrjes në dorëzim të inceneratorit, inceneratori ka qenë në punë. Ka bërë edhe incenerimin e mbetjeve, ka bërë landfillimin e mbetjeve, të cilat nuk ishin për djegie. Ka një diferencë të prodhimit të energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e OSHEE-së. Energjia e prodhuar është diku te 13 milionë kilovat/orë, nga të cilat bëhet diferenca, sepse ka një moment që ky incenerator importon energji nga OSHEE-ja dhe pjesa tjetër shumicën e kohës eksporton energji. Diferenca është një bilanc pozitiv diku te 6 milionë e 700 mijë kilovat/orë.

Jorida Tabaku – Nga informacioni që unë mora, nga raporti i fundit i ERE-s, kompania nuk është e regjistruar dhe nuk është e licencuar nga ERE-ja.

Si administrohet importi dhe eksporti i energjisë konkretisht?

Arjan Baçi – Për licencimin ose jo të kompanisë, këtë nuk di ta them, por ERE-ja ka rënë dakord, domethënë nuk ka rënë dakord për të nxjerrë çmimin për kilovat/orë, sepse

pretendon se këto lloje impiantesh, kjo ka të drejtë për të nxjerrë çmimin më pak se 2 megavat, domethënë prodhimi i energjisë, kur është më pak se 2 megavat, atëherë këto janë subjekt i nxjerrjes së çmimit të blerjes nga ERE-ja.

Impianti i Elbasanit prodhon diku te 2,8 megavat/orë energji elektrike, prandaj kontrata e blerjes së energjisë elektrike ka ngelur pezull. Di të them se nga ana e “*Albtech*”-ut është kundërshtuar vendimi i ERE-s në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila i ka dhënë të drejtë shoqërisë “*Albtech*”, dhe ka kërkuar nga ERE-ja që të vendosë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga inceneratori i Elbasanit.

Çështja është në Gjykatën e Apelit.

Jorida Tabaku – Kjo çështje që ju ngritët është shumë e rëndësishme, ndoshta është teknike për disa kolegë, por është shumë e rëndësishme, sepse që në kontratën e hartuar ka pasur një vlerë abuzive të përcaktimit të çmimit. ERE-ja nuk është përfshirë në vendosjen e çmimit të energjisë elektrike dhe ka pasur mosmarrëveshje në momentin kur ka dashur që të licencohet. Kështu që biem të gjithë dakord që procesi i shitjes së energjisë, megjithëse impianti ka përfunduar, nuk po realizohet si rezultat i një mosmarrëveshjeje që sot është në gjykatë, thoni ju.

Arjan Baçi – Po.

Jorida Tabaku – Në bilancet që unë kam marrë në Qendrën Kombëtare të Biznesit për kompaninë (ju besoj e keni parë shëndetin financiar të kompanisë gjatë këtyre dy muajve, keni pasur mundësi t’i shikoni shifrat), kompania ka deklaruar fitim dhe ka bërë një shpërndarje dividenti prej pothuajse 2 milionë eurosh vitin e fundit, ndërkohë që në pasqyrat financiare ka akoma shpenzime të mbartura, janë shpenzime të pakryera akoma, ndërkohë që ka shpërndarë fitimet pa u mbyllur bilancet dhe i kryer të gjitha këto shpenzime, pa i realizuar këto shpenzime. Si e keni konstatuar këtë fakt?

Pyetja është për “*Albtech Energy*”.

Arjan Baçi – Nga të dhënat financiare, që kemi marrë nga zyra e kontabilitetit, e cila ka mbajtur të dhënat financiare deri në këto momente, rezulton që shoqëria “*Albtech Energy*” ka mjete financiare të pakonsiderueshme, gati-gati në zero. Deri tani edhe shërbimet e incenerimit dhe landfillimit të mbetjeve janë bërë nga të ardhurat që ka pasur kompania “*Albtech*” deri në këto momente.

Për bilancin e vitit 2020 nuk di të them, sepse kjo nuk është pjesë e veprimtarisë së administratorit, sepse ne fillojmë punë nga momenti i marrjes në dorëzim dhe këndeje dhe nuk di të them se sa është dividenti i shpërndarë nga kompania.

Jorida Tabaku – Që ta kuptoj qartë, ju po thoni se në momentin që e keni marrë në administrim, ato i kanë zbrazur arkat, kanë pasur bosh çdolloj gjëje dhe ju po punoni me të ardhurat që gjenerohen nga mbetjet në këtë moment?

Arjan Baçi – Në momentin e marrjes në dorëzim të ardhurat, ka disa llogari bankare, po them se janë diku te 5 mijë euro maksimumi.

Jorida Tabaku – Domethënë, ata që janë sot në kërkim, kanë zbrazur llogaritë bankare e pastaj janë larguar.

Po nga analiza e bilanceve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta përfundoj pyetjen e pastaj do ta marrë fjalën zoti Arapi.

Po nga analiza e bilanceve të deklaruara nga kompania në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2020, janë deklaruar të ardhura në vlerën e pothuajse 40 milionë eurove. Kontrata koncesionare është në një vlerë më të vogël, në vlerën e 24 milionë eurove. Nga mendoni se kanë ardhur këto pagesa shtesë mbi vlerën e kontratës koncesionare?

Farudin Arapi – Mendoj se kjo është pjesë e hetimit që po bëhet nga SPAK-u. Unë nuk jam në gjendje të them diçka në lidhje me këtë. Nuk e di.

Jorida Tabaku – Si ekspert, që tani e keni nën administrim kompaninë, nuk mund të gjykoni?

Farudin Arapi – Edhe një herë: ligji “Për administrimin e pasurive” hyn në lojë në çastin kur vjen vendimi i gjykatës, në çastin kur bëhet sekuestrimi i pasurive. Me këto të dhëna që ne kemi në momentin e marrjes në dorëzim, me këto të dhëna vazhdojmë edhe administrimin e këtyre pasurive. Për pjesën e kaluar nuk di të them se si ka operuar Albtech Energy.

Jorida Tabaku – Ma ka kërkuar fjalën zoti Boçi... Kërkoj ndjesë, zoti Pëllumbi në fillim e më pas zoti Boçi.

Arben Pëllumbi – Falemnderit, kryetare!

Në fakt, unë vazhdoj të ngul këmbë se ne, si komision hetimor, jemi këtu për të shqyrtuar procedurat dhe nëse ato kontrata që kanë lidhur institucionet e këtij shteti me koncesionarët, janë zbatuar apo jo. Se si i ka bilancet kompania, besoj se kjo nuk është detyra jonë, por e organeve të tjera, që t'i hetojnë nëse janë me fitim, kanë ndarë dividend apo nuk kanë ndarë.

Gjithsesi, meqenëse e mora fjalën, po bëj edhe unë disa pyetje.

Në momentin që ju u caktuat nga gjykata për të vajtur në impiantin e trajtimit të integruar të mbetjeve në Elbasan, si e gjetët kompaninë? Funkciononte, punonte, i punonin të gjithë elementët, të gjitha hallkat, apo kishte diçka që nuk ishte në funksion?

Faraudin Arapi – Në momentin që u bë marrja nën administrim, gjithë impianti i përpunimit të mbetjeve ishte funksional dhe në rregull. Bëhet incenerimi, bëhet prodhimi i energjisë elektrike. Në fillim, në momente të caktuara, ka qenë në rregull.

Arben Pëllumbi – A vazhdon të prodhojë edhe sot energji elektrike impianti i përpunimit të mbetjeve në Elbasan?

Faraudin Arapi – Në momentin që flasim, nga impianti bëhet landfillimi i mbetjeve, sepse, siç thashë, gjendja financiare e shoqërisë Albtech ishte zero, ndaj për të mbajtur në punë inceneratorin kanë filluar procedurat dhe po ndërmerren të gjitha hapat konkretë që duhen bërë, për të vazhduar punën me djegien e plehrave dhe me prodhimin e energjisë elektrike.

Arben Pëllumbi – Ju përmendët shifrën 13 milionë kv/orë ose 13 mijë megavat, por që është hedhur në rrjet. A është thithur kjo nga OSHEE-ja, pra a është përdorur kjo energji elektrike?

Faraudin Arapi – Po, është përdorur. Edhe sipas kontratës koncesionare, aty është një pikë lidhjeje, e cila injekton gjithë prodhimin e energjisë elektrike në rrjetet e OSHEE-së. Ka matës, të cilët matin edhe prodhimin e energjisë elektrike, edhe shpenzimin, domethënë importin e eksportin, që ka në këtë incenerator, në këtë impiant.

Arben Pëllumbi – Pra, matësi me dy drejtime, qoftë në dhënie, qoftë në marrje, funksionon, ka pas funksionuar? Ose më saktë: ka pas funksionuar edhe përpara se të shkonit ju aty? Si e gjetët ju në atë moment dhe si është sot?

Faraudin Arapi – Po, matësi ka funksionuar. Është një matës, i cili funksionon.

Arben Pëllumbi – Sipas mendimit tuaj, në rast se nuk do të kishim këtë vendim gjyqate, a ishte gati kompania për t'iu dorëzuar bashkisë së Elbasanit, e cila ndërkohë duhej ta merrte në dorëzim?

Faraudin Arapi – Mendoj se po. Bashkia e qarkut të Elbasanit kanë krijuar një shoqëri, e cila ishte përcaktuar për të bërë marrjen në administrim të këtij impianti.

Arben Pëllumbi – Në rast se kompania do t'i ishte dorëzuar bashkisë së Elbasanit, a do të kishte ndonjë rëndësi për ne se sa të ardhura kishte në llogarinë e vet në momentin kur dorëzohet? Si mendoni? Meqenëse u pyetët se sa lekë gjetët kur vajtët ju. Në rast se do t'i ishte dorëzuar bashkisë së Elbasanit, mendoni se do të kishte ndonjë interes për ne fakti se sa lekë kishte kompania në llogari?

Faraudin Arapi – Jo, s'e besoj. Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Po pra, por ajo kompani ishte bërë gati për t'u dorëzuar. Llogaritë mund t'i kishte zero, mund t'i kishte plus, mund t'i kishte edhe minus, se ishin të vetat. E kuptoni? Kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë po i bëj pyetjet në vijimin tuaj.

Jorida Tabaku – Ta përfundojë zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Edhe një herë, ju lutem, sepse dy gjëra kanë qenë të rëndësishme në diskutimet tona në lidhje me impiantin e përpunimit të integruar të mbetjeve në Elbasan. A ishte funksional i gjithi? A prodhonte energji elektrike? Pra, a hidhte në rrjet energji elektrike?

Farudin Arapi – Po, ishte funksional dhe prodhonte energji elektrike në momentin e marrjes në dorëzim.

Arben Pëllumbi – Falemnderit! Këto kisha.

Jorida Tabaku – Tani, meqenëse duhet t’i bëjmë pyetjet edhe një herë: a shitej energjia elektrike? Sepse qëllimi është që energjia elektrike të shitet. A ishte funksional? Se mund të prodhojmë energji elektrike edhe me një pajisje të thjeshtë. Për qëllimin e kontratës koncesionare, a shitet sot energjia elektrike? A zbatohet neni i kontratës, që unë e kam këtu përpara, në lidhje me shitjen e energjisë elektrike përpara se të merrej në dorëzim nga shoqëria që administron bashkitë e qarkut Elbasan?

Farudin Arapi – Albtech nuk ka pasur arkëtime nga shitja e energjisë elektrike, por prodhimi i energjisë elektrike është bërë.

Jorida Tabaku – E ka fjalën zoti Boçi dhe pastaj...

Helidon Bushati – Vetëm një pyetje kam. Vetëm një moment.

Jorida Tabaku – në rregull!

Helidon Bushati – Shumë e drejtë. A keni ju një dokument, që jua njeh OSHEE-ja si vlerë të marrë të energjisë elektrike, e që do t’jua njohë në kuadër të *right off-eve* ndryshme?

Farudin Arapi – Ne si Albtech kemi prodhimin e energjisë elektrike. Si vlerë, nuk kemi.

Helidon Bushati – Zotëri, të lutem, kur prodhon, në biznesplan parashikohet se nga shitja e energjisë elektrike arkëtohen të ardhura. Apo jo? Ju thoni se nga OSHEE-ja, për sa kohë që jeni ju, nuk keni arkëtuar gjë. Dakord? Shpeshherë, kur një kompani ka probleme likuiditetesh, ta një këtë vlerë. A ta ka njohur me ndonjë dokument vlerën që ti ke hedhur në rrjet?

Farudin Arapi – Midis shoqërisë Albtech Energy dhe OSHEE-së është një korrespondencë, që unë kam gjetur, një korrespondencë, që e njeh si prodhim që e ka marrë nga Albtek, por nuk është në gjendje të lidhë kontratë, pasi nuk ka çmimin, pra s’ka një nga pikat kryesore të kontratës, çmimin.

Helidon Bushati – E kupton mirë pyetjen, por s’ka problem. Unë ia bëj prapë, në forma të ndryshme, që ai të jetë prapë aty ku do.

Arsyeja e pyetjeve është për të treguar se kjo energji e prodhuar, sepse pa dyshim që është prodhuar energji, nga djegia prodhohet energji edhe po s' deshe ti, se prodhohet vetvetiu, është proces. Nuk ka nga shkon pa prodhuar energji. Kjo energji, që është hedhur në rrjet, a ju është njohur?

Faradin Arapi – A të bëj një sqarim shtesë, meqenëse mbuloj pothuajse gjithë pjesën e inceneratorëve, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë?

Në lidhje me pyetjen e parë, se përse ka një tejkalim të vlerës, shoqëria Albtech ka kredi sovrane për pagat, të cilën ende nuk e ka likuiduar. Studio kontabël, që unë kam nën administrim, në tabelat e saj ka një rritje vlerore mbi vlerën e projektit të kredisë sovrane prej 871 mijë e 910 lekë. E para.

Problemi i dytë, që mendoj se është themeltar, është se shoqëria Albtech, nëse do të ishte realizuar edhe me çmimin e energjisë elektrike prej 8, 5 lekësh kilovat/orë dhe jo 12 lekë kilovat/orë, që është energjia e rinovueshme e pretenduar nga Albtech sh. p. k, dhe kështu ka qenë: të gjithë inceneratorët që prodhojnë energji elektrike nga djegia në impiantet e përpunimit, marrin një vlerë me 12 lekë kilovat/orë. Kjo jo vetëm do të përballonte gjithçka, edhe shpenzimet, por sot duhej të ishte me fitim. Por edhe me energjinë elektrike prej 8, 3 lekë kilovat/orë, do të përballonte shpenzimet dhe do të dilte rentabël. Kostoja e mbulimit të disa lloj shpenzimeve është tepër minimale, nga momenti i marrjes sonë nën administrim.

Po e bëj këtë sqarim, ngaqë i disponoj pasqyrat financiare, jam pjesë e kontrollit dhe e auditimit që po vazhdojmë të bëjmë, dhe mendoj se Albtech i ka mundësitë shumë shpejt, siç e shpjegoi edhe kolegu, që nëpërmjet masave që kemi marrë, të fillojmë vënien në punë dhe prodhimin e energjisë elektrike, pavarësisht se ERE nuk e ka miratuar çmimin. Pra, nuk është defekti i punës së shoqërisë koncesionare, por është defekti i vetë ERE-s, që ende s'po merr një vendim. Duhet ta ndajë ose si energji të zakonshme, ose si energji të rinovueshme.

Jorida Tabaku – Po.

Zoti Arapi, unë të falënderoj, sepse ngritët dy çështje shumë të rëndësishme, për të cilat kam pyetje. Kompania koncesionare, që ta kuptojnë edhe qytetarët, e koncesionit të Elbasanit ka marr kredi me garanci sovrane gjatë kohës së pandemisë për pagat. Ky është një element shumë i rëndësishëm. Kur të gjitha bizneset ishin mbyllur dhe kur inceneratori i Elbasanit merrte pagesa nga shteti, kompania ka marrë garanci sovrane për të paguar pagat, ndërkohë që ky ishte një proces që nuk kishte lidhje me pandeminë, sepse biznesi vazhdonte, dhe unë ju falënderoj që ju e ngritët këtë shqetësim e kam këtu si pikë.

Elementi i dytë, që ngriti zoti Arapi, që është shumë i rëndësishëm, është mosdakordësia për çmimin e energjisë 8,3 apo 12,5. Për qytetarët që na dëgjojnë, ta kuptojnë se ku është ndryshimi: gjatë miratimit të kontratës koncesionare për Elbasanin nuk është marrë

miratimi i ERE-s për çmimin e energjisë. Kushdo ministër Infrastruktura dhe Energjie, që e ka dhënë lejen për impiantin e energjisë, pa marrë miratimin e ERE-s, ka kryer një shkelje. Për këtë arsye sot ERE-ja nuk bie dakord, sepse kjo kontratë koncensionare që kemi këtu në procedurë të saj duhet të merrte edhe miratimin tek ERE për shitjen e energjisë. Në fakt, ju ngritët dy elemente shumë të rëndësishme, në fakt, që unë i kisha pjesë edhe të pyetjeve të mia.

Farudin Arapi – Për të mos e keqinterpretuar dhe për ta sqaruar, edhe me çmimin e energjisë prej 8,3 lekësh kilovat/orë “Albtech”-u është shoqëri fitimprurëse me energjinë elektrike të prodhuar në gjendje, ne detyrimet...

Jorida Tabaku – Nuk po e diskutoj fare këtë pjesë është apo jo, po diskutoj nëse procedura është korruptive apo jo.

Farudin Arapi – Ne jemi ekonomistë dhe e kuptojmë njëri-tjetrin. Energjia elektrike, me arkëtimin edhe të asaj vlere, e njohur nga Enti Rregullator i Energjisë... Por, nëse pretendojmë ne për të marrë një vlerë më të madhe, edhe me atë vlerë 500 mijë apo 600 mijë euro, përballon nevojat; sikur të mos kryejë fare veprime të tjera të shitjes së produkteve të riciklueshme të përballojë për rreth 6-7 muaj të tjerë funksionimin normal të impiantit dhe të prodhimit të energjisë elektrike.

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zonja Denaj për procedurë dhe më pas zoti Boçi.

Anila Denaj – Kam dy komente.

Së pari, garancie sovrane zonja Tabaku, ajo e para dhe e dyta, nuk i kanë limituar në asnjë moment bizneset në raport me bankat. E gjithë vendimmarrja është te bankat për të gjykuar riskun financiar nëse do të japin apo jo garanci. Pikërisht, sepse për çdo kompani që ka qoftë edhe një punonjës, dhe unë besoj se keni pasur më shumë se një punonjës në kohën e pandemisë, përgjegjësia e qeverisë shqiptare në momentin e aprovimit të garancisë sovrane ka qenë që asnjë punonjës të mos jetë i ekspozuar drejt të pamundësisë për t’u paguar nga çdo kompani, përfshirë edhe nga një kompani private si në rastin konkret, dhe për këtë arsye nuk e ka limituar për asnjë kompani, me përjashtim të atyre që morën pagat dhe ishin bizneset e vogla dhe unë besoj se ju nuk jeni biznes i vogël.

Zonja Tabaku, që të abuzosh këtu për garancinë sovrane, nuk është pasaktësi nga ana juaj, por besoj se është një mënyre për të defokusuar vëmendjen e opinionit publik, por edhe të komisionit.

Së dyti, në mbështetje të kolegut tim, zotit Pëllumbi, dua të rikujtoj se ky komision hetimor është i fokusuar për kontrollin e ligjshmërisë së monitorimeve dhe veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mjeteve urbane. Meqenëse koha në dispozicion për çdo dëshmitar besoj se është e kufizuar,

sepse kemi shumë sot, nuk kemi vetëm dy, duhet që pyetjet t'i lidhim me këtë objekt veprimtarie dhe të mos dalim jashtë rregullores që ky komision hetimor ka aprovuar.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zonja Denaj!

Sigurisht, dha një sqarim për fondin e garancisë, që nuk është miratuar nga qeveria, por është miratuar nga bankat e nivelit të dytë. Biem shumë dakord.

(Diskutim pa mikrofon.)

Është zbatuar nga bankat e nivelit të dytë dhe ka përfituar edhe kompania koncensionare. Shqetësimi që unë ngrita këtu, është, kur bizneset e vogla masivisht u mbyllën dhe morën 25 mijë lekë, janë paguar paga me 4 mijë euro për koncensionarin e Elbasanit me garanci sovrane.

Anila Denaj – Ju lutem, mos bëni politikë! Përdorët termin e garancisë sovrane si një term abuziv.

(Diskutim pa mikrofon.)

Arben Pëllumbi – Zonja Tabaku, ju donit që impianti të mbyllej dhe Elbasani të vazhdonte përsëri të qelbej nga e para? Ky ishte qëllimi juaj?

(Diskutim pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Meqenëse jemi tek energjia, në fakt këtu doja të fokusohesha në fillim të pyetjeve të mia, por disa çështje dolën. Pra, tek e fundit, nuk shisni energji. Nuk po e bëj pyetje, po e pohoj, dhe kërkoj pohimin tuaj, aktualisht nuk shisni energji?

Arjan Baçi – Prodhojmë energji, por nuk ka një kontratë shitjeje.

Luçiano Boçi – Edhe zoti Arapi e përcaktoi shumë mirë që në kontratën e koncesionit përcaktohej se inceneratori i Elbasanit ishte me kompensim, çka do të thoshte se gjatë viteve ai do të nxirrte vlerën e tij nëpërmjet prodhimit të energjisë elektrike, sepse ishte qëllimi fundor i inceneratorit. Madje ky është qëllimi që u miratua; u pa gjoja si risi. Kjo do të thotë që ky incenerator ka 4 vjet, në mos 5 vjet, që nga viti 2017 që del me humbje. Kush i paguan këto humbje, sepse arkën ju e keni gjetur bosh? Pra, kompensohen nga çmimi për ton mbetje, sepse kompania ka një bilanc, si mund të dalë 4 vjet me humbje?

Arjan Baçi – E thashë edhe pak më parë, ne nuk kemi bërë një auditim të bilancit. Kjo pjesë është pjesë e prokurorisë dhe SPAK-ut. Ne fillojmë që nga momenti i marrjes në dorëzim; nga momenti i marrjes në dorëzim edhe sot mund pyesni për çfarë të doni dhe do t'ju përgjigjemi, kurse për pjesën e kaluar...

Luçiano Boçi – Sa është sasia e mbetjeve që përpunon aktualisht, sepse ju jeni administrator në inceneratorin e Elbasanit?

Arjan Baçi – Në impiantin e grumbullimit të mbetjeve në Elbasan sasia e mbetjeve varion nga dita në ditë, por me një mesatare sot që flasim shkon në 110- 120 tonë në ditë.

Luçiano Boçi – Përafërsisht 110-120 tonë është diferencë shumë e madhe. Nuk është përafërsisht. Është me distancë shumë të madhe dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

10 tonë në ditë mua më duket vlerë e madhe, sepse është administrator dhe i di vlerat. Nuk po pyes një njeri që punon në një punë tjetër. Sa është sasia e energjisë që prodhohet në muaj, sepse më dhatë një shifër 13 milionë kilovat/orë. Sa është sasia në një muaj, sepse ju keni 1 muaj?

Arjan Baçi – Nga momenti i marrjes në dorëzim dhe sot në impiantin mbetjeve në Elbasan përpunohen mbetjet vetëm duke u landfilluar, sepse të ardhurat janë zero. Bashkitë e qarkut të Elbasanit i landfillojnë mbetjet pa kosto, me kosto zero.

Luçiano Boçi – Nuk japin asnjë lekë bashkitë që depozitojnë mbetjet? Nuk sjellin fare, nuk dorëzojnë asnjë lekë, i bëjnë falas?! Pra, kostot kush i paguan?

Arjan Baçi – Deri tani kostot e bashkive të qarkut të Elbasanit për landfillin e mbetjeve kanë qenë zero. Nuk e di si u kuptua, por ...

Luçiano Boçi – Duke qenë se kostot janë zero, pse tri bashkitë e tjera të qarkut të Elbasanit nuk pranojnë t'i sjellin mbeturinat në landfill dhe në incenerator?

Arjan Baçi – Nuk e di pse nuk pranojnë.

Luçiano Boçi – Bashkitë kanë deklaruar që nuk i përballojnë dot kostot financiare, ndërkohë ju thoni ato nuk kanë kosto financiare. Kështu që nuk ka përputhje midis deklaratës suaj dhe deklaratës së bashkive.

Arjan Baçi – Di të them se landfilli deri tani dhe incenerimi deri në periudhën, kur ne e kemi marrë në dorëzim nga bashkitë e qarkut Elbasan kostoja ka qenë zero. Këtë di them nuk di, gjë tjetër nuk e kam idenë.

Luçiano Boçi – Atëherë, në qoftë se do të ishte zero, edhe bashkitë e tjera do të kishin dëshirë t'i depozitonin në inceneratorët e Elbasanit. Gjithsesi, kam një pyetje në lidhje, sepse nuk doja të shfokusoheja nga çështja e energjisë, ne kur shkuam si grup vizitorësh, zoti Pëllumbi, dhe na u dëshmuua (ju ishit prezentë aty) që këtu prodhohej energji. Ndërkohë, unë marr përgjigje që nuk prodhohet energji. Pra, kemi dy realitete të ndryshme: përgjigjen e administratorit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, është ndërprerë, vetëm të landfillohet; landifillohet do të thotë që nuk incenerohet. Tani unë shqipen e di shumë mirë. Zotëria tha landfillohet, apo jo, zoti Arapi? Pra, nuk incenerohet.

Jorida Tabaku – Ju lutem, a mund të na i konfirmoni me mikrofon që nuk incenerohet, por landfillohet që ta dëgjojmë të gjithë?

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Kur nuk incenerohet, nuk prodhohet energji. Ne shkuam atje, pamë dhe na u dëshmuua se prodhohet energji. Tani ja ku është administratori që thotë vetëm landifillohet.

Faraudin Arapi – Një sqarim shtesë, realisht në momentin që ne në datën 13 morëm në administrim pothuajse të gjitha pasuritë e inceneratorëve, ato që janë përfshirë në vendimin e gjykatës, edhe për inceneratorin e Elbasanit ne kemi lejuar dhe kemi vazhduar deri në datën para se të dorëzohej, diferenca 3 ditore midis vendimit të gjykatës dhe datës 16 dhjetor që ky incenerator duhet t'i ishte dorëzuar Bashkisë së Elbasanit. Kjo diferencë kohore bëri që ne, si Agjenci e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të marrim disa veprime konkrete, të shikojmë mundësinë për të mos krijuar boshllëqe për shkak të gjendjes financiare të rënduar që kishte situata. Realisht, për shkak të mungesës së financimit, edhe me 8,3 lekë kilovatin, që ne diskutuam, vazhdimësia e inceneratorit për të rigjeneruar energjinë elektrike nga djegia e mbeturinave bëri të mundur që ne t'i japim një hapësirë, për të mos krijuar problematikë në qytet.

Në dijeninë time, kam qenë edhe dje, janë lidhur kontratat nga të gjitha bashkitë, me kostot përkatëse, të cilat depozitohen në landfill dhe, shumë shpejt, mendojmë brenda 2-3 ditësh ose nga fundi i javës, inceneratori do të vihet në punë dhe do të fillojë të prodhojë energjinë elektrike. Ky është konkluzioni ynë përfundimtar.

Luçiano Boçi - Pra, e gjitha vizitë jonë ishte false, sepse para kamerave u dëshmuua që inceneratori punon, sepse u parapërgatit vizita, ndërsa sot, ju falënderoj për përgjigjen, sepse është e sinqertë, nuk incenerohet.

Ndërkohë, në fjalën tuaj ma vrau veshin një pjesë e fjalisë: “Për të mos shqetësuar banorët e qytetit të Elbasanit” (po e perifrazoj , sepse nuk është fjalë për fjalë). Incenerimi i shqetëson banorët e Elbasanit?

Faraudin Arapi - Ndoshta u keqkuptuam, por shpjegimi im ishte që për ta vënë inceneratorin në punë, të cilin ne, duke mos pasur sasi vlerore të mjaftueshme për të siguruar lëndën e parë, siç është karburanti, gëlqerja e të tjerë, nuk po hyj në elemente përkatës të saj, menduam se ishte më e dobishme të mbahej në gjendje pune, pra i ndezur, por jo funksional dhe, realisht, i ndezur, me grupin që ka ITS-ja, pra institucioni ku unë jam administrator, kam lënë të gjithë kuadrin e nevojshëm, inxhinierë e teknikë, në dispozicion të inceneratorit të Elbasanit, në mënyrë që të mos krijohet shkëputje deri në momentin e transferimit. Ky grup e mban të hapur, por për sa kohë duhet të arkëtojnë këto vlera, për të cilat i kemi kërkuar Bashkisë

Elbasanit, që, nëse ka 80 tonë, kundrejt vlerës dhe kostos për ton që është miratuar, t'i dorëzojë dhe ne të fillojmë urgjentisht kalimin e mbetjeve jo më në landfill, por drejtpërsëdrejti në seleksionim dhe në incenerator, për të përpunuar edhe energjinë elektrike.

Faleminderit!

Luçiano Boçi- Lidhur me çështjen e energjisë, me mosfutjen në rrjet dhe të shitjes së energjisë. Në kontratën koncesionare, në pikën 5.4.4 përcaktohen detyrimet e autoritetit kontraktor, ku, midis të tjerave, theksohet shumë qartë, sepse ka 4 vjet kjo histori, që autoriteti kontraktor të garantojë detyrimet e tij, koncesionari, nëse kërkohet nga ky i fundit, detyrimin e subjektit të furnizimit me energji elektrike për të blerë energjinë e prodhuar nga këto impiante.

Pra, autoriteti kontraktor, që është Ministria e Mjedisit, në bazë të kërkesës që ju i paraqisni, "Albtek" dhe ITS, do të merrte të gjitha masat që ju të hynit nën regjimin e shitjes së energjisë. Ka katër vjet, pse nuk është bërë kjo? Si mendoni, sepse ju një muaj keni? A keni parë shkresa të kërkesës së koncesionarit drejtuar autoritetit, sepse duhet ta kishte përmbushur, pasi kontrata quhej e përfunduar në datën 16.02? Në qoftë se kontrata nuk ishte përmbushur në pikat e saj, atëherë, ka penalitete, sepse parashikon edhe penalitete. Ju, si mendoni, a janë bërë këto kërkesa, sepse ne gjendemi në një situatë absurde tani?

Arjan Baçi - Ka një korrespondencë të gjerë midis "Albtek", ministrive, Entit Rregullator të Energjisë Elektrike dhe OSHEE-së, ku kërkojnë nxjerrjen e çmimit për blerjen e energjisë elektrike, por pretendimet e ERE-s, siç e thashë pak më parë, sepse ne nxjerrim çmimin për energji elektrike për impiante më pak se dy mega...

Luçiano Boçi - Nuk hyra në detaje. Ju, si shoqëri, keni kontratë me Ministrinë e Mjedisit, ia lini topin në derë asaj dhe i thoni: "O vëlla, në kontratë e keni të përcaktuar, interesohu ti që unë të shes energjinë", sepse është interesi i shtetit që e ndërtoi, është me kompensim. Ne po shmangim detyrimin, lekët janë marrë nga buxheti i shtetit dhe do të gjejnë mënyrën për t'i kthyer, si mundet që shteti të mos angazhohet që të vejë në punë shtetin? Nuk shkon kjo. 4 vjet, unë nuk e marr vesh. Atëherë, të dalin këtu që shteti s'ka funksionuar për 4 vjet dhe që ministritë nuk kanë bërë detyrën e tyre. Thojini ju, nuk ka asgjë të keqe këtu. Prandaj, ne themi që procedura është korruptive, për këtë arsye.

Arjan Baçi - Ne kemi filluar punë më 14 dhjetor, edhe nga ana jonë i janë bërë shkresat OSHEE-së dhe ERE-s për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për impiantin e Elbasanit.

Luçiano Boçi - Ne jse, e kuptoj, por 4 vjet kjo nuk mund të zgjaste. Jorida i dha argumentimet, ndoshta edhe më të sakta nga ana teknike.

Te çështja e kontratës, zoti Arapi, doja ta bëja si pyetje, por ju e sqaruat. Për mua bënte jo çudi, por doja një përgjigje për arsyen pse inceneratori nuk kalon në pronësi të Bashkisë së

Elbasanit, pas vendimit të këshillit bashkiak të datës 16, sepse mbaronte edhe data e fundit e kontratës, por vazhdon të jetë me përfaqësues të kompanisë “Albtek” dhe ITS? Si administrator, a jeni në kontakte me palën e interesuar? Edhe një pyetje në vazhden e saj. A mendoni se është zbatuar kontrata, pasi në kontratë përcaktohej qartë që në përfundim inceneratori i dorëzohet autoritetit kontraktues, fillojnë bisedimet 6 muaj përpara (është në kontratë kjo) dhe i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit, jo Bashkisë Elbasan, pastaj negociohet me palë të tretë, por të gjitha asetet i merr Ministria e Mjedisit dhe më pas ia kalon autoritetit? Pra, 6 muaj, tashmë, duhet të kishte kaluar dhe data e vendimit bashkiak, e cila është marrë në konsideratë nga SPAK-u, nuk më duket e drejtë.

Farudin Arapi - Faleminderit!

Atëherë, bëj këtë sqarim. Certifikimi i punimeve në bazë të situacioneve të inceneratorit, së bashku me lanfillin në Elbasan, ka përfunduar brenda afateve kohore dhe unë i kam, pothuajse, të gjitha procesverbalet e kolaudimit dhe përfundimit të vlerës së plotë të investimit dhe të realizimit të projektit të kontaktuar, vlerë e cila, po përmend shumë, kap shumë në lekë 25 milionë. Edhe nga njësia e mbikëqyrjes, që është institucioni që certifikon përfundimisht dhe pastaj bën dorëzimin, midis “Albtek” dhe grupit që është monitoruesi dhe realizuesi, vlera është 25 milionë 993 mijë 200 lekë, e realizuar në përputhje me kontratën. Ky është certifikimi i dokumentacionit që ne kemi marrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U mbyll. Realisht, institucioni, Bashkia Elbasan, nëse do të dilte vendimi, do ta merrte, por, nëse nuk do të dilte vendimi nr. 484, duhet ta merrte në administrim, po të mos ishim ne. Por për shkak të daljes së këtij vendimi, të sekuestros preventive që iu bë inceneratorit të Elbasanit, ne nuk lejuam më marrjen në administrim, sepse nuk na lejon ligji i parandalimit dhe goditjes së krimit të organizuar, i vitit 2019, i ndryshuar, si dhe ligji i administrimit. Ne u futëm menjëherë në lojë, i kërkua organit që të futemi menjëherë në pozicionet e punës dhe kërkua nga Bashkia Elbasan të përfundonte disa etapa, siç ishin përgatitja e specialistëve dhe e kuadrit të dobishëm, që do të dorëzohej dhe do ta merrte në pronësi, gjë që, realisht, ka pasur disa pengesa, por nuk ka përbërë thelbin. Pra, kontrata koncesionare për ne, po të mos dilte vendimi, do të quhej e mbyllur.

Luçiano Boçi - Produkti final si mbetje e inceneratorit është hiri dhe ditën e vizitës, megjithëse ju nuk digjnit, inxhinieri na tha që hiri hidhet në landfill, teorikisht, sepse nuk prodhohej për atë muaj. Ajo që unë dua të di, meqenëse keni një muaj aty është, hiri është mbetje shumë e rrezikshme, kontaminuese, kancerogjene, që ka rregulla të caktuara për administrimin e tij. Në kontratë parashikohet koncesionari të marrë masa, është e përcaktuar në kontratë, për trajtimin e ujërave të zeza, për hirin dhe për energjinë. Për energjinë, e morëm

vesh, që nuk punon dhe nuk ka shitje, po për hirin, si administrohet mbetja e hirit në incenerator? Pra, inxhinieri, e ka me video...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, unë mendova se do të revoltoheshit që na gënjyen me kamera atë ditë dhe do të thoshe ndonjë fjalë të mirë, morale, sepse na gënjyen të gjithëve atje, po dalin gjëra të tjera këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thotë vetë zoti Arapi, sepse ka përvojë, nuk ka nevojë për mbrojtje politike, **fare**. Po e thotë, sepse e ka atë përvojë dhe unë po bëj një pyetje konkrete, sepse është aty në terren. Unë po pyes në terren, a ka vend depozitimi për hirin? Kaq; është shumë e thjeshtë; nuk e ditkan ata!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u shqetëso fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E pamë, që nuk shitej, është prodhuar.

Jorida Tabaku – Dua t'u tërheq vëmendjen kolegëve, se e kemi të pamundur të bëjmë debat me njëri-tjetrin. Fokusohuni te dëshmitarët!

Luçiano Boçi – Zoti Arapi dhe zoti Baçi, sepse ishit prezentë atë ditë kur inxhinieri deklaroi se hiri shpërndahet në landfill, kontrata përcakton se duhet të ketë trajtim të veçantë, venddepozitim të veçantë, ndoshta hermetik. Thashë dhe rastin e Francës, ku i transferojnë me tanke hermetike, sepse janë shumë helmuese dhe i asgjësojnë. A ka një vend për asgjësimin e hireve, sepse është produkti më kontaminues? Hidhen në buzë të Shkumbinit, ujërat nëntokësore, ujërat e shirave e përcjellin në florën dhe faunën që është ngjitur. Ky është shqetësim edhe për njerëzit, edhe për mjedisin. Si trajtohet? Ju për një muaj sa jeni, na thoni, se do t'ua bëj pyetje edhe të tjerëve që kanë dijeni.

Farudin Arapi – Një sqarim për të kuptuar.

Ju falënderoj për mendimin që dhatë!

Personalisht, kam inspektuar dhe vazhdoj, pasi inspektoj të gjithë inceneratorët dhe landfillet që janë në procese ndërtimi dhe përfundimi, në bazë të afateve kontraktore, kam parë, ndoshta në Elbasan jam marrë më shumë me bashkinë, të them të drejtën, për hirin; di vetëm nga ana teknologjike që inceneratori i Elbasanit ka kapacitet që djeg me temperaturë shumë të lartë, po kaloi mbi 1000 gradë, djegia nuk bëhet më e toksifikueshme. Personalisht, ju kërkoj ndjesë, por e di nga literatura dhe kam parë në inceneratorët e tjerë, po marr Fierin, po marr edhe Vlorën që është në pjesën e parë të procesit të landfillit të ndërtuar, që janë gropa të veçanta ku do të depozitohen mbetjet toksike. Mbajtja në punë e inceneratorit të Elbasanit ka

një kosto X lekë; e kemi mbajtur në punë, nuk ju kemi gënjyer, më falni që shpreh këtë fjali, por është mbajtur në punë aparatura, sepse, po të fiket, do të ditë të tërë që ta ndezim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Për sqarimin e hirit të Elbasanit dhe të mënyrës së djegies, teknologjia e përdorur në Elbasan në debatin që është zhvilluar në momentin kur do të ngriheshin inceneratorët nga specialistët është konsideruar djegie mesatare, në raport me teknologjinë bashkëkohore, madje është konsideruar teknologji e vjetër, sepse sot djegiet bëhen me 4000 mijë gradë, Elbasani e ka me 1000 gradë dhe autoklavat kanë 4000 gradë. Pasoja e elementeve kontaminuese në hi është shumë më e madhe. Nuk po nisem nga ana teknike, që ju e dini dhe ne nuk e dimë ta debatojmë. Kontrata e ka të përcaktuar qartë se duhet venddepozitimi për hirin. Unë këtë kërkoj nga ju, shumë shkurt: a ka vend depozitimi për hirin, apo hidhet në landfill? E ka kontrata. Aka impiant për trajtimin e ujërave të zeza dhe për trajtimin e hireve? Po ose jo! Nuk keni pse merrni ngarkesë.

Arjan Baçi – Po e sqaroj pak, “*Albtech Energy*” për impiantin e përpunimit të mbetjeve në qarkun e Elbasanit për vazhdimin e aktivitetit sigurisht është licencuar me lejet përkatëse dhe licencat që duhen për landfillimin incenerimin. Aty janë të përcaktuara kodet për të cilat inceneratori i Elbasanit apo edhe landfili kanë të drejtë të pranojnë mbetje apo të mos i pranojë ato. Për shembull, mbetjet spitalore duhet të vijnë sipas kodeve të përcaktuara sipas lejeve që ka inceneratori i Elbasanit. Sipas informacionit që kemi nga drejtuesi teknik, leja që ka impianti i përpunimit të mbetjeve në Elbasan e mbulon edhe trajtimin e mbetjeve të këtij hiri.

Luçiano Boçi – Po që e mbulon, e kuptova unë, se është produkt që e merr, por ku e çon? A ka venddepozitimi të veçantë: po ose jo? Është shumë e thjeshtë, publiku e do shumë të thjeshtë. Ti hyn në retorikë kot, ka marrë licencën e të tjera. E ka marrë licencën, ka marrë lekët, por nuk ka bërë punën, po them unë. A e ka bërë punën, apo jo? Kaq dua. Jetoj në Elbasan dhe e di shumë mirë këtë gjë. E kam shqetësim shumë të madh dhe transmetoj shqetësimin e atyre qytetarëve. Dua një përgjigje shumë të saktë: po, jo. Ekziston?

Arjan Baçi – Në momentin që agjencia ka marrë në administrim impiantin e përpunimit të mbetjeve në Elbasan nuk ka pasur incenerim të mbetjeve, për këtë arsye nuk ka dhe hi të grumbulluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Po, zonja Denaj, mund të vazhdojmë, se nuk mund t’i bihet për qark, kur njerëzit sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, dha përgjigjen që nuk ka. Kam edhe pyetje tjetër. E kam sipas kontratës, sepse jemi te procedura që tha zoti Pëllumbi.

Jorida Tabaku – Zoti Boçi, ju lutem, mos replikoni me kolegët! Të përfundojmë pyetjet!

Dua t'u kujtoj edhe dy dëshmitarëve që kanë ardhur, se nuk jeni thirrur në cilësinë e ekspertëve mjedisorë. Është apo jo në kontratë, këtë pyetje po kërkojmë? Si është zbatuar? Kaq. Mendimet e mia për inceneratorët i dëgjova sot nga raporti i Bankës Botërore, që është alternativa më pak e preferuar. Këto janë çështje të tjera pastaj, por zoti Boçi ka disa pyetje konkrete.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Në kontratë përcaktohet qartë që koncesionari duhet të marrë masa për ruajtjen e ekosistemit natyror. Cilat janë këto masa që keni evidentuar ju?

Arjan Baçi – Nuk jam shumë i qartë me pyetjen, megjithatë, nëse do të më lejoni, ma bëni pyetjen me shkrim që t'u drejtohem punonjësve të inceneratorit të më japin përgjigje. Di të them që inceneratori dhe landfilli çdo 3 muaj monitorohen nga agjencitë përkatëse për mjedisin dhe deri tani ka pasur dhe deri tani i ka pasur të suksesshme.

Luçiano Boçi – Monitorimi është detyrim kontraktor. Çdo tre muaj ka monitorim dhe kjo është e vërtetë. Unë po nisem nga kontrata. E kam të shkruar këtu, në pikën 11/5/21, se cilat janë masat për ruajtjen e ekosistemit, sipas kontratës.

A keni evidentuar marrje masash? Kaq. Ju jeni në terren. Kë të pyes unë?

Arjan Baci – Nuk di të them nëse ka masa për ekosistemin, por di që vendosja në punë e impiantit ka një kosto të caktuar. Kjo për arsye se pastrimi i të gjitha ndotjeve nga djegia është i lartë.

Luçiano Boçi – Shumë mirë. Atëherë, unë kuptova që energji nuk shitet, huret po hidhen në ajër, masat e tjera nuk janë marrë, lekët janë marrë e janë futur nëpër xhepa. Jemi shumë në rregull!

Jorida Tabaku - Fjalën për pyetje e kanë zonja Denaj dhe zonja Çupi.

Zonja Çupi e ka kërkuar fjalën e para.

Anila Denaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

A ka një raport vjetor monitorimi të gjendjes së mjedisit, që ju e diskutoni, e keni marrë të trashëguar nga kompania dhe jeni konsultuar me të?

A jeni vënë në dijeni të raportit vjetor të monitorimit të gjendjes së mjedisit? Kur ka qenë raporti i fundit?

Çfarë ka konstatuar ky raportim në lidhje me ndotjen? Sidomos në një zonë si Elbasani, ku, përveç faktit që kolegu Boçi jeton aty, të gjithë ne e dimë që ka pasur problematika ndotjesh prej vitesh, sepse Elbasani e ka trashëguar edhe nga industria këtë.

A ka në këto raportime një tregues në kohë se si ka ndryshuar cilësia e ajrit para ngritjes së impiantit, gjatë, dhe gjatë vitit të fundit?

Kur parashikohet të jetë raporti pasardhës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që është në fokus të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së dyti, ne jemi vënë në dijeni edhe me shkresë nga OSHEE-ja për prodhimin e energjisë. Sigurisht, për çështjet teknike ju thatë që do të na sillni një raport. Unë nuk jam teknike dhe dëshiroj shumë ta lexoj raportin teknik.

Megjithatë, kur ishim në vizitë, ju na treguat një pajisje ku prodhohej energji. Madje, nuk e mbaj mend shumë mirë shifrën, por ishte me mbi 5000 kilovatë dhe ju thatë që 1/3-ta e tyre përdoret për përdorim të brendshëm. A është e vërtetë kjo?

Faleminderit!

Arjan Baci – Atëherë, në bazë të kontratës, raportet mjedisore, që kontrollohen nga agjencia e mjedisit, për incenerimin dhe *landfill*-imin bëhen të ndryshme dhe nga ekspertë të jashtëm të licencuar. Pra, ky shërbim blihet. Deri në momentin që flasim, të gjitha këto raporte kanë qenë pozitive dhe në nivelin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Raporti i fundit, në mos gaboj, ka qenë në nëntor të vitit 2021.

(Zonja Anila Denaj ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse do të duhet, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç e treguam edhe tek impianti, aty ka një pajisje, një matës, që tregon prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike, injektimin në rrjet dhe blerjen nga OSHEE-ja në momente të caktuara të impiantit. Kjo diferencë është pozitive, rreth 6 milionë e 700 mijë kilovatorë.

Helidon Bushati – Në sa kohë?

Arjan Baci– Nga momenti kur ka filluar punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Sa për qind të energjisë që prodhoni e përdorini për nevojat tuaja?

Arjan Baci – Kur inceneratori është në punë, e gjithë energjia që duhet për funksionimin e inceneratorit dhe *landfill*-it merret nga ky burim energjie. Diferenca ose importi

i energjisë elektrike të marrë nga OSHEE-ja është në periudhat kur inceneratori është pushim, bëhet remonti dhe... Pra, vetëm në këto momente ka blerje të energjisë.

(Zonja Anila Denaj ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Jorida Tabaku – A mbaruat, zonja Denaj?

Anila Denaj – Po, me nevojën që disa informacione të na i sjellin me shkrim.

Jorida Tabaku – Besoj se i mbajtët shënim dy raportet që kërkoi zonja Denaj për t'i depozituar në këtë komision.

Kam edhe një gjë për çështjen e energjisë.

Fjalën e ka kërkuar zonja Çupi dhe më pas zonja Dhima.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të them diçka për çështjen e energjisë dhe më pas...

Besoj se jeni në dijeni për vendimin nr.792 të Entit Rregullator të Energjisë, i cili kësaj kontrate koncesionare për energjinë, që ishte 7-vjeçare, i ka shtuar dhe një 25-vjeçar. Pra, kompania Albtek-Energy, që duhet ta përfundonte kontratën koncesionare për 7 vjet dhe ta merrte në dorëzim Bashkia e Elbasanit, tani do ta ketë për 25 vjet shitjen e energjisë. Ky është një ndryshim i kontratës fillestare. Ne i kemi llogaritur kosto-përfitimet e kontratës fillestare dhe tani ky është një shërbim i ri që merr koncesionari. Koncesionari është paguar dhe tani po merr një shërbim të ri.

Çështja e energjisë nuk është kaq e thjeshtë. Po e diskutojmë çështjen e energjisë, sepse bëhet fjalë për një koncesion të dytë të dhënë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, edhe unë atë po them. Po i sqaroj qytetarët që kjo është shumë e rëndësishme, sepse është dhënë një koncesion i dytë. Duhet ta merrte Bashkia e Elbasanit dhe është dhënë një koncesion i dytë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e sqaroj për të gjithë njerëzit që prandaj po diskutohet çështja e energjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, siç e tha dhe zonja Denaj, ne jemi të interesuar për procedurën e dhënies me koncesion. Pra, kemi një kontratë koncesionare, ku është dhënë një vendim, e kanë shkelur me këmbë dhe kanë shtuar edhe 25 vjet. Këtë po diskutojmë ne.

Atëherë, si e gjykoni këtë vendim të dytë, për sa i përket zbatimit të kësaj kontrate të dytë koncesionare 25-vjeçare?

Arjan Baci – Nuk kemi dijeni për këtë vendim të Këshillit të Ministrave.

Jorida Tabaku – Nuk jeni në dijeni që kompania që ju administroni ka marrë një licencë të dytë për shitjen e energjisë elektrike, me vendimin nr.792 të Entit Rregullator të Energjisë, për shitjen për 25 vjet të energjisë?

Kështu e ka bërë.

Arjan Baci – Nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion nuk ka rezultuar.

Jorida Tabaku – Besoj se nuk i keni audituar mirë dokumentet. Ka akoma nevojë për çështje të tjera, që duhet të dalin.

Kam një pyetje për zotin Arapi. Më pas fjalën e ka zonja Çupi.

Zoti Arapi, çfarë të ardhurash merrte kompania, përveç pagesës koncesionare nga buxheti i shtetit?

Farudin Arapi – Më falni, por a mund të jeni më e drejtpërdrejtë? Për cilën kompani, për atë që administroj unë apo...?

Jorida Tabaku – Për të dyja kompanitë, meqenëse thatë që jemi në proces auditimi. Kompania Albtek-Energy është përfituesja e një pagesë të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit. Përveç kësaj pagese të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit, që varionte nga 600 në 700 milionë lekë në vit, çfarë pagesash të tjera ka marrë kjo kompani?

Si i ka realizuar të ardhurat kjo kompani?

Farudin Arapi – Me të dhënat që kam unë, kompania Albtech e ka mbyllur angazhimin e saj për përfundimin e procesit të ndërtimit të *landfill*-it dhe inceneratorit. Vlera që përmendët më parë ka të bëjë vetëm me një kredi sovranë për pagat, marrë nga Credins Bank, për shkak të garancisë, sepse deri në momentin kur kemi diskutuar nuk ka pasur asnjë humbje, i ka shlyer me kredinë që nga 2018-ta, 2020-ta dhe ka ende të palikuiduar një vlerë prej rreth 12 mijë e 860 lekë.

Jorida Tabaku – Jam shumë e qartë për këtë. Pyetja që bëra ishte tjetër.

Farudin Arapi – E mbylla.

Për problemin për të cilin diskutoni, për mua personalisht vlera e projektit nuk është tejkualuar dhe nuk tejkalohe, sepse çdo ndërprerje kontraktore me nënkontraktorët që ne kemi, pra me nënkontraktorët që ka Albtech sh.p.k., është mbyllur në bazë të situacioneve përkatëse dhe nuk kemi vlerë tjetër suplementare të likuiduar nga zyrat tona të kontabilitetit.

Jorida Tabaku - Atëherë, po e ribëj edhe një herë pyetjen. Kemi një kontratë koncesionare 22 milionë euro, e cila...

Farudin Arapi – 21 milionë e 600...

Jorida Tabaku – Dakord, 21,6 milionë euro, që të jemi të saktë. Ndërkohë, janë marrë pagesa sipas bilancit të kompanisë dhe ka të ardhura 40 milionë euro.

Përveç pagesës që ka marrë nga buxheti i shtetit, a ka kryer kompania shërbime të tjera? Energji nuk ka shitur, e sqaruar. Bashkitë nuk kanë paguar tarifa të tjera. Kontrata koncesionare 21,6 milionë euro; bilanci i kompanisë 40 milionë euro. Nga kanë ardhur të ardhurat që janë në diferencë të kësaj? Janë po të buxhetit të shtetit? Kjo është pyetja që dua të sqaroj.

Faraudin Arapi – Aktualisht nuk mendoj se ka ndonjë shifër tjetër përveç kësaj që ju raportova. Vlera 40 milionë, nuk di, e llogaritur nga ju ose nga bilanci...

Jorida Tabaku – Nga bilanci i dorëzuar në qendrën kombëtare...

Faraudin Arapi – Edhe unë e kam bilancin. Nuk ka asnjë vlerë ekstra të shtuar në vlerën e projektit. Që të jem i saktë deri në fund, vlera e projektit me zyrën e kontabilitetit janë të përputhura plotësisht: fatura sipas preventivit, situacione të kolauduara dhe vlera të shlyera. Nuk të lejon asnjë institucion, përveç atyre që ka çelur qeveria, në vlerën që përmenda, 26 mijë, të ketë vlerë tjetër suplement 40 milionë. Për mua, është e pajustificuar dhe nuk ekziston.

Jorida Tabaku – Atëherë, ju sugjeroj t'i shikoni edhe një herë bilancet e kompanisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bilanc thuhet 40 milionë, ndërkohë që zoti Lefter i referohet shifrës për pagesat e drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit, që janë më shumë se ajo që ju deklaroni me përgjegjësi të plotë, por do t'ia jap atij fjalën, që të thotë se sa është shifra.

Në dijeninë tuaj, kompanitë Albtek-Energy dhe ITS a kanë kontraktorë kompani të tjera, të zotëruara nga zonja Stela Gugallia dhe zoti Klodian Zoto?

A kanë nënkontraktuar kompani të tjera të zotëruara nga këta dy zotërinj, për sa u përket punimeve të konsulencës, punimeve inxhinierike dhe punimeve në infrastrukturë, që janë zhvilluar në incenerator?

Faraudin Arapi – Sipas pasqyrës që disponoj, duhet të kemi diçka të qartë: shoqëria “Integrated Technology Services”, pra shërbimet teknologjike të integruara, është krijuar që në vitin 2010 dhe në vazhdimësi, deri në vazhdimin e procesit penal që ka filluar, sepse prezumimi i pafajësisë është një proces i natyrshëm që ne nuk i hymë, di që ka aktivitete jo vetëm për ndërtim inceneratorësh, por edhe për landfille, pra është aksioner në disa kompani. Po të shohim veprimet, kur unë jam caktuar si administrator, kemi bërë ngrirjen e aktiviteteve, por jo mosfunksionimin e tyre. Do t'ju përmend disa shoqëri, të cilat unë i kam si objekt të analizës sime. Nuk është vetëm shoqëria “Altec”, ka ...

Jorida Tabaku – A është shoqëria “Consulting SE Partners” e dorëzuar nga Stela Gugalli si nënkontraktore?

Faraudin Arapi – Po ka qenë.

Jorida Tabaku – A është shoqëria “E.R One Albania sh.p.k.” e zotëruar nga “Energy Recuperator” dhe Ernesto Graneli si nënkontraktore?

Farudin Arapi – Të gjithë këto janë dhe po jua sqaroj.

Jorida Tabaku – Nëse ka mundësi na jepni një sqarim për këtë çështje. Unë kam nxjerrë këtu të paktë 30 kompani të zotëruara nga Zoto dhe Gugalli që janë nënkontraktor...

Farudin Arapi – Ju lutem, në Fier “Integrated Technology Servis” zotëron 70 % të koncesioneve sipas ekstraktit të QKB-së...

Jorida Tabaku – Nuk i referohem kontratave koncesionare, por nënkontraktorëve të punimeve.

Farudin Arapi – Një shoqëri me inerte sh.p.k “ITS” zotëron 24%, ku jam unë si përfaqësues i saj, të kapaciteteve të shoqërisë, në shoqërinë “CGC”, e themeluar në vitin 2013, Mirel Mërtiri “ITS”, zotëron 70% të aksioneve. Pra kjo është një kompani që në bazë të statutit, prandaj përmenda prezumimin e pafajësisë, për sa kohë nuk ka përfunduar procesi hetimor, ai deri në datën që është vënë në ndjekje, është marrë me ndërtime të llojeve të ndryshme, si impiante teknologjike, impiante të prodhimit të energjisë elektrike, landfillet e të tjera, pra ka një fushë të gjerë veprimi. Në këtë fushë të gjerë veprimi askush nuk e ka ndaluar konkurrimin e tij në tenderat përkatës që ka. Pra ai është dhe zotëron kapitale në disa shoqëri, por që janë ngrirë për momentin dhe janë nën mbikëqyrjen...

Jorida Tabaku – Zoti Arapi, unë dua që dokumentin që ju keni ta administrojmë në cilësinë e provës në këtë komision.

Shqetësimi që ne kemi është se janë krijuar kompani të zotërinjve Zoto, Mërtiri dhe Gugallja, që janë nënkontraktuar, unë i kam nxjerrë këtu dhe ju sapo i konfirmuat, për punë brenda kantierit, përveç rasteve të kompanive “PIVO 04” dhe “AS”, të cilat janë zbuluar nga struktura e veçantë antikorrupsion si kompani që kanë kryer procese shitje dhe blerje me fatura fiktive dhe nuk kanë kryer punë për inceneratorët. Prandaj kam dëshirë që këtë dokument ta administrojmë ne në cilësinë e provës listën e nënkontraktorëve ku janë pronarë Zoto, Gugallja dhe Mërtiri.

I përfundova pyetjet dhe fjalën do t’ia jap zonjës Çupi.

Farudin Arapi – A mund të bëj një sqarim të vogël, ju lutem?

Jorida Tabaku – Po, patjetër.

Farudin Arapi – Unë shpjegova se Klodian Zoto, ish-administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “ITS”, ka pasur mundësi që kapitalet dhe fitimin që ka realizuar në vite, unë kam tabelën përkatëse të realizimit të pjesës së fitimit, si ortak i vetëm, ta shpërndante. Kjo ka qenë e drejtë e tij.

Edhe një sqarim, fitimi, në përputhje me ligjin e kontabilitetit, bëhet brenda datës 30 korrik të vitit që ka qenë dhe ai e ka shpërndarë, ka realizuar një fitim...

Jorida Tabaku – I kam të qarta, sepse kam bilanci këtu.

Faraudin Arapi – Një minutë, ju lutem, 43 milionë 522 259 lekë për vitin 2020. Viti 2021 nuk ka dalë.

Jorida Tabaku – Vitin 2021 nuk e kam.

Faraudin Arapi – Nuk ka dalë viti 2021. Këtë e ka mbyllur në korrik dhe si ortak i vetëm ka investuar në kapitalet e këtyre shoqërive. Ka qenë e drejtë e tij, sepse nuk ka qenë në proces hetimor.

Jorida Tabaku – Nuk po e diskutoj fare këtë të drejtë. Ne po diskutojmë që këtu është ngritur një piramidë kompanish, të cilat kanë paguar njëra – tjetrën, këtë po diskutojmë.

Faraudin Arapi – Të lutem, duhet të kemi një gjë parasysh, nënkontratat, ju i keni dhe nuk ka nevojë t'ju mbush mendjen, mes shoqërisë koncesionare dhe "ITS"-s janë mbi 90, pra mund të ketë edhe 110 nënkontrata për shërbime të ndryshme që ofrohen për të kryer punimet në përfundimin e programit të investimit që ka një landfill apo një incenerator. Të mos e ngatërrojmë këtë, ndërsa si aksioner pjesën e dividendit të fitimit të tij e shpërndan si të dëshirojë.

Jorida Tabaku – Po diskutoja për nënkontrata dhe do të mbyll.

Zoti Arapi, sa etike e gjykoni ju që zonja Stela Gugallja që është aksionere e kompanisë "Altec Energy" zotëron një kompani auditimi shoqëria "Consulting SE Partners", e cila bën auditimin e këtyre bilanceve?

Faraudin Arapi – Aktualisht, meqenëse ...

Jorida Tabaku – Aktualisht janë në kërkim ato, por po them ..

Faraudin Arapi – Meqenëse zotëronte 80% të aksioneve në këtë shoqëri që e përmendëm, e cila edhe pse nuk është përmendur në vendimin e gjykatës, po e citoj, personalisht kolegu përkatës i ka ndërprerë marrëdhëniet nga momenti që ne e morëm në administrim. Personalisht unë, me studion në të cilën ka qenë Stela Gugallja, mbaj një staf të reduktuar, vetëm për shërbimet e mia personale dhe jo të inceneratorëve që ndjek në procese. Ndërsa, aktivitet të mirëfilltë të likuidimit të vlerave dhe benefiteve që dalin nga studioja nuk ka më. Këtë e them me përgjegjësi.

Jorida Tabaku – Zoti Arapi, ju jeni me eksperiencë dhe nuk ka nevojë që t'ju shpjegoj juve procesin. Unë po them që këto dy muaj ato janë në kërkim, por po them që kjo ka ndodhur për 7 vjet, dhe kanë krijuar kompani që kanë paguar veten duke bërë auditimin po nga kompania vetë. Pra ne po diskutojmë për një skemë pastrimi parash, ndërsa çfarë ndodh këto 2 muaj është një gjë tjetër.

Farudin Arapo – E drejtë. Jam me ju është pjesë e procesit të hetimit.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zonja Çupi.

Dhurata Çupi – Faleminderit,

Të nderuar zotërinj, që jeni të pranishëm,

Për të qenë e qartë edhe pala përballë, pasi deputetët me shumë të drejtë insistojnë t'i qëndrojnë objektit të komisionit hetimor, për dijeninë tuaj objekt i komisionit hetimor janë procedurat e ndjekura mbi kontratën koncesionare, kjo nuk ka lidhje me ju, lidhja dhe ekzekutimi i kontratës që normalisht kanë lidhje me pyetjet që do të bëhen dhe abuzimi, nëse ka, nga buxheti i shtetit.

Pra, këto janë 3 objektet e punës së këtij komisioni.

Para se të filloj me pyetjet, sepse kam 2 pyetje për kontratën, ju të paktën 2 herë deklaruat, që unë inspektoj të gjitha koncesionet e inceneratorëve në Shqipëri, a ka mundësi ta di përse?

Farudin Arapi – Nuk besoj se i inspektoj, por shkoj se jam aksioner në një pjesë, pra shoqëria që kam nën administrim në bazë të vendimit të gjykatës, pasi diku mund të ketë 70%, diku tjetër 23% e të tjera, për të parë angazhimet dhe detyrimet për t'i thënë stop vazhdimësisë së kryerjes së shpenzimeve që nuk përputhen me vazhdimësinë e kontratës që ekziston, kjo për pjesën që unë kam, jo për të tjerat. Pra, unë shkoj dhe i shoh, sepse e kam detyrim ligjor si administrator.

Dhurata Çupi – Përgjigjja juaj më solli në mendje një pyetje tjetër. Kompania që ju administroni sot në Elbasan ka aksione në të gjithë inceneratorët në Shqipëri?

Farudin Arapi – Unë jam administrator në një institucion tjetër që kryen shërbime teknologjike të integruara, ndërsa zotëria është në Albtek, unë fola për veten time dhe për institucionin ku kam disa nga ato që ju përmenda më sipër. Sa i takon Albtek-ut nuk besoj se ka, por megjithatë përgjigjen le t'ju japë kolegu.

Dhurata Çupi – Kam një pyetje lidhur me kontratën. Kur ka filluar ekzekutimi i kontratës, a ka mundësi të ma thoni, sepse ju në bazë të kësaj kontrate po vazhdoni të punoni? Pra, kur është nënshkruar kontrata ndërmjet koncesionarit dhe institucionit publik?

(Diskutime pa mikrofon)

Farudin Arapi – Kontrata është nënshkruar më 21.12.2013 dhe ka qenë e vlefshme ekskluzivisht nga ana logjike dhe ligjore ndërmjet palëve, shoqërisë përkatëse dhe ITS-së që është institucioni ku unë jam pjesë, duke pasur nënkontratat përkatëse.

Dhurata Çupi – Cili ka qenë afati i përfundimit të punimeve? A është lidhur në vitin 2016? Për sa kohë do të kryheshin punimet?

Faraudin Arapi – Është lidhur në vitin 2013 dhe afati do të ishte 7-vjeçar.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, unë nuk jam i Elbasanit, por jam i ITS-së, ndërsa i Elbasanit është kolegu.

Dhurata Çupi – Pra, qëllimi i pyetjes është: kur ka filluar kontrata, për të dy dëshmitarët? Kur duhej të përfundonte kontrata? A është ekzekutuar, pra a janë bërë punimet brenda afatit të kontratës? Sa para janë dhënë nga buxheti i shtetit brenda kontratës? A është ekzekutuar kontrata në afat dhe a ka pasur penalitete nëse nuk është ekzekutuar kontrata në afat? Këto janë të gjitha pyetjet që unë kisha.

Arjan Baçi – Kontrata e koncesionarit mes shoqërisë Albtech dhe autoritetit kontraktues për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve në Elbasan është e vitit 2014. Afati i përfundimit është 7 vjet nga data efektive e lidhjes së kontratës. Data efektive, në gjykimin tim, është data që është lidhur kontrata dhe i bie që më 16 dhjetor 2021 të përfundonte afati për dorëzimin e inceneratorit.

Dhurata Çupi – Pra, është një kontratë e financuar totalisht me buxhetin e shtetit. Sa para janë paguar nga buxheti i shtetit?

Arjan Baçi – Në momentin e marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 484, na është vënë në dispozicion edhe kontrata e koncesionarit ku kontrata bashkëngjitur ka edhe listën e disbursimit të lekëve, të cilat do t'i merrte kjo shoqëri për ndërtimin e këtij impianti.

Afati i fundit është data 30 ose dhjetor 2020, dhe vlera reale është, sipas kontratës, 21,6 milionë euro.

Dhurata Çupi – Pra, 21,6 milionë euro janë disbursuar nga buxheti i shtetit për koncesionarin, ndërkohë që kontrata duhej të mbaronte në vitin 2020 nuk kishte përfunduar. Pyetja që unë kam është: a ka pasur penalitete pas mbarimit të afatit të kontratës?

Arjan Baçi - Jo, kontrata përfundonte më 16 dhjetor të vitit 2021, ndërsa disbursimi është bërë në dhjetor të vitit 2020, pra kjo nuk ka lidhje me penalitetet, sepse është brenda afateve.

Dhurata Çupi – Objekti i këtij komisioni hetimor, po jua them edhe një herë, janë procedurat e paligjshme, por nuk është në autoritetin tuaj të jepni shpjegime. Zbatimi i kontratës, a ka qenë brenda afateve? Nëse ka qenë brenda afateve, a është shlyer totali prej 21,6 milionë eurosh? Në përfundim të kontratës, a ka qenë në funksion impianti dhe nëse nuk ka qenë, a ka penalitete kjo kompani? Këtë janë pyetje të thjeshta, janë baza.

Kam edhe një pyetje për ta mbyllur. Ju thatë që prodhohet energji elektrike, por ndërkohë nuk merrni mbrapa faturën. Ku shkon kjo energji elektrike, sepse nuk mendoj që ta fusni në çelës?

Faraudin Arapi – Më lejoni, t'ju bëj 2 sqarime.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, a mund të bëj një sqarim më tepër edhe si ndjekës aktualisht i këtyre vlerave të investimit!

Vlera totale e investimit për ndërtimin e inceneratorit në Elbasan është 21 milionë e 600 mijë euro, plus TVSH-në 4 milionë e 320 mijë, bëhen 25 milionë e 920 mijë euro. Atëherë, likuidimi i kësteve nëpërmjet atyre që ju përmendët është i tillë, duke filluar nga 31.8.2015 me një vlerë kësti i parë 393 751 20 euro, vazhdojnë të gjitha kështet standard, duke përmendur vitin 2015, vitin 2016, pra janë gjithsej 66 financime të kësteve të pandryshuara për të cilën është realizuar kjo vlerë. Kjo është vlera përfundimtare e projektit, të cilën, siç jua përmenda më sipër, është realizuar dhe janë me fatura dhe situacione të likuiduara nëpërmjet bankës, pasi është bërë edhe kolaudimi i tyre. Kjo është tabela përfundimtare.

Aktualisht, nuk disponojmë dhe nuk kemi asnjë vlerë të dëmit për penalitete që lidhen me shtyrjen e afateve, sepse ndodh, po jua shpjegoj teknikisht, ndoshta edhe mund të gabohem, që midis supervisorëve dhe shoqërisë, kur ka zvarritje, sidomos në dhënien e licencës për ndërtimin e landfilleve, sepse aty ka qenë edhe problematika më e madhe, nga momenti i marrjes kur është bërë kontrata deri në momentin kur kanë filluar punimet e ndërtimit të landfillit, është një kohë relativisht e gjatë ku KKRT-ja ka marrë vendimet përkatëse. Afatet janë shtyrë në maksimum me 2 ose 3 muaj.

Sinqerisht ju them se unë nuk disponoj asnjë lloj penalteti për shoqërinë e Albtek-ut nga faturat që kam dhe paratë janë lëvruar brenda afateve dhe kësteve të përcaktuara në marrëveshjen që ka pasur me nivelet e bankave të dyta të Shqipërisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Anila Denaj – Zoti Bushati, unë di që nuk jeni ju kryetari.

Jorida Tabaku – Zonja Denaj, për procedurë.

Është diskutuar gjatë me stafin e komisionit çështja e orareve...

Anila Denaj – Riskeduloni agjendën dhe do të rrimë këtu deri në fund për të dëgjuar çdo dëshmitar.

Jorida Tabaku – Do ta riskedulojmë dhe do t'ju japim më shumë kohë, por dëshmitarët pa u pyetur nuk kanë për t'u larguar.

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Denaj, të mos bëjmë diskutime që i kemi bërë, sepse ditët i keni hequr dhe kërkoni të mbyllni komisionin hetimor, ndërsa tani më thua mua mos t'i marrim...

(Diskutime pa mikrofon)

I kemi hequr ne?

Ne do të rrimë këtu dhe do t'i dëgjojmë të gjithë dëshmitarët.

Anila Denaj – Kërkoj formalisht ndryshimin e agjendës...

Jorida Tabaku – Patjetër, do t'i japim më shumë kohë dëshmitarëve.

Zonja Denaj, fjalën jua jap unë.

Fjalën e ka zonja Dhima.

Anila Denaj – Kërkoj ndryshimin e agjendës, sepse nuk mund të vazhdojmë 2 orë. Më vjen keq, por unë di që ka një agjendë.

Ju jeni kryetare e komisionit kështu që ma sqaroni agjendën, ma riskeduloni të gjithën.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Gjatë gjithë kësaj kohe që ne kemi filluar të diskutojmë dhe të dëgjojmë dëshmitarët është diskutuar shumë pjesa e energjisë elektrike që prodhohet në inceneratorin e Elbasanit. Dua të sjell në vëmendjen e anëtarëve të këtij komisioni, si dhe ta informoj publikun, se ky komision për nevojat e hetimit i është drejtuar OSHEE-së me një kërkesë për informacion mbi prodhimin e energjisë elektrike nga inceneratorët e Elbasanit dhe të Fierit. Në përgjigjen e administratorit Ardian Çela thuhet se: “Për inceneratorin e Elbasanit bëjmë me dije se shoqëria Albtech Energy sh.p.k. ka aplikuar pranë OSHEE sh.a. për lidhje të burimit gjenerues të rrjetit shpërndarës të OSHEE sh.a në gusht të vitit 2016. Në prill të vitit 2017 është instaluar në objektin matës të energjisë elektrike me dy drejtime. Në datën 6.6.2017, shoqëria ka njoftuar OSHEE sh.a. se do të kalojë në regjimin dhënie energjie në rrjetin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike deri në datën 8.11.2021. Rezulton se ky subjekt ka injektuar në rrjetin shpërndarës sasinë e energjisë prej 6748,2 megavatorë dhe ka përdorur për nevoja vetjake sasinë e energjisë prej 2792,6 megavatorë”.

Ne, në inspektimin që bëmë në inceneratorin e Elbasanit e pamë edhe sasinë e energjisë që ishte injektuar atje, të cilën e lexuam edhe në matësin që ishte vendosur. Kjo ishte sa për informacion në mënyrë që të mos i hutojmë njerëzit dhe të mos i japim drejtime të tjera këtij komisioni.

E nderuar, zonja kryetare,

Mendoj që ne duhet të respektojmë të gjitha procedurat për këtë komision dhe njëkohësisht të respektojmë Rregulloren dhe kohën ashtu siç edhe zonja Denaj, jua tha para meje.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, e nderuar zonja Dhima!

Fjalën e ka kërkuar zoti Spaho.

Edmond Spaho – Faleminderit!

Kam diçka për zotin Faudin Arapi. Dua të di a keni pasur mundësi të shikoni procesin e aplikimit për koncesionin, procedurat që janë ndjekur që të mund t'ju bëj ndonjë pyetje nga kjo periudhë.

Faraudin Arapi - Faleminderit për pyetjen!

Ne në këtë periudhë kohore deri më sot kemi marrë në administrim të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me veprimtarinë e institucionit ku unë jam dhe që ka marrëdhënie me Albtech ose me shoqëritë e tjera në Fier dhe në Tiranë. Të gjitha kontratat themelore, kontratën bazë, si dhe nënkontratat në të njëjtën kohë po i bashkëshoqëroj për t'i përputhur, sepse siç jua thashë...

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi ende në grumbullim të materialit dhe realisht në të dhënat...

Edmond Spaho – Kuptimi im, më korrigjoni nëse e kam gabim, është që shteti ka vënë në dispozicion paratë dhe kompania ka ndërtuar inceneratorin, djegësin dhe prodhuesin e energjisë elektrike, apo jo, përveç fushës së depozitimit. A jam i saktë në këtë që ju thashë? E gjitha kjo ka kushtuar 26 milionë euro, para, të cilat shteti i ka likuiduar apo jo, pra ia ka dhënë kompanisë. Prandaj edhe bashkitë që mbulon ky incenerator nuk paguajnë tarifë për depozitimin, sikurse është tek inceneratori i Tiranës që paguajnë 29 euro për ton, apo jo, sepse këtu shteti e ka paguar të gjithë që nga fillimi vleftën e inceneratorit. A jam korrekt në këtë?

Faraudin Arapi – Po.

Edmond Spaho - Inceneratori ka një kontratë me Ministrinë e Mjedisit që pas 7 vjetëve t'i dorëzohet bashkisë së Elbasanit, apo jo? Kjo përfshin edhe djegësin, edhe impiantin e prodhimit të energjisë elektrike apo vetëm djegësin?

Faraudin Arapi – Në këtë vlerë përfshihen të gjitha llojet e punimeve, përfshi edhe ndërtimin e inceneratorit që është realizuar, sepse ka një kosto, nëse nuk jua kam përmendur do t'jua them se sa është kostoja e inceneratorit në Elbasan dhe e landfilleve. Pra, është përfshirë në vlerën e plotë, e cila do t'i dorëzohet, pra edhe impianti i energjisë së Elbasanit bashkisë së Elbasanit.

Edmond Spaho – Supozojmë sikur nuk do të kishte ndodhur kjo historia që të hapeshin hetimet. U mbushën 7 vjet, siç e parashikon kontrata, dhe bashkia e Elbasanit do të merrte edhe djegësin edhe impiantin e prodhimit të energjisë elektrike, apo jo?

Faraudin Arapi – Po.

Edmond Spaho – Pyetja tjetër, përse kompania që administron inceneratorin e Elbasanit ka një kontratë me Ministrinë e Energjisë për prodhim të energjisë elektrike për një periudhë 25-vjeçare në një kohë që supozohet që do ta dorëzonte te bashkia e Elbasanit pas 7 vjetëve?

Faraudin Arapi – Duke qenë se ju dhashë një sqarim, i cili ndoshta nuk ishte sqarues, ne tashmë po e evidentojmë nëse ekziston kjo kontratë dhe duhet ta vëmë në dispozicion për ta ndërprerë vazhdimësinë e kësaj kontrate, sepse normalisht nuk ka qenë në kompetencën tonë. Ne nuk kemi informacionin e mjaftueshëm që pas administrimit energjia elektrike dhe benefitet që rrjedhin nga realizimi i saj do të ishin në favor të Stela Gugallës, iksit apo ipsilonit, sepse po ju dorëzua do të ishte e realizuar totalisht.

Edmond Spaho – Nga informacioni që kam, një kontratë e tillë ekziston dhe sipas kuptimeve që kam unë për kontratat i bie që kompania të pretendojë të vazhdojë për një periudhë 25-vjeçare prodhimin e energjisë elektrike, shitjen shtetit dhe akumulimin e të ardhurave për këtë periudhë. Besoj se jam korrekt, pra nëse kjo kontratë ekziston dhe nga informacioni që unë kam është që ekziston.

Faraudin Arapi – Realisht, ne nuk e disponojmë, por do ta bëjmë pjesë të organit të prokurorisë, sepse kemi të drejtën ligjore që na e jep ligji ynë që kur konstatohet, siç është rasti konkret, kemi marrë një informacion, por nuk e kemi disponuar. Ndaj, duke qenë se është në një proces hetimor penal edhe personi në fjalë, kam bindjen, personalisht nga përvoja dhe eksperiencia, që një veprim të tillë organi i prokurorisë nuk do ta kalojë lehtë dhe do ta anulojë, për mendimin tim.

Edmond Spaho – Të lutem, se nuk kam mbaruar ende, ma hoqët edhe pyetjen nga mendja!

Jorida Tabaku – Do ta përfundoj fjalën e tij zoti Spaho.

Edmond Spaho – Doja të pyesja administratorin e kompanisë së Elbasanit, lënda e parë, po supozoj që jemi në kushtet që do të vazhdojë për 25 vjet prodhimi i energjisë, sepse ka kontratë për këtë (prokuroria duhet të ndërhyjë dhe t'i vërë njerëzit para përgjegjësisë), djegësi ligjërisht do t'i kalojë bashkisë, por djegësi prodhon edhe lëndën e parë për prodhimin e energjisë elektrike, domethënë do të digjen mbeturinat për të prodhuar energji elektrike. Këto mbeturina, të cilat i ka Bashkia e Elbasanit, sepse është mbyllur periudha, vlerësohen kur i kalojnë impiantit të prodhimit të energjisë elektrike?

Sikurse Bashkia e Elbasanit, në kushtet aktuale është pronarja e djegësit, kompania juaj është pronarja e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike, sipas meje, sepse ka një kontratë 25-vjeçare, unë ju furnizoj ju me lëndë të parë për të prodhuar energji elektrike, ju, në këmbim, më jepni ndonjë lekë mua, në kushtet aktuale të kontratës?

Faraudin Arapi - Siç e thatë edhe ju, jemi në kushte të supozimit, sepse në dijeninë time nuk ka një kontratë të tillë dhe nga informacioni që kemi marrë nga shoqëria apo nga punonjësit. Nuk na kanë vënë në dispozicion një vendim të Këshillit të Ministrave apo një kontratë të tillë për të marrë prodhimin e energjisë elektrike për 25 vjet.

Edmond Spaho – Pas jush do të vijë një gazetar, i cili ka bërë një investigim dhe e ka parë kontratën me sy. E ka marrë atë nga Ministria e Energjetikës, që ka një kontratë 25-vjeçare për prodhimin e energjisë elektrike.

Debati me ministrinë nuk është për kohën, por është për çmimin, sepse kompania që përfaqësoni ju do çmim 12,5 lekë për kilovat, si energji e rinovueshme. Në fakt, ERE-ja, ju thotë: “Do t’jua blejmë me 8,5 lekë për kilovat, sepse impianti juaj është 2,8 megavat, për rrjedhojë, nuk përfitoni nga koncepti i energjisë së rinovueshme”.

Sa kohë që ky impiant (por jemi gjithmonë në kushtet që ekziston kontrata për 25 vjet)

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një kontratë për 25 vjet dhe detyrimi i kompanisë suaj është që t’i jepni shtetit vetëm 2% të vlerës së shitjes së energjisë elektrike.

A është normale që një objekt që ndërtohet me paratë e shtetit, të mbyllë afatin, t’i zgjatet afati dhe t’i japë shtetit vetëm 2% të vlerës, pjesën tjetër ta fusë në xhep?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jam në kushtet e supozimit. Mbas pak do të vijë këtu dhe do të shikoni se ka një kontratë të lidhur midis Ministrisë së Energjetikës dhe Albtek-ut që të prodhojë energji elektrike për 25 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të prodhojë, po për kë do të prodhojë?

Pse e ka firmosur “Albtek” kontratën me Ministrinë e Energjetikës për 25 vjet?

Jorida Tabaku - Fjala për zotin Lefter Gështenja dhe përfundojmë pyetjet.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zonja kryetare!

Më lejoni, zoti Arapi, t’ju korrigjoj lidhur me pagesat që janë bërë për inceneratorin e Elbasanit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me shkresë të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Operacionit të Thesarit, Tiranë, më 22.11.2021, na ka sjellë informacion lidhur me pagesat e kryera për inceneratorin e Elbasanit, që nuk është e vërtetë, ashtu si thatë ju, se ka pagesa konstante çdo muaj, por është ndryshe, që do të thotë se për muajin e parë, gusht 2015, që nuk ka filluar pagesa e parë, është 45 mijë lekë të rinj. Nuk po e lexoj pjesën tjetër. E pastaj vazhdon me radhë, 4540, pastaj thotë 1727, pastaj thotë 107, 98. Ndërkohë, është shumë e drejtë ajo që thatë ju, duhet të ishte konstante për 60 muaj. Në fakt, në realitet nuk ka ndodhur kështu dhe kjo është arsyeja pse ne themi se shuma totale e kësaj kontrate nuk është më 21 milionë e 600 mijë euro, por është 3,3 miliardë lekë të

rinj. Kjo është shifër zyrtare nga Drejtoria e Thesarit. Të gjitha këto pagesa janë të bëra nga autoriteti kontraktor.

Kjo për sa u përket pagesave.

Nuk e di, keni ndonjë koment për këtë, që është shkresë zyrtare?

Faraudin Arapi - Për ta shpjeguar, lidhur me faturimet që janë bërë realisht, kam kështet pa TVSH, me TVSH dhe vlerën totale të kësteve të faturuara muaj për muaj, sipas afateve që u përmendën. Katërcipërisht nuk e pranoj, nëse me të vërtetë juve ju ka dërguar një informacion thesari, por ky është informacion i zyrës sonë të kontabilitetit, që disponon dhe kryen pagesat.

Konkretisht, në datën kur janë likuiduar dhe janë paguar, data 27.08, ju përmenda, data 28.08, 328 mijë në muaj, e kështu me radhë. Ka edhe këste që janë më të vogla, por ka edhe këste më të mëdha dhe shuma totale e likuiduar është 25 milionë, 919 mijë e 981. Pra, këto janë të mbylljes përfundimtare të rakorduara midis kësteve të lëvruara. Unë nuk di të ketë këste shtesë. E para.

E dyta, duke qenë se u bë një pyetje dhe unë jam i detyruar ta jap shteruese përgjigjen:

- Impianti plus menaxhimin ka kushtuar 13 milionë, 467 mijë e 677 euro.
- Punimet për landfillin janë 10 milionë, 444 mijë e 701 euro.
- Përfundimisht, totali i përputhur me faturat dhe likuidimet, se kam ndjekur

personalisht, është 23 milionë, 912 mijë e 378 euro.

Këto janë shifrat tona të kontabilitetit zyrtar. Unë nuk di financime eksta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa TVSH 23 milionë, me TVSH shkon 26 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po i përmend shifrat. Shifrat përputhen.

Ky është financimi. Mbase nuk ishit në pjesën e parë. Ka edhe një pagesë kredie sovraane të shtuar në vlerën që përmenda.

Kërkoj falje që nuk e përfshiva në shumën totale!

Por në shumën pa kredi sovraane, është kjo.

Jorida Tabaku - Ju lutem, zoti Gështenja, kanë ardhur dy dëshmitarë të radhës.

Lefter Gështenja – Pyetja ime është: për periudhën që e menaxhoni ju këtë koncesion, sa janë shpenzimet mujore? A kemi një vlerë fikse? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë, sa është numri i të punësuarve aktualisht?

Pyetja e tretë, sipas jush, kjo kontratë a është koncesion apo është PPP?

E fundit, a është paguar *fee*-ja koncesionare, siç përcaktohet në kontratë? Nëse po, sa është vlera e paguar?

Faleminderit!

Faraudin Arapi - Ju lutem, mund të jap një përgjigje për pjesën që më takon dhe që kam ndjekur? Mbase zoti Arjan ka një kohë të përshtatshme për sqarime shtesë.

Ne kemi në dispozicion një listë punonjësish nga momenti që e morëm në administrim me datën 14 e në vijim. Pranë landfillit të inceneratorit punojnë rreth 42 punonjës, përfshi edhe kuadrin inxhinierë të kualifikuar që kemi jashtë, që i transferojmë, pasi mbaroi inceneratori i Elbasanit, i lëvizim në Fier, në Tiranë ose në Vlorë. E para.

Vlera e detyrimit mujor që kemi ne, pasi nuk ka më të ardhura dhe projekti ka përfunduar është 3 milionë, 822 mijë e 612 lekë. Kjo është vlera totale e pagesave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Pyeta edhe për *fee*-në koncesionare. A është paguar siç prezantohet në kontratë?

Faraudin Arapi - Nuk është paguar. Ne presim arkëtimet, që të jem i sigurtë, që të shlyejmë detyrimet e prapambetura që ka shoqëria koncesionare. Në momentin që do të arkëtojmë, do të marrim përsipër shlyerjen, sepse kemi detyrimin ligjor të administrimit të shlyejmë edhe ato detyrime që kanë lindur gjatë procesit të administrimit tonë.

Faleminderit!

Lefter Gështhenja – Duke vlerësuar ekspertizën tuaj në këtë fushë, do të doja të dija, a ka lidhje kjo kompani ose të tria kompanitë e inceneratorëve me menaxhimin e kompanive piramidale? Kanë ngjashmëri mes njëra-tjetrës?

Faleminderit!

Faraudin Arapi - Janë fusha të ndryshme dhe janë jashtë objektit tim. Nuk besoj se kanë asnjë lidhje. Skemat piramidale kanë qenë të tjera, menaxhimi që zhvillojmë ne aktualisht ka miradministrim. Ne përgjigjemi para disa institucioneve, siç janë prokuroria dhe gjykata, në raportimet tona mujore për ta miradministruar. Nuk besoj se do të ketë veprimtari të këtij karakteri.

Faleminderit!

Jorida Tabaku - Fjala për zotin Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, kryetare!

Unë kam tri pyetje, që kanë të bëjnë me funksionalitetin aktual, duke qenë se ju administroni nga data 16 dhjetor e në vijim. Nga ana e grupit teknik dhe të ekspertëve, a mund të themi se janë të gjithë aty dhe inceneratori është funksional në vijueshmëri?

Arjan Baçi - Patjetër që grupi i inxhinierëve është aty i gatshëm për të vazhduar punën.

Etjen Xhafaj – Së dyti, si nivel kapaciteti, a ka inceneratori kapacitetin që edhe ato që janë duke u depozituar aktualisht, të incenerohen eventualisht, pavarësisht fluksit ditor?

Arjan Baçi - Kapaciteti i impiantit të përfundimit të mbetjeve në Elbasan është nga 120 deri 140 tonë mbetje në ditë. Ky është kapaciteti mesatar. Nga të dhënat e deritanishme aty janë inceneruar diku 80 deri në 100 tonë mbetje në ditë. Pjesa tjetër e mbetjeve kanë qenë Bashkia e Peqinit dhe Bashkia e Përrenjasit, të cilat nuk kanë çuar mbetje në landfill, në vendgrumbullimin e mbetjeve në Elbasan.

Etjen Xhafaj – Sa i përket fizibilitetit ekonomik dhe financiar të kompanisë, sikur të gjitha funksionet, duke përfshirë këtu edhe kontratën që duhet miratuar eventalisht nga ERE-ja për çmimin e shitjes së energjisë, në qoftë se të gjitha funksionet e inceneratorit janë vënë, si është raporti ekonomik-financiar i kompanisë në një vit funksionaliteti?

Arjan Baçi - Kompania “Albtek Energy” deri tani ka funksionuar me kosto zero të pritjes së mbetjeve nga bashkitë e qarkut të Elbasanit. Të gjithë veprimtarinë e saj e ka mbuluar me të ardhurat nga koncesionari dhe janë disa të ardhura të papërfillshme, të cilat janë të tretët që depozitojnë mbetjet në vendgrumbullim.

Sa i përket çështjes a ka apo jo fitim, është gati e pamundur të dalim sot në këtë rezultat.

Etjen Xhafaj – Pse është e pamundur?

Farudin Arapi - Duke iu përgjigjur pyetjes suaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me Bashkinë e Elbasanit, dua të jem i sinqertë, kemi punuar për të ndërtuar kontratat me shoqërinë “Ecoalb” që ka krijuar kontratat me të gjitha minibashkitë ose bashkitë që përfshihen në qark. Kemi përcaktuar një kosto për mënyrën se si do të bëjë Elbasani për t’i depozituar te inceneratorët për djegie dhe të gjitha minibashkitë e tjera në këtë vlerë.

Realizimi me këtë kosto që kemi pranuar që të realizohet, natyrisht është një studim tregu. Për momentin e parë, meqë ne jemi në fazën e implementimit për inceneratorin e Elbasanit dhe me shitjen e nënprodukteve, se ka edhe nënprodukte të tjera, mbeturinat e qelqit, plastikë, letër e të tjera që realisht ne po i inspektojmë dhe themi se duhen vazhduar për t’i përdorur aq sa i lejon kapaciteti i atyre që gjenerojnë 20% të produktit.

Për mua del me fitim, nuk është me humbje realizimi i këtyre detyrimeve kontraktore të respektueshme. Jam i bindur totalisht, në përgjegjësinë time si specialist që jam.

Etjen Xhafaj – Rezultati financiar i kompanisë publike që i kalon Bashkisë së Elbasanit, atë po thosha, në një vit funksionaliteti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo puna bëni si themi ne, e mos bëni si bëjmë ne, është komplet...

Pyetja ime ishte: ka një plan të fizibilitetit ekonomik dhe financiar të kompanisë, i cili është bërë në bazë të të gjitha parashikimeve që kanë qoftë marrëveshjet, qoftë kontratat koncesionare dhe që parashikohen në një vit normal me atë kosto për ton, me atë kosto që

nxirret nga çdo ton qoftë nga pjesa e përpunimit, qoftë nga pjesa e incenerimit, sa mund të jetë raporti? Pra, në parashikimet ekonomike-financiare sa është raporti i fitimit të kompanisë në një vit normal?

Faraudin Arapi - Në studimin e fizibilitetit që mua më ka rënë në dorë, realisht është me fitim. Për ta parë konkretisht, ne do të na duhet një muaj në kushtet e vënies në punë normalisht dhe në zbatimin e këtyre kontratave që kemi me bashkitë. Pas kësaj ua jap saktësisht. Por studimi i fizibilitetit, i realizuar në momentin që ka filluar, është pozitiv.

Belind Këlliçi - Faleminderit!

Unë kam një set pyetjesh koncize, të ndara fillimisht për Albtek-un dhe më pas për ITS-në.

Për Albtek-un dua t'ju pyes konkretisht, zoti Baçi, në mos gaboj, në lidhje me disa kompani që janë fiktive dhe kanë lëshuar fatura të drejtuara Albtek-ut me pretendimin se janë nënkontraktorë tuajt. Nga një hetim dhe hulumtim i dokumenteve që kemi bërë rezulton se Albtek-u nuk ka bërë pagesa për to dhe rezulton që është debitor. Këto kompani që do t'ju përmend janë kompani që lëshojnë fatura për përfitimin e TVSH-së dhe për të fryrë kostot, në mënyrë që të tregohet sikur janë bërë dhe justifikohen punimet që ka marrë përsipër Albtek-u për të realizuar.

Më konkretisht, interesohem për kompaninë “Pëllumbi 2015”, që ka kryer punime në vlerën 512 milionë lekë; “SG Logistic” ka kryer punime ose shërbime në vlerën 482 milionë lekë; “Xhevi Inert” në vlerën 76 milionë lekë dhe “AMCO&CO” në vlerën 70 milionë lekë.

Dua ta di se çfarë punimesh kanë kryer këto kompani për ju?

Arjan Baçi – Nga momenti i marrjes në dorëzim Albtek-u ka pasur vetëm dy kontrata me kompanitë e tjera, ka qenë kontrata për konsulencën financiare dhe juridike. Të dyja këto kontrata janë ndërprerë nga ana e administratorit, ndërsa për periudhën para se ne ta marrim në dorëzim kjo është pjesë e hetimit nga SPAK, kështu që nuk mund t'i japim përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Belind Këlliçi- Nëse është spekuluar, provojeni ju që është spekuluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po tani, pse shqetësoheni ju më shumë se këta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Belind Këlliçi - Unë kam një kërkesë, nëse unë po spekuloj, dhe nuk po them të vërtetën, e kanë fare kollaj administratorët të më thonë se nuk po them të vërtetën. Kaq pse shqetësoheni ju më shumë se këta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëri, unë po bëj pyetje bazuar në informacionin që unë disponoj.

Jorida Tabaku – Zoti Këlliçi, ju lutem, drejtojuni dëshmitarëve!

Belind Këlliçi – Zoti Baçi, ju po më thoni se, si administrator i “Albtek Energy”, për këto katër kompani që kanë kryer punime në vlerën 1,1 milionë dollarë, për “Albtek Energy”, ju si administratorë sot nuk keni asnjë informacion se çfarë punimesh kanë bërë, edhe pse i kanë bërë para se ju të emëroheshit?

Arjan Baçi - Administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara veprojnë në bazë të ligjit nr. 10192 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” ose ndryshe quhet ligji antimafia. Pjesë e punës së administratorëve nuk është hetimi i punës së një shoqërie ose një kompanie, ose ku e di unë të një individi para se ne të fillojmë punë. Pjesë e punës së administratorëve është momenti i administrimit në mënyrë korrekte dhe po të jetë mundur rritja e vlerës së këtyre pasurive në momentin që ne bëjmë marrjen në dorëzim të pasurive. Për këtë ne nuk mund të themi se a kanë qenë fiktive faturat e mëparshme, a ka lëshuar fatura “Albtek”, apo jo.

Belind Këlliçi – Mua më bën përshtypje që për disa kompani, që kanë kryer punime në vlerën 1,1 milionë dollarëve, ju nuk keni asnjë informacion, sepse vlera nuk është e vogël.

Arjan Baçi - Administratorët e marrin në dorëzim ata të pasurive.

Belind Këlliçi – Meqë përmendet pjesën e kontratave, që keni për konsulencë dhe për raportet financiare, në dijeni në time nga studimi i fizibilitetit për projektin e inceneratorit të Elbasanit, hartuar nga Ministria e Mjedisit, rezulton se në analizën financiare të projektit janë parashikuar të gjitha kostot e realizimit të projektit, përfshirë shpenzimet fillestare, kostot kapitale, ato operative dhe të mirëmbajtjes që në fillim. Tani, nga verifikimi pagesave rezulton se Albtech Energy ka paguar rreth 580 milionë lekë, “Zoto Consulting” sh.p.k, krijuar në vitin 2017 me 90% ortak Klodian Zoton, dhe “Consulting SE Partner’s” Stela Gugallja; Zoto ka marrë 320 milionë lekë dhe Stela Gugallja 260 milionë lekë. A mund të më tregoni, ju lutem, për çfarë shërbimesh u janë paguar 580 milionë lekë zotit Zoto dhe zonjës Gugallja nga kompania, që janë vetë pronarë.

Arjan Baçi – E thashë këtë pak më parë, ne fillojmë punë në momentin e marrjes në dorëzim të pasurive dhe dokumentacionit. Aty gjetëm që “Albtek Energy” kishte dy kontrata me të dyja këto firmat që përmendët dhe të dyja këto kontrata janë ndërprerë.

Jorida Tabaku – Ju lutem, kolegë, nuk e kuptoj, nuk është përsëritje, pyetjen e bëra unë, i kërkova zotërisë të ma depozitojë si provë në komision, bëhet fjalë për një skemë të pastrimit të parave, mos e merrni kaq lehtë!

Arjan Baçi – Kam pasur dy kontrata në vlera të ndryshme, diku te 7 milionë lekë të vjetër për secilën kompani. Nëse janë të ligjshme apo janë të paligjshme, kjo nuk është në përgjegjësinë time ta them, sepse nuk jam organi hetues ta them ose jo, por në momentin që ne

e kemi marrë në administrim, në zbatim të dispozitave që ka ligji për administrimin e pasurive, kemi kërkuar ndërprerjen e këtyre kontratave. Nga ana e Albtek, nga marrja në dorëzim e këtej, nuk është bërë asnjë pagesë për këto dy kompani.

Belind Këlliçi – Dakord. Në studimin e fizibilitetit, me aq sa unë jam në dijeni dhe kam informacion, nuk parashikohet as ky zë për konsulencën, që nuk është një zë i vogël, kushton 500 mijë euro, dhe as një zë tjetër, që ka të bëjë me shpenzimet udhëtimesh, që është 74 milionë lekë. Tani, a mund të më tregoni se për çfarë janë shpenzuar 74 milionë lekë për udhëtime për inceneratorin e Elbasanit?

Arjan Baçi – Kompania nuk është imja, unë jam një administrator i vendosur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe kam marrë punën në datën 14 dhjetor të vitit 2021. Nga momentet para të kësaj date mund të thërrisni administratorët që kanë qenë për t'u kërkuar llogari. Unë nuk e kam idenë pse janë marrë dhe pse janë bërë këto pagesa.

Belind Këlliçi - Edhe pse jeni emëruar në dhjetor të vitit 2021, a keni informacion, a jeni debitor apo i keni shlyer detyrimet për këto shërbime që keni marrë? A e dispononi këtë informacion?

Arjan Baçi- Po, kam një informacion nga zyra e financës, detyrimet janë shumë më të vogla, diku të 3 milionë lekë të rinj për t'u shlyer, pra detyrimet e prapambetura të Albtek-ut.

Belind Këlliçi- Një pyetje të fundit për ju, nëse ju kujtohet, në lidhje me një nga punonjësit që mban pozicionin më të lartë dhe paguhet më lart te ju, zoti Renardo Nallbani, dua të di çfarë pozicioni mban tek “Albtek Energy”?

Arjan Baçi – Patjetër, Renaldo Nallbani ka qenë drejtor i “Albtek Energy”, ka pasur një pagë që e merrte nga Albtek-u, por në momentin që ne e kemi marrë në dorëzim të gjithë punonjësit e Albtech Energy kanë dhënë dorëheqjen. Sot që flasim kjo shoqëri ka zero punonjës. Të gjitha shërbimet i ka me nënkontraktorë.

Belind Këlliçi – Sot që flasim zotëria nuk figuron i punësuar më pranë jush.

Arjan Baçi – Jo.

Belind Këlliçi – Faleminderit!

Kam një pyetje për zotin Farudin Arapi. Unë dua t'ju pyes në lidhje me ITS-në kompaninë, ku ju jeni administrator. Meqë ITS-ja ka pasur angazhim në të tre inceneratorët, dua t'ju pyes për disa kompani, që rezultojnë që janë me dy punonjës, pa mjete dhe që janë të dënuara nga Gjykata e Apelit për mashtrim dhe evazion fiskal. Unë dua të di nga ju, në lidhje me dy kompanitë që do t'ju përmend tani: çfarë punimesh kanë kryer këto kompani për ITS-në, që i janë faturuar shumat, që unë do t'i përmend? A u keni bërë ju pagesa këtyre kompanive

për faturat që ju kanë lëshuar? A keni rimbursuar TVSH-në në lidhje me këto fatura? Nëse po, do të dëshiroja që këto fatura dhe ky dokumentacion t'i vihet në dispozicion këtij komisioni.

Më konkretisht ju pyes për kompaninë “**AMCO&CO**”, që ju ka faturuar me vlerën 900 milionë lekë, 9 milionë dollarë. Ju pyes për kompaninë “**ELVIS-03 GROUP**” që ju ka faturuar rreth 4 milionë dollarë, ju pyes për kompaninë “**Alfa Pouer Group**” në vlerën 4 milionë dollarë, ju pyes për “**Elvis CO**” në vlerën 1,6 milionë dollarë, ju pyes për “**Lumi 06**” në vlerën 1 milionë dollarë; “**Alber Co&Co**” në vlerën 1 milionë dollarë; “**AA117**” në vlerën 1,2 milionë dollarë; “**PM&A Company**” në vlerën 1,5 milionë dollarë; “**GLE Van**” 1 milionë dollarë; “**EZ& LA**” në vlerën 7 milionë dollarë, “**PUPA services**” në vlerën 22 milionë dollarë; “**Frogy**” në vlerën 28,4 milionë dollarë; “**Deleli 17**” në vlerën 3,3 milionë dollarë, totali, për vlerën që ju pyeta, i operacioneve fiktive në gjykimin tim, po dua një përgjigje nga ju, është në vlerën 25 milionë dollarë dhe totali i TVSH-së së përfituar është në vlerën 5 milionë dollarë.

A mund të më jepni përgjigje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mos u shqetëso është për të tre inceneratorët kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, unë e kuptoj që ju qeshni kur flitet për pastrim parash, se nuk ka problem për qeverinë, po, zoti Arapi, a mund të më jepni një përgjigje për çka ju pyeta?

Farudin Arapi – Faleminderit!

Atëherë, po sqaroj se duke qenë se ju keni përmendur kompani, të cilat përfshihen në lidhjet kontraktore që ka ITS-ja me këto kompani dhe nëse janë për inceneratorët e tjerë. Ju them që për Elbasanin fillimisht vlera e këtyre faturave, e cila është hetuar dhe ka dalë në materialin e gjykatës. Për të cilin i gjithë dokumentacioni fillestar u është përcjellë nga ana jonë organeve të hetimit është dhënë një shifër 3,6 milionë lekë detyrime me fatura. Mund të jenë fiktive, por organi i hetimit po i heton. Për këtë vlerë prej 3,6 milionë lekësh, si kolateral, është marrë fabrika e prodhimit të pijeve alkolike të Durrësit, pra si garanci. Nëse do të vërtetohen, kur të përfundojë procesi hetimor, për vlerën që përmenda më sipër, por gjithmonë ka një vlerë x, atë që përmenda 3,6 milionë euro.

Për sa u përket pjesëve të tjera, nga momenti që personalisht jam futur si administrator i këtyre kompanive, pra i kompanisë ITS-së, nuk likuideoj asnjë fond, e kam detyrim ligjor që detyrimet e prapambetura të mos i shlyej dhe nuk e kam bërë, pra nuk kam firmosur aktualisht në këtë 1 muaj e gjysmë fatura, të cilat janë të ekzekutueshme dhe kanë këto benefite që ju përmendët. Unë realisht likuideoj vetëm disa fatura, të cilat kanë ardhur me doganë, janë pjesë e projekteve për vazhdimësinë e procesit dhe nuk likuideoj asnjë lloj fature për punimet, qoftë të prapambetura, dhe kur janë të prapambetura e kam ligjore që jo.

Belind Këlliçi – Atëherë, meqë ju administroni kompaninë, a mund të na vendosni në dispozicion fatura të mëparshme të vitit 2021, sepse ju i dispononi si dokumentacion, që janë likuiduar më përpara për këto kompani që unë përmenda.

Farudin Arapi – Po, i marr, për shoqërinë “Albtek Sh.p.k”, të gjitha faturat janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’ju lutesha shumë është një volum, të gjitha faturat që kanë të bëjnë me shpenzimet që janë likuiduar për këtë shoqëri i janë përcjellë organit të hetimit dhe i ka organi i hetimit. Kanë ardhur te ne oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë bërë sekuestrimin total, kanë marrë edhe njësitë përkatëse të tyre dhe për sa kohë ato janë në proces hetimi, unë nuk kam dokumentacion tjetër për këtë shoqëri “Albtek” për faturat, kam vetëm përmbledhëset e likuidimet që ju kam përmendur më sipër. Për shoqëritë e tjera, duke qenë se nuk janë pjesë e procesit të hetimit, nuk ka asnjë material kallëzues as për Fierin, as për Tiranën, këto fatura janë pjesë e kontabilitetit, të cilat përcillen, i ka zyra e kontabilitetit, është një volum shumë i madh, nuk e di nëse kërkohet nga ana juaj konkretisht, do të saktësoj zyrën e kontabilitetit që t’ju sjellë një përmbledhëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëjeni dhe ta shikojmë nëse është e mundur.

Jorida Tabaku – Po e bën këtu në seancë, po kërkon këto fatura që të administrohen si prova dhe të na i dorëzoni.

Farudin Arapi – Të kujt, fatura të kujt, ju lutem, konkrete?

Jorida Tabaku – Faturat që citoi zoti Këlliçi, të këtyre kompanive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Farudin Arapi – Atëherë, sillni një kërkesë për secilën nga shoqëritë, cilët janë preventivi, situacionet dhe mënyra e likuidimit të fondit, besoj janë të gatshme të jepen nuk ka asnjë lloj problemi.

Edmond Spaho – Pyetja e fundit, zoti Bushati ma kalon radhën mua.

Zoti Arapi, për ta bërë më të thjeshtë që ta kuptojmë dhe ne të komisionit, por dhe qytetarët që na ndjekin, shteti shqiptar i ka dhënë 26 milionë euro kompanisë për të ndërtuar inceneratorin. Në momentin që ju e keni marrë në dorëzim në arkën e kompanisë keni gjetur vetëm 5 mijë euro gjendje, detyrimet e prapambetura të kompanisë janë, në mos gabohem, rreth 5 milion euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa? Për inceneratorin e Elbasanit?

Farudin Arapi - Nuk e di sipas bilancit. Sipas të dhënave të marra nga zyra e financës që mban kontabilitetin e kësaj selie është kredia sovrane që është në vlerën 4 milionë lekë të

rinj dhe detyrime të prapambetura në vlerën 3,3 milionë lekë të rinj. Pra, këto janë detyrimet e Albtek-ut.

Edmond Spaho – Pra, të gjitha detyrimet janë diku tek rreth 100 mijë dollarë, i bie për afërsisht nga ajo çka thatë ju dhe këto do të shlyhen me të ardhurat e inceneratorit, 100 mijë dollarë. Pasi dëgjova detyrimet e prapambetura janë 5 milionë euro sipas bilancit të dorëzuar në QKB.

Farudin Arapi – Komunikimi me zyrën e financës është shkresorë dhe nga e-maili që kam marrë nga zyra e financës që mban kontabilitetin janë të dhënat që sapo thashë. Ligji për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara ka përcaktuar dhe nuk i njeh si detyrime të prapambeturat, pra nga ana e administratorit nuk shlyhen këto detyrime, madje, nëse do të ketë konfiskime të këtyre pasurive as bankat nuk përfitojnë nga kolaterali i vënë, pra, këto janë dispozita në ligjin e administrimit të pasurive.

Jorida Tabaku –Zoti Bushati, shumë shkurt, ju lutem!

Helidon Bushati – Unë kam dy pyetje për zotin Arapi, për dividendin. Sa është rezultati financiar i 2020-ës për Elbasanin? Ju keni një fat edhe ne që ju pyesim, sepse keni eksperiencë nga kur ka lind celulari deri tani që Kryeministri zgjidh hallet e popullit në *Tik-tok* në celular, prandaj po ju them ju se keni më eksperiencë në këtë gjë dhe po ju drejtohem ju, meqenëse u përgjigjët për dokumente financiare të “Albtek”. Sa është rezultati financiar i bilancit të vitit 2020 për Elbasanin?

Farudin Arapi – Duke qenë se Albtek-u për vitin 2020 ka dalë me një normë fitimi, të cilët ju përmendët nga raporti

Helidon Bushati – Jo normën e fitimit, sa është rezultati, sepse norma e fitimit është tjetër.

Farudin Arapi – Atë normë fitimi, dividend që ka realizuar, e ka rishpërndarë sot, ose në periudhën që ka filluar nuk disponon me gjendje vlerore në llogaritë e saj.

Helidon Bushati – Zotëri, jo më kot ju bëra edhe elozhe për eksperiencën e gjatë në administrim. Sa është rezultati financiar i vitit 2020,?

Farudin Arapi – Bilanci me rezultat financiar në kushtet e një sigurimi të ardhurash jo nga energjia elektrike dhe as nga tarifatat e vendosura është 0.

Helidon Bushati – Më fal, i keni bilancet aty të 2020, sa del ?

Farudin Arapi – Bilancin nuk e kam, por e di që është 0.

Helidon Bushati – Zonja Tabaku sa është? A mund ta kem si shifër bilancin e 2020-ës.

Anila Denaj - Bëj pyetje, a je përgatitur, mos na merr kohë edhe një herë, ose nuk doni t'i merrni të gjithë në intervistë, apo si doni këto.

Helidon Bushati - Atëherë, zonja Denaj, unë e kuptoj që koha juaj është flori, që keni gjëra shumë më të shtrenjta për të bërë se sa për të qenë në komision, por ky është detyrim që të rrimë në komision dhe për të vlerësuar.

(Diskutime në sallë.)

Zonja Denaj, në qoftë se jeni këtu për të bërë zhurmuesin është një diçka që nuk sjell lekë, kështu që mund të shkoni dhe të kryeni ato aktivitete që ju sjellin lekë, pa problem, po jo zhurmuesin.

Në qoftë se është orari i zhurmës, na thoni dhe e ndalim.

(Diskutime në sallë.)

Meqenëse nuk doni të përgjigjeni, zoti Arapi, po bëj edhe pyetjen e dytë.

Zoti Arapi, gjatë këtij muaji që ju po administroni koncesionin e Fierit, ka pasur vonesa, pasi dihet, jemi shumë me vonesë, a keni ju një raport përmbledhës të specifikuar, të detajuar për sa u përket vonesave dhe nga cilat institucione kanë ardhur këto vonesa?

Farudin Arapi – Duke qenë se nuk është pjesë e procesit, unë zotëroj kapitalet në ndërtimin e landfillit dhe inceneratorit. Nuk kam ndonjë raport, sepse realisht nuk ka përfunduar procesi i mbylljes së kontratës. Në momentin që do të përfundojë mbyllja e kontratës, do të nxjerr bilancin faktik të saj.

Helidon Bushati – Këtë radhë nuk kishte lidhje me bilancin, kishte lidhje me punimet, me vonesat në punime, të cilat kanë sjellë edhe shtyrjen e afatit të inceneratorit që nuk është vënë akoma në punë. Kjo ishte pyetje, nuk ishte për bilancet financiare, për pasqyrat financiare, por ishte për evoluimin e punimeve.

Farudin Arapi – Ne si institucion, ITS-ja, merr çdo muaj grafikun e realizimit të punimeve dhe realisht për periudhën që jemi në vijimësi, të periudhës dymujore, nuk kemi lënë asnjë moszbatim të detyrimeve për realizimin e programit të kontratës, pavarësisht nga shtyrja që ka pasur në periudhën para kohore, para nesh.

Helidon Bushati – Kjo është një kërkesë për informacion. Ju lutem, a mund t'i sillni këtu raportet tremujore që koncesionari gjatë gjithë periudhës? Është detyrim kontraktual, pikë kontraktuale, që koncesionari të raportojë pranë autoritetit kontraktor çdo tre muaj për ecurinë e punimeve dhe për vonesat. A mund t'i ketë ky komision të gjitha raportet që janë bërë nga koncesionari në këto vite pranë autoritetit kontraktor për Fierin?

Farudin Arapi – Në përputhje me kërkesën që e bëtë dhe që duhet të vijë edhe në agjenci, do t'i drejtohem koncesionarit dhe institucionit përkatës që është atje për të na vënë në dispozicion dhe do t'ju sjellim.

Ne nuk i disponojmë, sepse nuk është objekt i punës sonë në momentin e tashëm. Ato janë dosje dhe praktika që mbahen në zyrat e koncesionarit.

Jorida Tabaku – Atëherë, i falënderoj kolegët për pyetjet dhe zotërinjtë që erdhën këtu!

Zoti Arapi dhe zoti Baçi, dua t'ju kërkoj që të gjeni dhe të lexoni me shumë kujdes vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 792, që është kontrata koncesionare për 25 vjet për inceneratorin e Elbasanit, që unë e kam këtu, që do ta diskutojmë edhe në vijim, i cili ishte një informacion që ju nuk e dinit, sepse është një aset që duhet ta administroni, meqenëse administroni asetet e kompanisë.

E përfundojmë seancën e pyetjeve për dëshmitarët aktualë.

Do të bëjmë 5 minuta pushim.

Urdhëroni për procedurë, zoti Shalsi!

Ndjesë, zoti Shalsi!

Zoti Arapi, ju kërkoja që të administroja si provë listën e nënkontraktorëve që më thatë se e kishit me vete.

Faraudin Arapi – Listë me emra nënkontraktorësh nuk kam. Kam vetëm shpenzimet faktike që janë kryer dhe janë realizuar për realizimin e projektit të programit të inceneratorit të Elbasanit.

Jorida Tabaku – Po pate mundësi, ta depozitojmë si provë dhe ta administrojë sekretaria!

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja kryetare,

Siç e keni vënë re, nuk kam ndërhyrë gjatë ditës së sotme. Ka rreth 2 orë e gjysmë që vijon me pyetje. Ju e dini qëndrimin tim dhe i respektoj kolegët e opozitës, sidomos për pyetjet, por kam një kërkesë, të përsëritur në fakt, për të qenë sa më efikas.

Duke marrë në konsideratë numrin e madh të dëshmitarëve, do t'u kërkoja të gjithë kolegëve të jemi sa më racionalë te pyetjet, duke shmangur çdolloj interpretimi apo komenti, pasi bëhen pyetjet.

E dyta, dua t'u kërkon kolegëve deputetë se nuk kemi atributin e hetimit. Zot të hetimit janë prokuroria dhe gjykata dhe sa më racionalë të jemi ne në pyetjet që u drejtojmë dëshmitarëve, aq më efikase do të jenë mbledhjet, e theksoj, pa dashur në asnjë mënyrë që të vë në dyshim pyetjet.

Ajo që ju kërkoj, nisur edhe nga volumi i punës, është mbarëvajtja e seancave të tilla dëgjimore ku ne duhet t'i përmbahemi planit të hetimit dhe rolit tonë që assesit nuk mund të zëvendësojë as prokurorinë, as gjykatën.

Debatet e ditës së sotme le të na shërbejnë të gjithëve për të qenë më racionalë dhe për të arritur drejt asaj që, si ju që e keni iniciuar, edhe ne do të donim të kuptonim më mirë. Në këtë mënyrë, edhe ju keni një rol përtej nesh në modelimin sa më adekuat të mbledhjes.

Nëse do të vijojmë, aty jashtë është një zotëri në moshë që ka më shumë se një orë që pret, janë edhe të tjerë në radhë, prandaj do t'ju lutesha që të jemi sa më efikasë edhe në mënyrën se si i drejtojmë pyetjet, duke mos harruar asnjëherë që është shumë e rëndësishme se çfarë pyesim, por edhe mënyrën se si pyesim.

Këtë doja të sillja në vëmendjen e të gjithë kolegëve.

Jorida Tabaku – Ju falënderoj, zoti Shalsi!

Dua t'u kujtoj zotërinjve para se të largohen se zonja Denaj kërkoi raportet e monitorimit të mjedisit, që ndoshta ju mund t'i keni dhe t'ia sillni këtij komisioni.

Zoti Këlliçi kërkoi që të administrojmë faturat e disa kompanive që i renditi.

Zoti Bushati kërkoi raportet tremujore nga koncesionari.

Unë ju kërkova listën e nënkontraktorëve me shpenzimet.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Duke parë listën e dëshmitarëve, hasa edhe drejtorin e një autoriteti, siç është Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit, kam një sugjerim për të gjithë kolegët deputetë që disa pyetje specifike mund t'ua adresojmë edhe personave më kompetentë që mund të na ndriçojnë më mirë me përgjigjet e tyre, duke qenë se janë pjesë e fushës.

Edmond Spaho – Do të na përsëritet historia me zonjën Denaj prapë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe mos ta hapim më këtë muhabet! Racionaliteti është i domosdoshëm.

(Pas pushimit.)

Jorida Tabaku – Në qoftë se kemi kuorumin, të nderuar kolegë, e rifillojmë mbledhjen.

Zotin Aleksë e kam thërritur unë si dëshmitar. Sigurisht që këdo tjetër, që ka dëshirë t'i bëjë pyetje zotit Aleksë, ne mund ta shtojmë.

Zoti Aleksë, unë mora spunto për t'ju thirrur si dëshmitar pas një interviste publike që dëgjova nga ana juaj në lidhje me procesin e depozitimit të dherave në landfillin e Sharrës, në trajtimin e impiantit të mbetjeve në landfillin e Sharrës, ndërkohë që ju dëgjova, kam nxjerrë direktivat e BE-së për këtë çështje, kam nxjerrë njëkohësisht edhe ligjin shqiptar që në kohën e Fatos Nanos në vitin 2005, ndryshimet përkatëse që i janë bërë ligjit edhe në vitin 2015, njëkohësisht edhe vendimin për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve.

Përpara se të filloj pyetjet, dua të bëj vetëm një koment të shkurtër. Administratorja e landfillit të Tiranës, e impiantit të Tiranës, ishte këtu prezente në këtë komision dhe na dëshmoi që ne marrim një tarifë nga depozitimi i mbetjeve.

Unë e pyeta zonjën a është e vetmja tarifë që ju merrni dhe zonja e konfirmoi edhe një herë, ndërkohë që, duke hapur faqen e internetit të kompanisë që administron landfillin e Sharrës, shikoj që këtu nuk ka vetëm një tarifë për mbetjet, por këtu ka edhe një tarifë që i është shtuar kontratës koncesionare për dherat.

Shqetësimi që ne kemi këtu, është që kjo tarifë koncesionare për dherat, e shoqëruar me një vendim të këshillit bashkiak për tarifën e dherave, është një aktivitet shtesë i kontratës fillestare koncesionare të inceneratorit të Tiranës, e cila ka bërë disa llogaritje për fitimet e kështu me radhë.

Përpara se të fillojnë, unë dua t'ju kujtoj që, bazuar në rregulloren e brendshme të komisionit, neni nr. 18, dëshmia nga ju do të merret pasi ne të kryejmë betimin.

Neni 360 i Kodit të Procedurës Penale “Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit”, ju lutem, përsëritni pas meje!

“Beto het se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë. Beto hem!”

Luigj Aleksi – Beto hem!

Jorida Tabaku – Shqetësimi që unë kam, dhe që po diskutojmë si objekt i këtij komisioni hetimor, është që kemi pasur një kontratë koncesionare fillestare, e cila presupozonte që do t'i merrte të ardhurat nga depozitimi i mbetjeve, shitja e energjisë nga skrapit. Kësaj kontrate fillestare i është shtuar një shërbim tjetër shtesë, për të cilin unë ju dëgjova kur po e shpjgonit.

Do të kisha nevojë që t'i informoni anëtarët e këtij komisioni për situatën se si është sot.

Luigj Aleksi – Faleminderit!

Unë shumë shkurtimisht do të informoj që ne si ndërtues jemi të lidhur ose të ndërlidhur me këtë problem që trajtohet nëpërmjet dy VKM-ve. VKM-ja e parë, nr. 99, datë 18.02.2005, i zotit Nano, ku është miratuar katalogu shqiptar i klasifikimit të mbetjeve. Në këtë katalog, neni nr. 17 është i vetmi nen që na takon ne, ndërtuesve, shkruhet: “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara).”.

Pastaj lidhemi me VKM-në nr. 575, datë 24.06.2015, ku miratohen kërkesat për menaxhimin e mbetjeve. Sipas këtij vendimi, ne quhemi të detyruar si zotërues të mbetjeve dhe prandaj duhet t'i ruajmë, t'i transportojmë dhe t'i dorëzojmë ato në landfill. Efektivisht, me nenin 17 dhe me vendimin nr. 99, ne si ndërtues nuk kemi absolutisht asnjë objeksion. Të gjitha

mbetjet që dalin nga ndërtimet, të gjitha prishjet që dalin nga ndërtimet dhe të gjitha gërmimet që bëhen në zona të helmuara, ne jemi dakord t'i depozitojmë dhe të paguajmë të gjitha taksat dhe tarifatat që vendosen.

Faktikisht, ne, me një vendim që nuk e dimë, vendimi nuk ekziston, por nga bashkia detyrohen ndërtuesit të shkojnë të lidhin marrëveshje të veçantë me përfaqësuesit e landfillit dhe për të gjitha llojet e dherave që gërmohen duhet të paguajnë një taksë, sikur këto janë mbetje inertesh. Të konsiderosh dheun mëmë që gërmon mbetje është një gjë pa sens, është një gjë komplet e palogjikshme dhe e paligjshme dhe këtë unë do ta them shumë saktë se vendim nr. 99 e ka përcaktuar qartë.

Pika 1 e vendimit nr. 99 të qeverisë konfirmon që katalogu i klasifikimit të mbetjeve është në përputhje me katalogun europian të mbetjeve dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pika 3 e kësaj VKM-je detyron që edhe katalogu shqiptar i mbetjeve duhet të rishikohet dhe të plotësohet sipas ndryshimeve që pëson katalogu europian i mbetjeve.

Lista e mbetjeve europiane ose katalogu europian...

Jorida Tabaku – A mund t'ju ndërpres pak?

Unë e kam nxjerrë edhe direktivën, edhe listën, kam nxjerrë edhe listën së cilës ju i referoheni.

Luigj Aleksi – Dua vetëm 2 minuta kohë.

Jorida Tabaku – Patjetër, ju na pritët 2 orë.

Luigj Aleksi – Në katalogun europian të mbetjeve, i cili është miratuar me vendimin e Komisionit Europian 2000/EC dhe sipas aneksit III të direktivës 2008/98EC ky aneks, neni 1, parashikon që kjo direktivë europiane përcakton masat për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Në lidhje me menaxhimin e dheut si mbetje, aneksi III i direktivës nuk parashikon asnjë detyrim ligjor për ta depozituar në landfill, madje nuk parashikon as edhe një mënyrë të veçantë për ta trajtuar atë.

Konkretisht, neni 2, pika 1, germa “c” e kësaj direktive shkruan: “Përfshihet nga fushëveprimi i kësaj direktive toka e pakontaminuar dhe materiale të tjera natyrore të gërmuara gjatë aktiviteteve ndërtimore”.

Ky është fakt, kjo është esenca e problemit në një kohë kur ne çdo metër kub dhe që çojmë në landfill, detyrohemi ta paguajmë si mbetje, kur ky dhe është mall, është vlerë, të cilën ne e bëjmë lulishte, e bëjmë argjinatura, duhet ta çojmë dhe t'i japim pronarit të landfillit edhe një taksë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta them, sepse ajo varion, ajo miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Do t'jua them me përfaqësi, ne nuk e kemi taksën e asaj, por luhatet nga 350-400 lekë për ton, gati 700 lekë për metër kub taksë. Në një kohë që ky dhe, që çojmë në landfill për landfillin është lëndë e parë. Ai pasuron landfillin, jo e helmon landfillin. Për këtë motiv që në vitin 2018, kur doli ky problem, ne i kërkuam bashkisë, me thënë të drejtën, takim, kemi zhvilluar takim, kemi marrë dhe përgjigje që nuk ishte e tillë, ku bënin të paditurin dhe nuk na kanë treguar asnjëherë: “Jemi njëjloj si ju, jemi klientë”. Në fakt, ata miratojnë çmimin, ata na detyrojnë të shkojmë të bëjmë marrëveshjen me landfillin. Në këtë kuptim, përveç takimit në vitin 2013 dhe jo vetëm ne, por kemi qenë bashkë me *Biznes Albania*, ka firmosur edhe Bregasi, bashkë me Dhomën e Tregtisë ka firmosur Nikolin Jakaj. Këto letra i kanë shkruar bashkisë, është bërë takim në bashki. Në vitin 2018 po kjo treshe i kanë shkruar edhe Ministrisë së Turizmit, zotit Klosi, që ka qenë në atë kohë ministri, Gjiknurit, ministër i Infrastrukturës, dhe zonjës Sonila Qato, ministre e Shtetit për Sipërmarrjen. Kjo situatë nuk është korrigjuar ende deri sot.

Jorida Tabaku – E kam shumë të qartë, e kam nxjerrë direktivën, është pikërisht kështu siç thoni ju, e kam shumë të qartë situatën, por, duke u përpjekur për të gjetur se cili është akti i bashkisë që ju detyron të shkoni atje, nuk e kam gjetur dot.

Luigj Aleksi – As ne nuk e kemi.

Jorida Tabaku – Si ju detyron ju bashkia të shkoni te koncesionari?

Luigj Aleksi – Nuk jep lejen e ndërtimit. Do shkosh të bësh marrëveshjen dhe të marrësh lejen.

Jorida Tabaku – Kjo është zyrtare me një shkresë, apo ju thonë drejtorët?

Luigj Aleksi – Nuk e dimë, neve na thonë: “Shkoni dhe bëni këtë punë”.

Jorida Tabaku – Cili institucion i bashkisë nuk u jep lejen pa kryer marrëveshjen me inceneratorin? Është informale, bashkia ju bën presion që të shkoni të firmosni tek inceneratori kontratën?

Luigj Aleksi – Jo, nuk mund të thuhet presion. Do të bëni marrëveshje me inceneratorin, do të paguani taksat.

Jorida Tabaku – Nuk ka asnjë akt zyrtar dhe, çuditërisht, as unë nuk kam.

Luigj Aleksi – Ne si shoqatë nuk kemi. Jua thashë në vitin 2018 kemi kërkuar takim me bashkinë, kemi folur me bashkinë dhe na është thënë nga bashkia: “Jemi klientë njëjloj si ju”. Kjo është përgjigja që na është dhënë.

Jorida Tabaku – Ndërkohë, unë arrita të gjej në faqen e kompanisë së inceneratorit tarifën dhe është tarifa që thoni...

Luigj Aleksi - Tarifën nuk janë publikuar.

Jorida Tabaku – Jo, nuk ka asnjë vendim zyrtar, asnjë institucion zyrtar nuk ka, ndërkohë që inceneratori thotë: “Për dherat dhe për inertet e përmendura, janë nga 350 lekë deri 20 mijë lekë për ton, në varësi të kategorizimit”, e kanë lënë të hapur. Shqetësimi që kemi si komision, është: kemi një kontratë koncesionare, që i kanë krijuar një volum pune shtesë, për më tepër në mënyrë korruptive, pa akte zyrtare duke krijuar edhe një burim tjetër të ardhurash. Sa gjykoni ju, me ndërtimet që ka në qytetin e Tiranës dhe Durrësit, që është kapaciteti shtesë për inceneratorin e Tiranës nga kjo pagesë?

Luigj Aleksi – Problemi nuk shtrohet ashtu, sepse të gjitha ndërtimet, prishjet, mbetjet dhe dherat nga tokat e kontaminuara duhet të shkojnë. Problemi shtrohet për tokat normale, për dherat normalë. Ju jeni ligjvënës, nesër do të gërmohet qendra e Tiranës për të ndërtuar teatrin, si do ta quajmë atë tokë, ku jemi rritur të gjithë, tokë e helmuar? Si do t’i japim atje koncesionarit 7 mijë lekë të vjetër për metër kub që të na pasurojë tokën?

Jorida Tabaku – Edhe unë e kam shumë të qartë këtë gjë, që nuk duhet të shkohet të depozitohen, por pyetja ime ishte tjetër: sa gjykoni ju, me aq njohuri sa keni nga anëtarët e shoqatës, se mund të jetë volumi i dherave që depozitohet atje?

Luigj Aleksi – Nuk mund ta jap këtë përgjigje.

Jorida Tabaku – Nuk e parashikoni dot.

Luigj Aleksi – Zonja Tabaku, nuk mund ta jap, sepse nuk kemi të dhëna. Kontratat bëhen individualisht, duhet të shkojë çdo subjekt të bëjë kontratën, marrëveshjen me inceneratorin, pastaj ato taksa luhaten nga aq sa thatë ju, por ne nuk i kemi faktikisht.

Jorida Tabaku – Janë në faqen e internetit të kompanisë.

Luigj Aleksi – Taksa varet edhe nga lloji i materialit, sepse mund të ketë materiale helmuese, asbest, xhama, gjëra të tjera që dalin nga prishjet dhe që kërkojnë shumë shpenzime për t’u rigjeneruar.

Jorida Tabaku – Ka pyetje tjetër? Unë nuk kam më pyetje.

Po, zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Mora shkas nga pyetja a ka Bashkia e Tiranës një vendim, një akt, apo jo? Jeni në dijeni që ka një kontratë koncesionare që parashikon një gjë të tillë, që i afekton kompanitë e ndërtimit të bëjnë një gjë të tillë? Për çfarë duhet vendimi në rastin konkret? Nuk e di nëse isha i qartë.

Pra, zonja Tabaku tha a jeni në dijeni të ndonjë akti, që i detyron firmat e ndërtimit të lidhin një marrëveshje me koncesionarin? Pyetja ime: a jeni në dijeni të kontratës koncesionare që është dhënë, e cila parashikon që firmat e ndërtimit...

Thjesht po ose jo.

Luigj Aleksi – Ne nuk kemi asnjë dijeni për këtë punë.

Eduard Shalsi – Pra, nuk keni dijëni që ka një kontratë koncesionare nga e cila lind detyrimi që firmat të hyjnë në marrëveshje të tillë me koncesionarin.

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk dua të hyj në komente, në interpretime, thjesht mora shkas nga pyetja.

Jorida Tabaku – E ka kërkuar fjalën zoti Lefter Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit!

Për të vazhduar, edhe pse bashkia nuk ka ndonjë urdhër të shkruar apo nuk kemi një vendim të qeverisë, duhet thënë një e vërtetë që nga momenti kur ka filluar punë kompania e inceneratorëve, Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit janë në dispozicion të këtij koncesionari, që do të thotë në momentin që zotëria apo kolegët, kompanitë e ndërtimit nisin gropën, menjëherë atje ke Policinë Bashkiake, e cila komunikon me inceneratorin, asnjë kamion nuk mund të shkojë në destinacion tjetër dhe pse nuk është shkruar asgjëkund, por Policia Bashkiake dhe Policia e Shteti janë në dispozicion të inceneratorit për të dërguar të gjithë sasinë e gërmuar atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Mund të flisja më gjatë, mund të jepja edhe një opinion, mund të bëja edhe komente, por, duke ditur përgjegjësinë që kam përpara këtij komisioni, do t'ju lutesha edhe njëherë ju dhe cilitdo tjetër që t'i shmangim komentet. Di të bëj komente dhe di të sqaroj në lidhje me kontratën apo se detyron apo pse. Ne jemi këtu për të bërë pyetje, nuk jemi për të bërë komente.

Ju lutem Shumë!

Jorida Tabaku – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Meqenëse ju jeni në fushën e ndërtimit që pa lindur telefoni celular, vazhdoni edhe sot ende të jeni në këtë fushë? Besoj se jeni njeriu më me eksperiencë për ta pyetur për situatën e mbetjeve ndërtimore në qytetin e Tiranës. Fakti që sot i është dhënë një zgjidhje e tillë, konsiderohet në shërbim të qytetarëve nga ana juaj, po apo jo?

Luigj Aleksi – Çfarë është përshkruar në vendimin nr. 99 po e lexoj edhe një herë: “Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet, përfshi dherat e gërmuara nga zonat të kontaminuara, veprimi është shumë i drejtë”. Ne jemi ankuar vetëm për dherat nga zonat të pakontaminuara.

Arben Pëllumbi – Kam përshtypjen që shqetësimi juaj në këtë rast nuk përputhet me interesin e këtij komisioni. Ne kemi një interes tjetër, por, meqenëse ju jeni këtu, duam ta sqarojmë mirë këtë punë. Marrëdhënia që ju lidhni atje, ku depozitoni dherat, është një marrëdhënie midis privatësh apo hyn edhe shteti në mes?

Luigj Aleks – Ne nuk i depozitojmë dherat, detyrohemi të çojmë dhera dhe të paguajmë taksë. Unë e përmenda, dhe po e përsëris dhe një herë tjetër, neve na thonë: “Që të merrni lejen e ndërtimit, do të shkoni të bëni marrëveshje me koncesionarin, do të paguani taksën e dherave atje, do të sillni këtë dokument të marrëveshjes këtu që të merrni lejen e ndërtimit”. Ky është fakti dhe ky bëhet për dherat, po të jetë për mbetjet nuk kemi asnjë lloj komenti. Flasin vetëm për dherat që dalin nga gjurmimet të pastra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk janë mbetje. Ky është gabimi më thelbësor që bëhet. Nuk është mbetje, por është mall, bëjmë argjinatura, lulishte. Ne detyrohemi të shkojmë përsëri te landfilli, ta marrim atë dhe, kur e marrim, e paguajmë edhe një herë dheun, për çfarë? Për të rregulluar lulishtet e pallatit.

Arben Pëllumbi – Përpara se të bëhej kjo procedurë midis privatit, a ishit ju pjesë objekt i ndotjes së qytetit me depozitim të dheut që mbanit pranë kantierit tuaj?

Luigj Aleks – Nuk mund të mohoj faktin që diku edhe ndotet, por diku edhe e depoziton dheun. Fakti është shumë i saktë, ne nuk kemi kundërshtime që ta çojmë dheun në landfill, sepse ka nevojë dhe shteti të çohet në landfill, sepse duhet për një proces, problemi është pse duhet të taksohemi dhe të konsiderohet kjo mbetje. Nuk është mbetje, por është mall. Shteti ka nevojë ta çosh atje dhe e çojmë atje me shpenzimet tona. Pse t’i japim një taksë atij?

Arben Pëllumbi – Qëllimi i pyetjeve të mia është diku tjetër. Ju kryeni një aktivitet ekonomik fitimprurës. Rrotull aty ku ndërtoni banojnë qytetarë, të cilët nuk kanë asnjë lloj interesi fitimprurës nga aktiviteti juaj. Ju nuk mundeni që të dera e shtëpisë së tyre të vazhdoni të depozitoni mbetje edhe të pakontaminuara, të cilat zënë oborret e pallateve, hyrjet e pallateve, shesh-pushimet, shesh parkimet, sepse kështu ka ndodhur, prandaj është detyruar bashkia që t’ju detyrojë të bëni një marrëveshje midis privatëve, në mënyrë që qytetin e Tiranës ta kemi të pastër. Por në kohën që ju depozitoni këto mbetje dhe merrni vetëm një pjesë të vogël të tyre të përpunuar, tashmë pavarësisht se çfarë keni depozituar, merrni dhe të pastër që e përdorni për lulishte.

Pjesa sesi janë vendosur tarifat nuk është çështje e këtij komisioni. Ne duam të dimë vetëm që, në kuadër të të gjithë asaj që po shqyrtojmë këtu për eliminimin e hotspotëve të rrezikshme ndotëse që helmojnë jetën e përditshme të qytetarëve, janë ndërmarrë iniciativa të cilat sjellin përmirësim të mjedisit. Kjo është një iniciativë që sjell përmirësim të mjedisit. Ju përtej të qenit ndërtues jeni edhe qytetar i këtij qyteti, ju këtu i rrisni fëmijët, si gjithë ne të tjerët. Kaq i intereson këtij komisioni. Për pjesën e tarifave mund të keni edhe të drejtë, po nuk është pjesa jona.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, unë nuk ju ndërpres fare kur flisni...

Luigj Aleksi – A mundet?

Jorida Tabaku – Patjetër, zoti Aleksi! Edhe unë kam 2 pyetje.

Luigj Aleksi – Ndërtuesit nuk janë ata që vendosin, por ndërtuesit i kanë kërkuar bashkisë jo 1, por 5 vende depozitimi, 4 vende depozitimi, në mënyrë që të mos ndotet dhe ta çojmë atje ku e do bashkia. Problemi është që këtë dhe që çojmë atje e depozitojmë me shpenzimet e ndërtuesve, pastaj pse duhet t'i paguaj taksë sikur është mbetje? Nuk është mbetje. Më jep 4 vende që të shkoj ta depozitoj ku të doni, e depozitojmë dhe e rimarrim kur të duhet. Përse koncesionari duhet të përfitojë padrejhtësisht para nga një mall, kur ai nuk është mbetje, nuk konsiderohet mbetje, por mall, si çdolloj malli tjetër që shitet dhe blihet? Për këtë nuk jemi dhe nuk kemi qenë dakord. Këtë kontestojmë. Ky qëndrim i bashkisë i detyron ndërtuesit, zoti deputet... Po ju them një gjë tjetër, ndërtimet nuk janë vetëm private, se ju e kthyet në ndërtim privat, por ne ndërtuesit ndërtojmë edhe për publikun, çfarë ndodh me fondet? Kush i paguan fondet? Nuk i merr ndërtuesi. Do t'ia paguajë buxheti i shtetit këto taksa atij koncesionarit për mbetjet që çon nga ndërtimi i një ure apo një rruge, për këto dherat? Ne po diskutojmë tokat e pakontaminuara. Nuk duhet të paguajmë taksë. Këtë kemi ngritur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Po kërkoja për pyetjen që bëri zoti Shalsi se si është llogaritur. Zoti Shalsi, nuk ka absolutisht në propozimin e kompanisë në llogaritjen financiare të Ministrisë së Financave në kontratën koncesionare asnjë të ardhur tjetër përveçse 3: trajtim, depozitimi i mbetjeve dhe incenerim i tyre, 29 euro tonë mbetje, shitje e energjisë dhe shitje e skrapit. Asnjë e ardhur tjetër nuk është objekt i kësaj kontrate, çështja e dherave të ndërtimeve dhe shtesën e kontratës e ka për grafikun e punimeve. Nuk ka asgjë tjetër. Zonja dje e pranoi: “Jemi duke marrë një shërbim tjetër që nuk është parashikuar në kontratë”. I ka këtu të gjithë zërat për të cilët është bërë llogaria financiare e kompanisë dhe, njëkohësisht, mbi të cilën është llogaritur edhe kostoja për euro ton mbetje.

Pyetjen e fundit e ka zoti Shalsi, pastaj zoti Gështenja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, të mbarojë pyetjen zoti Gështenja, pastaj ju bëni komentin në fund.

Lifter Gështenja – Faleminderit!

Pyetja ime ishte për ju, zoti Aleksi, kjo tarifa e koncesionarit a ndikon në çmimin e banesave, në çmimin e ndërtimit, të shitjes?

Luigj Aleksi – Sigurisht që ndikon, unë e përmenda që ndikon qoftë në çmimin e shitjes, sepse ne nuk do ta mbajmë për vete, do ta delegojmë te taksapaguesi në fund, tek ai që blen shtëpinë.

Po për publikun? Kur ndërtojmë një urë, për shembull, dhe gërmojmë 50 mijë metra kub dhe e çojmë atje dhe paguajmë 700 lekë për ton, këto a ndikojnë në buxhetin e shtetit dhe do t'i marrë koncesionari?

Fadil Nasufi – Një përgjigje ma dha para pyetjes sime zoti Aleksë në lidhje me faktin që ju keni kërkuar vende të tjera për të hedhur, sipas kategorisë, pjesën e ngurtë, dheun e mirë të tokës, sepse që duhet të shkojë në vende të orientuara dhe të miratuara nga bashkia besoj se jeni dakord të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka një përgjigje për këtë çështje?

Luigj Aleksë - Ka një përgjigje për këtë çështje, na është thënë: “Nuk kemi vend tjetër” që në vitin 2019 e kemi të shkruar. Jemi detyruar dhe e kemi çuar atje.

Fadil Nasufi – Në atë çfarë pamë ne në venddepozitimin dhe inceneratorin e Tiranës janë gati 100 mijë hektarë tokë. Ekzistojnë të gjitha mundësitë që të jetë depozitimi i të gjitha materialeve të ndërtimit me të cilat operoni ju. Tani, tarifën atje tek landfilli apo te inceneratori, kush e merr? E merr koncesionari apo bashkia?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luigj Aleksë – Shtatëqindlekëshin e merr koncesionari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputet – A keni ju një përlllogaritje të kostos së shërbimit në përgjithësi, të shërbimit publik të pastrimit, e pastaj të kostove të tarifës, që duhet mbuluar kostoja e shërbimit të pastrimit?

E dyta, ju si prodhues, a e keni të qartë atë qasje, sipas të cilës prodhuesi duhet të mbajë përgjegjësi për produktin e mbetjeve që prodhon, deri në trajtimin final, që t'i shërbejë interesit publik për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e shëndetit dhe për anën estetike të tërë qytetit, ku ne të gjithë bashkëjetojmë?

Luigj Aleksë – Unë e përmenda edhe një herë, po përsëri ngatërrohem në dialog. Dheu i pagërmuar nuk është mbetje. Këtë nuk e themi ne, nuk e thonë ndërtuesit, por e thotë direktiva europiane. Përrjashtohet nga titulli “mbetje”. Dheu është material dhe si i tillë do të shkojë atje e nuk do të paguajë taksë. Këtë e thotë direktiva europiane, e thotë vendimi nr. 99 i qeverisë. Këtu është deformuar vetëm ky rast dhe vetëm në bashkinë e Tiranës. Në asnjë qytet tjetër nuk ndodh kjo gjë.

Deputet – Dakord! A keni ju raste konkrete, oferta, pa u futur kjo taksë e bashkisë, pra a e keni pasur më përpara oferta, që ju e bënit privatisht shitjen e dheut? Keni pasur?

Luigj Aleksi – Unë nuk mund të jap një përgjigje të tillë. Rastet janë të ndryshme. Ka kërkesa për dhera. Ne kemi propozuar edhe që dheun e mirë ta çojmë për të bërë argjaturën e lumit të Tiranës me shpenzimet tona, dhe na kanë thënë: jo, do ta çoni këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Faleminderit!

Atëherë, me sa kuptova – unë në fakt e di edhe si shqetësim të subjekteve – në bashkinë e Tiranës firmat e ndërtimit që aplikojnë të marrin leje ndërtimi, nuk pajisen me leje ndërtimi pa pasur paraprakisht në dosje një kontratë me koncesionarin, për depozitimin e dherave. Nga ana tjetër, nuk është vetëm kjo, sepse u aludua që është marrëdhënie midis dy subjekteve private, por edhe firmat që marrin pjesë në prokurimet publike, nëse nuk kanë një kontratë për depozitimin e dherave, edhe ata që marrin nga buxheti i shtetit, pra kur fondi është i buxhetit të shtetit, i cili prokurohet dhe lidhet një kontratë me firmën fituese, edhe firmat fituese të një prokurimi me buxhetin e shtetit duhet të kenë një kontratë me koncesionarin, që të depozitojnë dherat.

Pra, janë fonde të buxhetit të shtetit, që u shkojnë, sepse ato janë situacione që do t'u kalojnë patjetër buxhetit të shtetit. Nëse e kuptova, jo vetëm subjektet private që duan leje ndërtimi, por dhe firmat e subjektet që lidhin kontratë për një investim publik, duhet të kenë një kontratë paraprake me koncesionarin, që të depozitojnë dherat dhe të jenë pjesë e situacioneve, sigurisht nga buxheti i shtetit. E kam kuptuar drejt, besoj.

Faleminderit!

Luigj Aleksi – E keni kuptuar drejt, por jo paraprake. Po të shikosh, gjatë fazës së tenderimit, në mjaft raste edhe preventivët e fondeve publike parashikojnë çmim për depozitimin atje, që duhet bërë. Edhe një fakt, meqë ma kujtuat, qeveria me shumë të drejtë, për objektet e rindërtimit në fazën e tërmetit, i ka përjashtuar, nuk paguhet kjo taksë. Nëse toka ose ky dhë është i kontaminuar, atëherë ne shkojmë e helmojmë një tokë, nxjerrim një vendim qeverie për të helmuar një tokë. E ka përjashtuar me të drejtë, sepse nuk është mbetje.

Pra, ne mbajmë dy qëndrime për të njëjtin problem. Në këtë rast, për të favorizuar koncesionarin, bashkia e konsideron mbetje, ndërsa në rastin tjetër qeveria e përjashton, sepse nuk është mbetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Unë them që ta përcjellim zotin Aleks, që personalisht nuk e kuptoj përse duhej të ishte munduar për të ardhur në këtë komision hetimor, ndërkohë që fare mirë, shqetësimi i tij dhe i ndërtuesve mund të ishte një objekt diskutimi edhe nëpër komisionet tona

të ndryshme parlamentare. Kështu që, unë mendoj se zoti Aleksë mund të vijojë. Pastaj mund të them nja dy gjëra në lidhje me thelbin e asaj që ju më shpjeguat.

Mirë, zoti Aleksë, mund të vijoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mund të vijoni, mund të vijoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë edhe për pritjen e gjatë që patët, por mund të vijoni!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo që po thosha është: ka një kontratë koncesionare. Koncesionari ka ekskluzivitetin e mbetjeve, si për ato organike, ashtu edhe për ato inorganike. Është një pikë e kontratës. Është një ligj, sot që flasim. Ju po i referoheni direktivës, por është një ligj, i cili ka një katalog, që përshkruan qartazi mbetjet në Shqipëri.

Nëse ky katalog...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Një sekondë!

Ke vendimin. Ja, të jap edhe pikën e vendimit, se si i klasifikon. Pra, e kemi në ligj, aktualisht. Po të ishte histori tjetër, do ta ndryshonim, por ama jemi para faktit se kjo është në ligj. Gjithsesi, të mos humbasim kohë, ndaj le të vijojmë.

Jorida Tabaku – Nuk dua të bëj asnjë koment mbi komentin tuaj. Besoj se të gjithë arritëm në atë konkluzion që donim: ne në tonin e ju në tuajin. Mua më vjen mirë që në këtë komision hetimor jemi duke diskutuar edhe në lidhje me gjëra për të cilat nuk kishim folur më parë.

Sot për dëshmi ka ardhur zoti Jetmir Olldashi, i cili është përfaqësues i Boldneës.al.

Zoti Olldashi, para se të fillojmë, dua t'ju kujtoj Rregulloren e brendshme të komisionit. Dëshmia juaj do të merret pasi që ju të keni kryer betimin. Njëkohësisht, dua t'ju kujtoj se dëshmia e rreme dënohet me burgim nga 2 deri në 6 vjet, sipas Kodit të Procedurës Penale. Sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale, ju lutem përsërisni pas meje:

“Betohe më se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën, dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë! Betohe më!”

Jetmir Olldashi – Betohe më!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Do t'ia jap fjalën zotit Këlliçi, për të filluar pyetjet drejtuar zotit Olldashi.

Belind Këlliçi – Faleminderit, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Olldashi, a jeni thirrur gjë nga SPAK-u ju?

Jetmir Olldashi – Jo.

Arben Pëllumbi – Nga prokuroria? A jeni pjesë e hetimit të prokurorisë?

Jetmir Olldashi – Jo.

Jorida Tabaku – Atëherë, meqenëse filloi kështu, po e nis edhe unë me gjeneralitetet, pastaj do t'ia jap fjalën zotit Këlliçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, a i njihni shtetasit Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja?

Ndizeni mikrofonin!

Jetmir Olldashi – I njoh në rrethana zyrtare, për shkak se jam paditur nga ata për shpifje, si shkak i disa artikujve që kam bërë unë, personalisht dhe portali mediatik që unë drejtoj Boldnews.al...

Jorida Tabaku – A i keni takuar ndonjëherë?

Jetmir Olldashi – Jo, nuk jam takuar asnjëherë me ata.

Jorida Tabaku – A keni komunikuar ndonjëherë me ta në telefon apo në mënyra të tjera?

Jetmir Olldashi – Jo, asnjëherë me telefon, përveçse nëpërmjet avokatëve, gjatë kohës që ka qenë procesi në gjykatë.

Jorida Tabaku – Sa padi i janë bërë në drejtim tuaj apo në drejtim të portalit tuaj, nga këta tre zotërinj?

Jetmir Olldashi – Kam një padi, e cila i është drejtuar personit tim, portalit gjithashtu, dhe Gjykata e Tiranës ka dhënë edhe një vendim, duke më dënuar për këtë. Domethënë, për akuzat që ka ngritur SPAK-u ndaj zotit Mërtiri, një i kërkuar ndërkombëtar, unë jam dënuar nga Gjykata e Tiranës, nga një gjyqtar kaçurrels, që ka dhënë një vendim paçavure, që unë mund t'jua vë në dispozicion sot.

Jorida Tabaku – Zoti Olldashi, të siguroj se këtu nuk të intimidon dot askush, ndaj mund ta thoni deri në fund atë që keni dëshirë të shprehni dhe atë që keni publikuar.

Fjala për zotin Këlliçi.

Belind Këlliçi – Faleminderit, kryetare!

Siç është thënë këtu disa herë nga unë personalisht, por edhe nga kolegët e kampit opozitar, për këtë aferë të tre inceneratorëve ne jemi shprehur publikisht, që kjo nuk është aferë vetëm financiare, por një aferë që lidhet thellësisht edhe me kapjen mediatike e me censurën mediatike, që i është bërë kësaj problematike gjatë viteve të fundit.

Përmes rrjeteve sociale, unë kam parë se portali që ju drejtoni, në mos gaboj është ndër portalet e para, së bashku me rrjetin investigative BIRN dhe dy -tre portale të tjera, që kanë folur hapur për aferën e inceneratorëve: për inceneratorin e Tiranës, të Fierit e të Elbasanit.

Ajo që më ka bërë përshtypje – në fakt ju jeni me kërkesën time këtu, në këtë komision, kërkesë e miratuar nga komisioni – pra ajo që më ka bërë përshtypje është fakti që ju, siç e përmendet, e unë do të doja të kalojmë pak edhe në detaje, nëse mundeni, për atë që mund të na thoni, jeni i dënuar nga Gjykata e Tiranës në lidhje me disa shkrime që ju keni bërë, shkrime të cilat sot janë akuzë nga SPAK-u për shtetasin Mirel Mërtiri, i cili në dijeninë time, është në kërkim. Në këto shkrime ju keni thënë plotësisht të vërtetën, për sa kohë që SPAK ka ngritur akuzë në lidhje me qëndrimet që ju keni mbajtur. Pra edhe akuza e SPAK-ut edhe qëndrimet publike që ju keni, janë të lidhura.

Po ju bëj një sërë pyetjesh, e më pas ju do të keni narrativën tuaj. Unë doja të dija nga ju: qëkur keni rënë në dijeni të aferës së inceneratorëve? Cila është periudha kur keni filluar të shkruani në lidhje me këtë aferë? A keni pasur ndonjëherë ndonjë kërkesë për të tërhequr shkrimet tuaja nga portali që ju drejtoni, në mënyrë që të tërhiqej padija ndaj jush? A jeni ndjerë ndonjëherë i intimiduar nga shtetasi Mirel Mërtiri apo nga persona që kanë folur me ju në emër të tij?

Më pas kalojmë në pyetje të tjera. Fillimisht; kur keni nisur raportimin? Sa vite keni që raportoni për këtë ngjarje, për aferën e tre inceneratorëve? Si është statusi juaj gjyqësor, sot që ne flasim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Për procedurë, për procedurë, nuk diskutohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bazë të Kodit të Procedurës penale, neni 156, germa “ç”, zotëria nuk mund të dëshmojë.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, fjala merret për procedurë pasi përfundon fjalën dëshmitari.

Arben Pëllumbi – Ja, t’jua lexoj!

Jorida Tabaku – Jo, j, një sekondë!

Arben Pëllumbi – Në bazë të nenit 156: “Papajtueshmëri me detyrën...”

Jorida Tabaku – Besion, të erdhi edhe ty ky mesazhi? U erdhi të gjithëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po lëre të përfundojë tani! Një sekondë! Se e di justifikimin që do të thotë ky...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Nuk bëhet dot dëshmitar, sepse është i dënuar në lidhje me këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 156 i Kodit të Procedurës Penale: “Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit”, germa “ç”, e ndalon zotërinë të flasë si dëshmitar në këtë komision.

Jorida Tabaku – Për çfarë arsyeje?

Arben Pëllumbi – I padituri civil dhe personi civil, ish përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri. Ky ka një dënim të formës së prerë, një dënim nga Gjykata e Shkallës së Parë, që është i dënuar për këtë çështje.

Jorida Tabaku – Jo, nuk është dënuar për këtë çështje.

Arben Pëllumbi – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ka një keqkuptim. Zotëria nuk është dënuar për këtë çështje. Zotëria ka një vendim, që Mirel Mërtiri e ka hedhur për shpifje zotërinë. Ne po e pyesim se cili është objekti, që ju e keni hedhur për shpifje.

Arben Pëllumbi – Prandaj pra, nuk mund të dëshmojë për këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Sepse për atë punë, ndërkohë që Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja ishin në kërkim ndërkombëtar, më kanë paditur mua.

Arben Pëllumbi – Në qoftë se gjykata do t’ju bënte fajtorë, as ju s’do mund të dëshmonit.

Jorida Tabaku – Dhjetë deputetë të Partisë Demokratike. Po diskutojmë për dy gjëra të ndryshme.

Arben Pëllumbi – Në qoftë se do të kishte një vendim që ju bën fajtorë, ju nuk mund të dëshmoni.

Jorida Tabaku – Po diskutojmë për dy gjëra të ndryshme.

Arben Pëllumbi – Kaq e thjeshtë është: nuk mund të dëshmojë.

Jorida Tabaku –

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Për procedurë e kam.

Përderisa çështja është vetëm në shkallën e parë dhe nuk ka dalë vendimi i apelit, nuk konsiderohet i dënuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jetmir Olldashi – Meqenëse ngrihet ky problem, si puna ime janë edhe disa medie të tjera, të cilat kanë qenë të paditura në Gjykatën e Tiranës. Thjesht e deshi fati që unë të

dënohesha i pari, por ajo që kishte nisur Mirel Mërtiri ishte për të dënuar disa medie dhe disa gazetarë, të cilët nuk u ishin bindur kërkesave të tij për fshirje lajmesh e për heqje lajmesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Olldashi, ju lutem!

Jetmir Olldashi – Domethënë, është mbyllur shkalla e parë, por patjetër që është apeluar dhe...

Jorida Tabaku – Nuk është dënim i prerë.

Jetmir Olldashi – Absolutisht!

Jorida Tabaku – Ju lutem, zoti Olldashi, përgjigjuni pyetjeve të zotit Këlliçi! Ajo është çështje e ezauruar.

Jetmir Olldashi – Po. Lidhur me aferën e inceneratorëve, unë kam dëgjuar dhe kam pasur dijeni që në vitin 2016, kur kam qenë pjesë e emisionit “Të paeksponuarit”, që drejtohej nga Ylli Rakipi, në televizionin News 24. Aty kemi bërë një emision të tërë. Ka qenë viti 2016, zotëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi bërë një emision të tërë lidhur me këtë fakt, pa u dhënë ende PPP-të e inceneratorit të Tiranës, të Elbasanit dhe të Fierit. Më pas, me kalimin e viteve, jemi marrë edhe me shkrime të tjera, të cilat ceknin lidhjet që kishin midis tyre Stela Gugallja, Mirel Mërtiri, Klodian Zoto. Pra, ishin kompani, të cilat fshiheshin pas njëra-tjetrës, përfundonin të gjitha në Holandë dhe në fund fare ishin të gjitha ofshore.

Kemi marrë edhe shkrime që ishin të kolegëve të tjerë, si të BIRN-it e të disa portaleve të tjera, të cilat i kemi pasqyruar në Boldnews. Së fundi, ishte një aferë që ndodhi në shtetin e Zimbabvesë, ku aktualisht ministri i Shëndetësisë atje është i arrestuar për një aferë prej 60 milionë dollarësh. Në të gjitha mediet e Zimbabvesë përflitej një zotëri me emrin Ilir Dedja, por në foton me ministrin e Shëndetësisë ishte vetë Mirel Mërtiri. Fotoja është publike dhe është akoma në rrjetin ZimLive.

Pra, kishim të bënim me një person, i cili kishte vajtur atje me një identitet tjetër dhe ishte paraqitur atje për të bërë biznes. Ne e pasqyruam këtë fakt, duke vendosur edhe burimin e informacionit poshtë. Pra, ne ishim thjesht përçuesit, përkthyesit e këtij informacioni, duke e lidhur edhe me situatën në Shqipëri: si ishte e mundur që në një shtet si Zimbabveja dënohet një ministër Shëndetësie, ndërkohë që Mirel Mërtiri në Shqipëri po bënte qindra milionë euro nëpërmjet aferës së inceneratorëve?

Jorida Tabaku – A mund të shtoj një pyetje tek pyetjet e zotit Këlliçi?

Zoti Këlliçi ju pyeti nëse keni pasur kërcënime, intimidime, kërkesë për dorëheqje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zoti Pëllumbi, më lejoni ta përfundoj fjalinë!

A ka pasur ndonjëherë media juaj oferta për reklama marketingu nga kompanitë e inceneratorëve? Dje arritëm të shihnim një buxhet të jashtëzakonshëm marketingu për televizione e media, që kompanitë kishin paguar. Në gjykimin tonë ky buxhet është përdorur pikërisht për të intimiduar mediat për të shkruar, duke paguar atje reklama. Po për medien tuaj, për portalin tuaj, a ka pasur ndonjë ofertë të tillë?

Jetmir Olldashi – Atëherë, gjatë kohës që zhvillohej gjyqi në Gjykatën e Tiranës, është bërë një seancë pajtuese, në të cilën, avokatët e zotit Mërtiri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem, mos bojkotoni komisionin! Ju lutem, zoti Pëllumbi! Ju bëj thirrje të mos bojkotoni komisionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos bojkotoni komisionin! Unë e kuptoj se çfarë doni të bëni. Mos bojkotoni komisionin! Zoti Pëllumbi, e kuptoj se nuk doni që shqiptarët të dëgjojnë faktet. Mos bojkotoni komisionin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja ka filluar me kuorum, ndaj ne do ta vazhdojmë. Vendimmarrje nuk kemi, kështu që fjala për zotin Olldashi.

Jetmir Olldashi – Atëherë, gjatë kohës që kanë qenë disa nga seancat e para në Gjykatën e Tiranës, avokatët e zotit Mërtiri i kanë kërkuar avokatit tim, që t'i heqim e t'i fshijmë shkrimet nga faqja. Gjatë kësaj kohe, unë i kam thënë avokatit tim nëse bëhej fjalë për ndonjë teprim të mundshëm, ndonjë metaforë pa sens. Domethënë, mund të ketë disa pika, për të cilat mund të flasim, që edhe mund të teprohet gjatë bërjes së shkrimeve. Nga ana e avokatëve të zotit Mërtiri, përgjigja ka qenë e prerë: që shkrimet duhej të fshiheshin afër nga faqja. Ne kemi qenë të prerë tek pjesa ku nuk kemi pranuar reklama marketingu nga kompani, të cilat mendojmë se kanë probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Belind Këlliçi – Shiko, mua më vjen mirë edhe për hir të opinionit publik dhe të shkuesve që e ndjekin këtë seancë, që përfaqësues të medias, që kanë ardhur sot për të dëshmuar para këtij komisioni, u treguan fare mirë të gjithë qytetarëve presionin e madh dhe censurën mediatike që është bërë ndaj kujtdo që ka pasur guximin të ngrejë zërin e të flasë për këtë aferë korruptive.

Unë personalisht, përgëzoj çdo gazetar, që në zbatim të detyrës dhe të misionit si gazetar nuk e ka ulur kokën dhe nuk ka rënë pre e sponsorizimeve nga paratë e inceneratorëve dhe të mafjes së plehrave, nga intimidimet apo kërcënimet për të tërhequr lajme.

Arsyeja pse ne, arsyeja pse unë personalisht kam dëshiruar që ju të jeni para këtij komisioni është edhe për t'u dhënë kurajë të gjitha medie, të gjitha portaleve dhe të gjithë gazetarëve për të bërë detyrën e tyre. Nëse ju keni diçka që doni të thoni në lidhje me investigimin tuaj, në lidhje me të gjitha informacionet që ju keni bërë publike, nëse doni të flisni diçka në lidhje me shkrimet që keni bërë, apo ndonjë dokument që ju keni disponuar, në të cilën mund të ndihmoni këtë komision, do të kërkoja nga ana juaj që të ndjeheni të lirë dhe të thoni të gjithë të vërtetën që ju dispononi, përpos të gjitha presioneve që bëhen nga pala e maxhorancës, që ju të mos e jepni këtë dëshmi.

Jetmir Olldashi - Atëherë, së pari, dua t'i drejtoj një thirrje deputetëve të Kuvendit, të cilët kanë të gjitha mundësitë e tyre dhe tagrin e duhur ligjor për t'i kërkuar organeve të vetingut që të gjithë këta gjyqtarë, të cilët janë vendime kundër medias, janë gjyqtarë që duhet të kalojnë sa më parë në filtrin e vetingut. Unë jam dënuar nga një gjyqtar që lëviz me porsh nëpër tiranë me targa amerikane dhe, çuditërisht, nuk i vjen radha e vetingut. Këtu po kalojnë të gjithë në filtrin e vetingut, atij nuk i vjen radha. Pra, kemi një simbiozë të rrezikshme, kemi kapjen e pushtetit gjyqësor dhe asnjë medie nuk mund të arrijë t'i bëjë dot ballë presioneve, malavitës, qeverisë apo parave të pista kur ka edhe gjyqësorin kundër, sepse del dhe thua të vërtetën dhe ai shkon të dënon pa asnjë provë, pa asnjë verifikim, por e sheh thjesht si çështje të vullnetit të tij apo bindje tij. Në rastin konkret kam dy dokumente, ku procesverbali i mbledhjes së vendimit më thotë që prokurori ka kërkuar fajësi, sepse ishte gjyq me prokurorë, ndërkohë, në vendimin përfundimtar të gjykatës, që ka marre me vulë nga Gjykata e Tiranës, thotë që prokurori ka kërkuar pafajësi. Domethënë, është një paçavure e plotë. Në momentin që unë nuk di se çfarë ka kërkuar realisht prokurori, unë kam pasur avokatin tim në zyrën e gjyqarit, dhe avokati më ka thënë që prokurori ka kërkuar fajësi, por, çuditërisht, në vendim na del pafajësi.

Jorida Tabaku—Unë ju falënderoj!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera nga ana e komisionit, dua të të siguroj që sa herë që bëhet fjalë për institucione që drejtohen nga opozita, ju do ta keni të hapur platformën dhe mikrofonin për të thënë të gjitha shqetësimet që ka. Nuk ka grup të strukturuar kriminal që na intimidon ne, por edhe gazetarët që duan të flasin për çështje të korrupsionit. Ne duhet ta vrasim frikën, sepse po nuk folëm ne të parët, politikanët, nuk flasin dot gazetarët. Dua t'ju përgëzoj për kurajën qytetare që keni pasur për t'i shkuar kësaj afere deri në fund, ju dhe disa gazetarë të terë.

Faleminderit!

Jetmir Olldashi- Ju faleminderit!

Jorida Tabaku- Dëshmitari i radhës është zoti Artan Rama. U kërkoj kolegëve socialistë në qoftë se do të vijnë në mbledhjeje, në të kundërt, ne do të vazhdojmë, por mirë do të ishte që ata të ishin prezent.

Zoti Rama, unë ju falënderoj për durimin, por, njëkohësisht, edhe për angazhimin që ju keni pasur në këtë çështje!

Për të gjithë ata që duan ta dinë, unë, përpara se të filloja ta denoncoja këtë koncesion dhe këtë aferë korruptive në vitin 2016, zoti Rama ka qenë i vetmi gazetar, i cili ka pasur guximin dhe ka shkruar dhe më pas e ndoqën edhe shumë medie të tjera kurajoze. Analizat e zotit Rama, për mua, kanë qenë të një niveli shumë të lartë profesional.

Dua t'ju citoj rregulloren e brendshme të komisionit. dëshmia juaj do të merret pas kryerjes së betimit. Dua t'ju kujtoj se sipas nenit 306, të Kodit të procedurës Penale dëshmia e rremë nga ana juaj dënohet nga organet përkatëse 2-6 vjet. Ju lutem, sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale, të përsërisni pas meje: “Betohem se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe asgjë që nuk është e vërtetë”.

Artan Rama- Betohem!

Jorida Tabaku- Ju faleminderit!

Përpara se të fillojnë seancën e pyetjeve, fjalën e ka kërkuar zoti Xhafaj për procedurë.

Etien Xhafaj- Kryetare, dua të sjell në vëmendjen tuaj dhje të gjithë anëtarëve të tjerë të këtij komisioni që nuk mund të vazhdoen mbledhjet kur nuk keni kuorum. Pjesa e politikës është edhe diskutimi me njeri-tjetrin dhe rënia dakord për disa çështje, sepse asnjëri nga kolegët e maxhorancës nuk ka pasur asnjë problem me dëgjimin e asnjërit nga dëshmitarët, përkundrazi, kemi sjellë në vëmendjen tuaj një nen specifik të Kodit penal, i cili ka të bëjë me papajtueshmërinë e dëshmitarëve që flasin për një çështje, të cilën ne, si përfaqësues të maxhorancës në këtë komision, e vlerësojmë se duhet vlerësuar nga ky komision dhe duhet marrë parasysh, duke qenë se personat, të cilët flasin dhe janë në hetim për c çështjen, të ngarkohen vetëm me përgjegjësi penale. Ky ishte i gjithë diskutimi.

Unë e kuptoj shumë mirë që duhet treguar çdo gjë dhe duhet alienuar çdo diskutim, por, në të mirën e parlamentarizmit, është edhe ai diskutim. Ju nuk mund të vazhdoni mbledhjen pa pasur kuorumin, sepse mbledhja ka filluar me kuorum, nuk është as kjo pjesë e ligjit, apo e rregulloreve. Prandaj, përpara se të citoni ato që ju pëlqejnë nga ligji dhe rregullorja, të kini parasysh e ne duhet t'i zbatojmë të gjitha.

Jorida Tabaku- Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi- Dua ta pyes dëshmitarin, zotin Rama, a ka një çështje të hapur gjyqësore apo një dënim në lidhje me këtë problematik që ne shqyrtojmë në këtë komision?

Edmond Spaho- Përpara se të flasë zoti Rama, dua ta marr fjalën për procedurë.

Ajo që ju jeni përpjekur të ngrini deri tani është që të mos i intimidojmë dëshmitarët. Kjo pyetje është ekzaktësisht për të intimiduar dëshmitarin. Duhet të keni parasysh që dëshmitari do të quhet i dënuar kur ka një vendim të formës së prerë. Edhe nga mënyra sesi pyetët unë kuptoj që për dëshmitarin ende nuk është zhvilluar as seanca në shkalën e parë të gjyqësorit. Kështu që, ju lutem shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, unë ju dëgjova. Për më tepër, po më duket jo serioze kjo lojë që po bëni me gazetarët për t'i ekspozuar si njerëz që kanë probleme me ligjin. Në fakt, edhe nëse ata kanë përballje me ligjin, e kanë për shkak se po përpiqen të kryejnë misionin dhe detyrën e tyre si gazetarë. Po ekspozojnë afëra korruptive dhe ata, të cilët kanë kryer këto afëra, marrin iniciativën dhe shkojnë dhe i akuzojnë për shpifje në gjykata e nivelit të parë. Unë mendoj se kjo nuk është e drejtë dhe duhet t'i lëmë këto lojëra dhe të ruajmë personalitetin e gazetarëve dhe në vend që të linçojmë duhet t'i falënderojmë që po kryejnë misionin e tyre.

Arben Pëllumbi- Zoti Spaho, këtu nuk është fjala as për gazetarë, as për jo gazetarë. Në këtë qëndrim do ta mbajmë si për zotërinë që iku, nëse zotëria në fjalë e ka këtë çështje, edhe për dëshmitarët që vijnë mbrapa, qofshin gazetarë ose jo gazetarë. Në qoftes e ka një problem me objektin tonë të hetimit, pra, një çështje të hapur, janë thirrur për t'u pyetur, janë dëshmitarë apo kanë një vendim nga gjykata nuk mund të dëshmojnë, sepse janë në konflikt interesi, nuk ka lidhje fare me detyrën që është duke bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku- Zoti Spaho, ju lutem!

Që të mos e interpretojmë ligjin secili siç ka qejf vetë, neni 18 i Rregullores së këtij komisioni hetimor thuhet që dëshmitari informohet në mënyrë të posaçme për të drejtën për të refuzuar dëshminë në dispozitat që përcakton neni 157 dhe 158 i Kodit të Procedurës Penale, që reflekton njëkohësisht edhe konfliktin e interesit. Janë dy raste kur ka konflikt interesi sipas këtyre dy pikave, kur dëshmitari ka një lidhje familjare me personat e përfshirë, ose kur ka një marrëdhënie biznesi. Ajo që ju citoni nuk është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë. Unë citova këtu për zëvendëskryetaren e komisionit që ka qenë e përfshirë në procedura dhe gjykante se nuk kishte konflikt interesi, ishte pjesë vendimmarrëse, ndërkohë, ne tani po diskutojmë për tre kriminelë në kprkim ndërkombëtarë pse na kanë hedhur në gjyq, por na kanë hedhur të gjithëve në gjyq. Të gjithë neve këtu na kanë hedhur në gjyq dhe nuk e diskutoj fare si konflikt interesi.

Fjalën e ka zoti Boçi për procedurë dhe me sugjerimin e zotit Xhafaj, do të bëjmë 5 minuta pushim që ta diskutojmë këtë.

Luçiano Boçi- Së pari, për çështjen e kuorumit, në traditën e komisioneve kuorumi verifikohet në fillim dhe kur ka proces votimi, pastaj, se ka lëvizje, del për kafe, për ujë apo emocionalisht prekeni dhe dilni në grup, kjo është çështjet tjetër, por komisioni vazhdon punën.

Së dyti, për çështjen e pranisë së gazetarit, po i referohem asaj që tha Mondit dhe Jorida. Tre kriminelë marrin miliona euro nga buxheti i shtetit, kur janë në kërkim nga SPAK-u, ju keni thënë që s'ka gjë, është procedurë, por si qenka procedurë?! Ndërsa gazetari, i cili është akuzuar nga këta që marrin miliona nga ju (e doni me "Ju", sepse ne jemi për një qëllim) ai nuk duhet të jetë aty. cili është objekti i komisionit?! Ka të bëjë me procedurat. Gazetari nuk është i akuzuar për ndërhyrje në procedura, prishej të procedurave, dëme e të tjerë, por është vetëm dëmi i imazhit të biznesit. Imazhi i biznesit nuk ka lidhje specifike me këtë që po hetojmë ne, akuza. Pastaj, se nga lind akuza është tjetër gjë. A jemi të qartë këtu? Lexojeni akuzën për Artan Ramën. Ajo është për prishje imazhi. Imazhi ka aktivitete tjetër, mund të jetë që ka instaluar një sahat uji, është marrë me shitje apo blerje ushqimore, ndoshta e ka për atë dhe do të hysh në detaje të hetimit. Akuza është e tillë. Ai nuk ka ndërhyrje në procedurë, nuk e ka prishur procedurën dhe nuk e ka vonuar që të akuzohet dhe ne t'i themi: "Ik, sepse ke ndikuar në procedurë", ose "Ik se je në konflikt interesi" po, jam dakord, por këtu nuk ka fare konflikt interesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka asgjë.

Jorida Tabaku- Ju lutem, që ta vazhdojmë diskutimin! Zoti Këlliçi e ka fjalën në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, dua të them edhe një fjali dhe të bëjmë 5 minuta pushim, sipas sugjerimit të zotit Xhafaj.

Secili ka interpretimin e vet. Nuk ka nevojë për interpretim, sepse ligji është shumë i qartë dhe neni që ju citoni, neni 156, është shumë i qartë. Thuhet: "Për veprë penale"

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta, kam një pyetje. Në Republikën e Shqipërisë shpifja është veprë penale? Të përgjigjet njeri nga ju, sepse po akuzoni kot. Zotëria është i paditur për shpifje dhe shpifja, sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, nuk është veprë penale.

Etien Xhafaj - Nuk po flet njeri për zotërinë, por po diskutonim një gjë tjetër në parim. Jeni ju që po e personalizoni diskutimin, nuk po flasim për zotërinë. Asnjëri nuk po flet për zotërinë.

Jorida Tabaku- Që ta kuptoni, shpifja nuk është vepër penale. Ju lutem, kuptojeni me logjikë që shpifja nuk është vepër penale.

Fjalën e ka zoti Këlliçi dhe pesë minuta pushim.

Belind Këlliçi- Faleminderit, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Largohuni, sepse ky ka qenë qëllimi që në fillim. Mua më vjen mirë që pjesëmarrja sot në këtë komision e gazetarëve, që kanë pasur kurajë dhe kanë folur për këtë aferë që ditën e parë, detyron të nxjerrë në pah fytyrën e vërtetë të kësaj maxhorance. Që nga dita e parë që është ngritur ky komision është ngritur me qëllimin vetëm për të mbrojtur 3 kriminelë, që sot janë në kërkim ndërkombëtar, që janë mbrapa kësaj afere, që, sigurisht, nis me Mirel Mërtirin, Klodian Zoton, Stela Gugallen dhe përfundon te Kryeministri i vendit, të cilin do ta kemi shumë shpejt këtu.

Unë kam një apel jo vetëm për zotin Rama, si gazetar, por edhe për zotin Olldashi dhe gazetarët e tjerë që të ndjehen krenarë që janë të paditur për shpifje nga kriminelët dhe hajdutët, që fshihen pas inceneratorëve, pas kësaj skeme mafioze, pse kanë thënë të vërtetën dhe kanë pasur kurajën qytetare dhe gazetareske për të bërë detyrën e tyre.

Unë, personalisht, kam pasur dy padi nga Mirel Mërtiti, zonja Tabaku, në cilësinë e kryetares së këtij komisioni, edhe ajo ka pasur padi, edhe zonja Zhupa dhe sa herë kemi kërkuar të përballemi në gjyq me Mirel Mërtirin nuk ka qenë. Në seancat e fundit, kur u pushuan çështjet, morëm vesh që zoti Mërtini nuk mund të vinte, sepse ishte në kërkim dhe nuk dihej adresa. Ndoshta ju, kolegë socialistë, mund të na ndihmonit të na thoni adresën se ku gjendet zoti Mërtiri, zonja Gugallja dhe zoti Zoto, por ne i kemi kërkuar që të vijnë të ballafaqohen.

Unë kam një apel jo vetëm për zotin Rama, por për të gjitha mediet, për televizionet që kanë pasqyruar prej 4 vjetësh, gjej shkak të përmend televizionin Ora News, që ka pasqyruar këtë çështje prej 4-vjetësht, e cila ka qenë një dritare që na ka dhënë mundësinë të them të vërtetën, gjej rastin të përmend gazetarët, rrjetin investigativ BIRN, CNA-në, Syrin, ABC-në dhe të gjitha mediet që kanë thënë të vërtetën dhe t'u japim kurajë të gjithë gazetarëve të bëjnë detyrën e tyre. Një padi për shpifje nga kriminelët, që kanë vjedhur shqiptarët dhe taksat tona për 30 vjet, është vetëm një medalje nderi për çdo gazetar në këtë vend. Kaq kisha.

Jorida Tabaku- Meqenëse zonja Antoneta Dhima më kërkoi të lexoj nenin, po jua lexoj nenin që kolegët e Partisë Socialiste citojnë. Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarin, po i referohem pikave b dhe ç, ku në pikën b thuhet: “Të pandehurit në një vepër penale të përbashkët..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji nuk lexohet si doni ju, por fillon nga pika a dhe vazhdon deri te pika ç. “I paditur civil dhe personi civil për dëmin e shkaktuar”. Pra, për veprën penale kemi juristen e komisionit këtu e cila mund të na tregojë se cila quhet vepër penale. A quhet shpifja vepër penale apo jo? Ky është shqetësimi që unë kam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu thotë Ermonela?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Ajazi, faja për ju.

Besion Ajazi- Faleminderit, kryetare!

Me lejen tuaj, a mund t’ia drejtoj edhe një herë pyetjen kolegut tim, Rama?

Zoti Rama, a mund të na thoni neve, si komision, a keni pasur ndonjëherë ndonjë proces gjyqësor me ndonjë nga koncesionarët, në mënyrë që të jemi të qartë të gjithë? Ne nuk kemi gjë as me ju, as me median tuaj dhe me asgjë, por thjesht për të qenë të qartë. Pasi të përgjigjet do të vazhdoj edhe për 30 sekonda.

Jorida Tabaku- Nuk po e diskutojmë këtë fare.

Edmond Spaho- E ka pasur për punën e tij si gazetar.

Jorida Tabaku- Nuk e ka pasur për korrupsion.

Edmond Spaho- Nuk e ka as për marrëdhënie biznesi, as për konflikt interesi tjetër. Jini seriozë, mos u tallni me ne këtu. Nëse doni të dëgjoni, rrini, nëse nuk doni, ikni, vazhdojmë vetë ne. Pse e prishni seancën? Pse keni frikë?

Jorida Tabaku- Të nderuar kolegë, ju lutem, mos na vononi punën, sepse kemi komision e koncesionit që po pret përjashta!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër!

Jeni duke na vonuar punën.

Zoti Ajazi, mbledhjen e drejtoj unë, do t’jua jap fjalën të bëni çfarë të doni, por ju lutem, po ju bëj edhe një herë thirrje, mos na bllokoni punën e komisionit!

Zoti Rama, fjala për ju.

Arben Pëllumbi- Nuk mund të vazhdojë zoti Rama.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Rama – Kam bërë disa shkrime në lidhje me inceneratorët dhe kompanitë që kanë marrë përsipër ndërtimin e tyre. Një prej këtyre shkrimeve është objekt i një padie civile në gjykatë, ende nuk ka filluar si proces, është në fazën paraprake. Në lidhje me të njëjtën nevojë, mund të them diçka që në përgjithësi në llojin e gazetarisë që unë ushtroj, e cila ka të

bëjë me hulumtimin, paditë, kryesisht ato civile që lidhen me dëmin e mundshëm të prezumuar që mund t'u shkaktohet kompanive, janë diçka normale, janë të natyrshme, madje në deontologjinë tonë të gazetarisë investigative ndonjëherë këto padi tregojnë deri diku shkallën e suksesit. Në përgjithësi kompanitë kërkojnë të rivendosin atë që ato e quajnë autoritet të humbur. Nuk është kjo padia e parë, unë kam pasur edhe padi të tjera civile, të cilat i kam fituar për shkak të punës që unë bëj dhe shkrimeve që kam bërë, mendoj se reputacioni është diçka që u takon si njerëzve, ashtu edhe kompanive, por është diçka që nuk fitohet në gjykatë, por duhet merituar.

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Ajazi, meqenëse e mori fjalën.

Besion Ajazi – Zonja kryetare, besoj se edhe nga përgjigjja e kolegut Rama, jemi të qartë se zoti Artani është në papajtueshmëri me statusin e dëshmitarit, e thotë edhe ligji neni 156, germa “ç”. Kështu që nuk është e udhës të vazhdojmë, në shkelje të Rregullores dhe të ligjit. Madje, zonja Kryetare, u bë e disata herë që unë, personalisht, por edhe kolegët e tjerë të maxhorancës jemi ndjerë se jeni duke drejtuar komisionin në një mënyrë joligjore, jo në bazë të Rregullores, dhe mos na detyroni që ta çojmë komisionin në atë hulli që nuk shkon, që të kërkojmë edhe shkarkimin tuaj si kryetare e komisionit, sepse jeni në shkelje të Rregullores, në shkelje të ligjit dhe në shkelje të Kodit të Procedurës Penale.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Shalsi.

Zoti Shalsi, vetëm 30 sekonda, meqenëse m'u drejtua mua.

Zoti Ajazi, për sa kohë ne këtu jemi duke hetuar një aferë korruptive, që është shkelur ligji me të katërta këmbët dhe po flisni dhe po mbron kriminelë në kërkim, frikë nuk duhet të kem unë nga ligji, por duhet të kenë ata që mbrojnë korrupsionin dhe kriminelët.

Zoti Shalsi, fjala për ju.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ndoshta ka lindur një keqkuptim, them ndoshta. Unë gazetarin në fjalë e njoh prej vitesh, i vlerësoj përpjekjet e tij dhe, kur them prej vitesh, prej vitesh, ndoshta edhe kur nuk kemi rënë dakord në të kaluarën për pikëpamje të ndryshme, thashë që e çmoj aktivitetin e tij dhe besoj unë askush nga kjo ana këtej nuk e vë në dyshim dhe aq më pak doja të siguroja një nga kolegët deputetë që të mund çojmë nëpër mend të intimidojmë gazetarë. Duke thënë këtë, ndaj e konsideroj keqkuptim, ka një ligj, të cilit ne i referohemi, doja ta dëgjoja me shumë vëmendje, por kolegët e mi shtruan faktin e një konflikti civil. As zoti Pëllumbi, as zoti Ajazi dhe askush tjetër nuk vunë në dyshim faktin që të dëgjojmë, kemi dëgjuar dhe do t'i dëgjojmë. Thelbi është: a mund të pyetet si dëshmitar një individ i nderuar, i cili ndodhet në një konflikt civil, në rastin konkret një konflikt gjyqësor, për të cilin do të shprehet gjykata? Ky është thelbi

i asaj që po themi dhe që duhet ta diskutojmë ndoshta edhe me shumë qetësi për të ndarë edhe pjesën e pushimit, për të parë mundësinë që, nëse ka papajtueshmëri me ligjin, siç po del edhe nga procedurat e kodit, edhe nga pika që iu referua kolegu, atëherë, jemi para këtij fakti: a mund të pyetet si dëshmitar një individ i nderuar, e theksoj, që ka një konflikt civil, pra ndodhet në një konflikt civil? Pastaj pjesa e asaj që ju thoni, jo korrupsioni po heton një rën apo tjetrën...

(Zoti Spaho flet pa mikrofon.)

Zoti Spaho, nuk kam ndërprerë asnjëherë njeri. Po e prezumoj atë që thoni ju sikur...

(Zoti Spaho flet pa mikrofon.)

Ne këtu mbështetemi mbi ligjin dhe mbi procedurat. A e thotë ligji që një person nuk mund të thërritet dëshmitar, nëse ka një konflikt civil?

Jorida Tabaku – Zoti Rama, që ta ndihmoj unë komisionin, a jeni marrë i pandehur nga organi i akuzës? A ju është komunikuar juve....

Artan Rama – Jo.

Jorida Tabaku – Ju është komunikuar ndonjë akuzë nga organi i akuzës?

Artan Rama – Jo.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Boçi, për procedurë.

Do të bëjmë 5 minuta pushim dhe do të diskutojmë me juristët.

Luçiano Boçi – Meqenëse zoti Ajazi i drejtoi pyetje zotit Rama, edhe unë kam një pyetje në lidhje me këtë akuzën që po hidhet si tymnajë këtu. Shkrimet tuaja i kam lexuar, zoti Rama, dhe ka shumë dokumente aty. Cilat mendoni se janë dokumentet...

Artan Rama – Nuk e kapa çfarë thatë, nuk, apo i keni lexuar?

Luçiano Boçi – I kemi.

I keni shoqëruar me publikimin e shumë dokumenteve. Cilat mendoni që janë dokumentet më sensitive, kontrata që ekziston midis Ministrisë së Energjisë dhe koncensionarit për shtyrjen e afatit 25-vjeçar, apo të tjerat? Cila ka qenë ajo kontratë që i dhemb?

Artan Rama – Në parim gjithçka, për të cilën unë vendos të bëj një shkrim, mendoj se është e rëndësishme, pastaj ju do të dëgjoni çfarë do të referoj mbështetur në fakte, ju mund ta gjykoni vetë; një gjykim, i cili mund të jetë ndryshe nga ai që unë mund të vlerësoj, por në përgjithësi gjithçka, që u përket shkrimeve të mia, mendoj se ka një interes të zgjeruar publik dhe ka një qëllim, i cili merret shumë kohë më parë se ju ta keni përfunduar shkrimin.

Jorida Tabaku – Pushim për anëtarët e komisionit dhe më pas do të diskutojmë pak me juristët dhe, zoti Rama, ju lutem, a mund të prisni jashtë dhe më pas do të rifillojmë mbledhjen?!

(Pas pushimit.)

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, do të rifillojmë mbledhjen!

I kërkoj stafit të komisionit që të thërresim zotin Artan Rama.

(Diskutime pa mikrofon.)

I kërkoj stafit të komisionit që të thërrasë deputetët për të filluar mbledhjen!

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë nuk kam nevojë për justifikim.

Zoti Pëllumbi, po ju pyes ju politikisht, si përfaqësuesi më i lartë, a do ta bojkotoni mbledhjen e komisionit, apo të vazhdojmë? Kaq është çështja! Uluni të vazhdojmë mbledhjen! Nuk jemi duke bërë shkelje ligjore.

(Diskutime pa mikrofon.)

Rendësi ka që të mos akuzohemi për korrupsion, sepse për kështu shkeljesh na çoni të gjithë në burg.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, meqenëse kemi një kuorum prezent për mbledhjen, dua që zoti Pëllumbi të jetë këtu, meqenëse kemi dakordësi që të jetë edhe zoti Pëllumbi!

Unë i mirëkuptoj qëndrimet politike që ka secila prej palëve tona, por, ju lutem, kemi rënë dakord që ky komision të vazhdojë punën. Keni vetëm 10 ditë kohë, tani, në qoftë se doni ta bllokoni, thoni që do ta bllokoni dhe ikim që të gjithë, por këtu ulur peng nuk na mbani dot.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk e kam filluar mbledhjen ende, sepse po ju pres ju. Nuk e kam filluar, pa pasur kuorumin.

Të nderuar kolegë, e fillojmë mbledhjen!

I kërkoj teknikës që të rifillojmë mbledhjen. Pas një pushimi të shkurtër, të dyja palët, sigurisht, u qëndrojnë mendimeve të tyre dhe bazës së tyre ligjore. Partia Demokratike insiston që ne do të vazhdojmë me pyetjen e dëshmitarëve. Bllokimi i këtij komisioni hetimor është i kotë. Askush nuk ka autoritetin dhe tagrin të dalë mbi vendimin e Kuvendit për të penguar punën e këtij komisioni. Zotëria, i cili është këtu prezent, është një gazetar, i cili pohoi se nuk është ngritur asnjë akuzë nga ana e institucionit të akuzës për të. Ashtu siç ka hedhur Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja padi për secilin prej nesh këtu, ka hedhur për të intimiduar edhe mediet. Unë këtë dua ta marr si një sinjal edhe për kolegët socialistë që ne nuk duhet të intimidohemi dhe duhet t'u dalim në krah medieve kurajoze.

Zoti Pëllumbi, kam 6 vjet që flas për këtë çështje dhe ju siguroj se ka pak media që flasin për këtë çështje. Ne duhet t'i mbështesim ato media. Dje e patë se çfarë buxheti marketingu kishte. Çfarë buxheti marketingu ka për medien? Unë kërkoj edhe një herë, bazuar

mbi ligjin, bazuar mbi precedencën e krijuar në këtë parlament dhe në komisionet parlamentare për t'i dhënë fjalën kujtdo, që është i përfshirë sipas planit të hetimit, njëkohësisht edhe listës së dëshmitareve të miratuar së bashku propozoj që të vazhdoj me pyetjet për dëshmitarin.

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Pëllumbi, më pas zoti Spaho për procedurë.

Arben Pëllumbi – Zonja Kryetare, së pari, nuk duhet të bëni asnjë lloj insinuate që këtu dikush dëshiron t'i pengojë, t'i pezullojë punimet apo se ju doni t'i vazhdoni, kurse ne nuk duam të vazhdojmë. Nuk dua që askush të vazhdojë të bëjë insinuata, si pak më parë që të na etiketojë ne sikur mbrojmë atë apo këtë, sepse nuk dua të përdor termat që u përdorën këtu nga kolegët tanë të opozitës. Ajo që ne po themi, dhe nuk e gjetëm dakordësinë edhe gjatë seancës së pushimit, është që një dëshmitar, i cili ka një konflikt, nuk mund të jetë pjesë e dëshmisë në këtë komision. Unë nuk besoj se zotërinë e nderuar në fjalë e ka penguar kush deri më sot që ta thotë të gjitha mendimin e tij dhe ta shprehë publikisht atë mendim. Është lexuar nga ia që ka dashur të lexohet, vazhdon akoma të ketë mundësi që të publikojë dhe të bëjë, pra askush atë nuk e intimidon në punën e tij. Ne këtu flasim vetëm për punën e këtij komisioni. Meqenëse ne nuk e gjetëm dakordësinë për faktin nëse duhet apo jo të dëshmojë zotëria, unë ju kërkoj që ta hidhni në votë nëse zotëria duhet të dëshmojë apo nuk duhet të dëshmojë.

Jorida Tabaku – Sipas rregullores së komisionit, dëshmia e çdo dëshmitari dhe përfshirja në listë e dëshmitarëve merret pa votë. Kemi rënë dakord për listën e dëshmitarëve, përfshirja në listë dhe çdo dëshmi merret pa votë. Në qoftë se ju doni të votoni kundër për diçka, sigurisht do të keni mundësi në fund për të votuar kundër edhe për raportin përfundimtar.

Zoti Spaho, fjala për ju.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Rama, që pranuat të vini në komision!

Si gazetar, ju keni kryer dy investigime në lidhje me inceneratorin e Elbasanit, një investigim për procedurat e ndjekura për hartimin e kontratës, dhënien e ofertës, shqyrtimin e saj, hartimin e kontratës deri në mbylljen dhe fillimin e punës për ndërtimin e inceneratorit dhe një të dytë që ka të bëjë me impiantin e prodhimit të energjisë elektrike dhe raportet e këtij impianti me pjesën tjetër të inceneratorit.

Unë dua t'ju pyes për të dyja çështjet, por le të mbarojmë me të parën për procedurën dhe më pas vazhdojmë me kontratën për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike. Në lidhje me procedurën, unë dua të dëgjoj nga ju që të më sqaroni në lidhje me emergjencën mjedisore në Elbasan. A ka pasur emergjencë mjedisore në Elbasan në periudhën kur është paraqitur oferta e pakërkuar? Nëse ka pasur emergjencë mjedisore, kush e ka shpallur?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju, nëse dëshironi të dëgjoni, dëgjoni, nëse nuk dëshironi, mund të ikni. Rrugën e keni të lirë. Nuk ka hedhje në votë për këtë çështje. Është marrë vendimi dhe do të vazhdojmë. Po të doni, dëgjoni; po të doni, ikni.

Faleminderit!

Mbi çfarë dokumentacioni është shpallur emergjence mjedisore?

(Diskutime pa mikrofon.)

Më pas cilat janë efektet e emergjencës mjedisore në procedurën e mbylljes së kontratës? Pra, dua të di nëse nuk ka pasur emergjence mjedisore, si do të vazhdohej dhe, nëse ka pasur emergjence mjedisore, cila është rruga dhe procedura që ndiqet?

Dua të më sqaroni: nga investigimet që keni bërë ju, a ka dokumente të tilla për çështjen që unë flas? Këto dokumente a janë në përputhje me ligjin, mbi të cilin është organizuar aktiviteti i ndërtimit të inceneratorit në Elbasan? Më pas do të vazhdoj me çështjen e dytë.

Artan Rama – Jo, nuk ka pasur emergjencë mjedisore. Në vitin 2014... *(Diskutime pa mikrofon.)*

Jorida Tabaku – Ia kam dhënë fjalën zotit Rama, sapo të mbarojë zoti Spaho, do t'ia jap kolegut për procedurë.

Zoti Rama, fjala për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, nuk e jepni ju fjalën në këtë komision. Pas zotit Spaho do ta merrni fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon)

Edmond Spaho – ...një aferë ku janë vjedhur para shtetërore dhe janë pastruar para!

Arben Pëllumbi – ...nuk ka asnjë lloj problemi, le të thonë çfarë të duan.

Deputet – Kur nuk ka konflikt...

Deputet – Po pse të mos e lënë të flasë? Ç'konflikt ka, more?!

Jorida Tabaku – Ju lutem, se mund ta zgjidh unë!

Të nderuar kolegë, ju lutem më dëgjoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

(Debat në sallë)

Ju lutem!

Të nderuar kolegë, më lejoni, besoj e sqaroj këtë çështje, duke cituar dy dokumente zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë: “Zoti Arben Ristani, nënkryetar i Komisionit Parlamentar për hetimin e CEZ-it, i ka kërkuar Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Ilir Meta, në datën

09.12.2016, të përjashtojë”, pikërisht për të njëjtat arsye që ju thoni, “si dëshmitar zotin Taulant Balla”. Është këtu shkresa e drejtuar nga zoti Ristani.

Zoti Ilir Meta, asokohe, Kryetar i Kuvendit, pjesë e maxhorancës me Partinë Socialiste, pasi analizon të gjitha faktet dhe provat, po njëkohësisht edhe legjislacionin, thotë: “Në vlerësimin tim, të mbështetur edhe në vlerësimin e bërë nga Shërbimet e Kuvendit, ngritja, shqyrtimi dhe vendimmarrja në rastin e papajtueshmërisë së anëtarit të komisionit hetimor shterohen brenda komisionit hetimor përkatës dhe nuk gjykohet që ka konflikt interesi në rastin e kësaj pjesëmarrjeje”. Kjo është një shkresë zyrtare e Kuvendit nga ish-Kryetari i Kuvendit, bazuar mbi një kërkesë të bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për ta përjashtuar.

Besoj që këta precedentë ne i kemi ezauruar.

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Unë, të nderuar kolegë, ju lutem...

Edmond Spaho – Ky është një shembull që edhe specialistët e komisionit, që i kemi thirrur këtu për të na dhënë ndihmë të specializuar...

Jorida Tabaku – Të mos politizohen.

Edmond Spaho – ...të mbajnë qëndrime asnjëse dhe jo partiake.

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Ju lutem, ta përfundoj diskutimin, dhe pastaj do ta marrin fjalën kolegët.

(Deputetja Dhima ndërhyr pa mikrofon.)

Antoneta Dhima – ...askush nga ju.

Jorida Tabaku – Ju lutem!

Antoneta Dhima – Këtu jemi të gjithë për të zbatuar ligjin.

Jorida Tabaku – Zonjë, fjalën e jap unë!

Jam duke folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e jap unë në këtë komision.

Të nderuar kolegë, ne nuk duhet të kemi frikë nga fjala e gazetarëve. Duhet t’i mbrojmë gazetarët të flasin këtu. Le t’i lëmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është në konflikt interesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, problemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Këlliçi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Rama, ju lutem, mund të vazhdojmë me përgjigjen e pyetjeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – ...i cili nuk është i drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një vendim jo i drejtë.

Të nderuar kolegë, ju lutem!

Zoti Pëllumbi, ju lutem, ju kam dëgjuar boll për procedurë!

Ju dhashë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka...

Zoti Pëllumbi, me gjithë respektin që kam për ju, një herë bëheni palë për të mbrojtur kriminelët në kërkim, një herë për kompanitë koncesionare...

Ju lutem, t'u japim fjalën gazetarëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zoti Rama, e keni fjalën ju.

(Debat në sallë)

Arben Pëllumbi – Ne kemi një çështje ligjore për t'u zgjidhur. Nuk e zgjidhni dot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Belind Këlliçi – Jo.

(Diskutime në sallë)

Jorida Tabaku – Dëshmitari merret në dëshmi pa votim.

Arben Pëllumbi – E kemi marrë.

Jorida Tabaku – Dëshmitari nuk përjashtohet dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare, për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju kërkoj që t'ia japim fjalën zotit Artan Rama. Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e jap unë, pra, zoti Pëllumbi.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Kemi një kërkesë, pra, për papajtueshmërinë...

Jorida Tabaku – Antonela, ju nuk jeni sekretare personale e askujt...

(Kryetarja e komisionit i drejtohet pa mikrofon këshilltares së komisionit.)

...ju shkoni t'u flisni në vesh deputetëve.

Tani të flasim formalisht se jemi në komision.

Lefter Gështhenja – Mos është anëtare partie ajo.

Jorida Tabaku – Është duke dëshmuar zotëria... Tani, si suflerë të gjithë nga mbrapa...

Lefter Gështhenja – Mos është patronazhiste ajo. Mos është anëtare partie ndoshta.

Jorida Tabaku – Tani, mirë që e kemi kundër këtu gjysmën e qeverisë me radhë, e me gjykata me radhë, por edhe stafi i Kuvendit...

Ju lutem, secili të ruajë pozicionin e vet!

Na lejoni që zoti dëshmitar, zoti Artan Rama, të japë dëshminë e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëria nuk ka asnjë konflikt interesi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Rama, të lutem, vazhdoni.

Fadil Nasufi – A ka mundësi, për procedurë?

(Debat në sallë)

Besion Ajazi – ...këtu mbrapa, që nuk ka asnjë konflikt dhe do ta dëgjojmë me shumë kureshtje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Çfarë konflikti ka? Ndonjë kontratë biznesi me Mirel Mërtirin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, një sekondë! Ju lutem!

Ne kemi ministra në këtë komision që kanë dhënë leje koncesioni dhe nuk i përjashtoni, e më tregoni mua që paska konflikt interesi ai!

As i kam pyetur ndonjëherë anëtarët e këtij komisioni, hani dreka apo darka me Mirel Mërtirin? Keni konflikt interesi dhe merreni me gazetarët atje të cilët kanë folur prej gjashtë vjetësh për këtë çështje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare, nëse flasim për...

Antoneta Dhima – Nuk kemi ngrënë as dreka, as darka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – ...redaksi sa keni djegur ju, do të mbronin gazetarët tani.

Diskutimi nuk është fare për gazetarin, është diskutim për ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje...

(Deputeti Xhafaj flet pa mikrofon.)

Besion Ajazi – Ej, o Belind, gazetari...

Edmond Spaho – A e kuptoni...?

(Diskutime në sallë)

Jorida Tabaku – Zoti Rama, të lutem.

Edmond Spaho – A e kuptoni që ju është prishur karakteri?

A e kuptoni apo jo? Po vini karakteret tuaja në funksion të urdhrit të partisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...që ose ta prisni këtë seancë, ose nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa logjikë, pa argumente, në kundërshtim me të gjitha procedurat që janë ndjekur në Kuvend më përpara.

Mua do të më vinte turp po të veproja kështu...

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

...sepse jeni njerëz, jeni qytetarë me formim intelektual, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që po silleni në mënyrën më të papranueshme, vetëm e vetëm që t'j shërbeni Partisë që ai të mos flasë!

Antoneta Dhima (off) – Nuk ka lidhje fare me partinë!

Edmond Spaho – Ju qofshi që keni frikë nga fjala e një gazetari për atë që e ka shkruar hapur, ka vënë kokën e tij në rrezik, është kërcënuar dhe ju i thoni: “Ke konflikt interesi!”, në një kohë kur asnjëri prej jush nuk e ka bërë atë. Përkundrazi, drejtues të rëndësishëm të maxhorancës, me Mirel Mërtirin, kanë ngrënë e kanë pirë, kanë udhëtuar në të njëjtën makinë! Dhe i thoni gazetarit që ka konflikt interesi.

Etjen Xhafaj – Dil e denoncoji të tëra!

(Debat në sallë)

Arben Pëllumbi – Zoti Spaho, askush këtu nuk ka asgjë me punën e nderuar të zotërisë. Ai zotëri nuk është penguar ta bëjë punën e tij, të cilën e ka bërë deri sot ashtu siç e ka gjykuar. I lumtë për punën që bën! Do të vazhdojë ta bëjë punën.

Ne po flasim vetëm për papajtueshmërinë e të qenit dëshmitar në këtë komision, nuk ka lidhje me detyrën e tij. Detyrën e tij është i lirë ta bëjë ai.

Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në papajtueshmëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po e prishni ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni 40 dëshmitarë. Për një dëshmitar doni të shkëlmi Rregulloren?

Ishim në padijeni kur është aprovuar lista. Le që zotëria nuk ka qenë fare në planin e hetimit kur e kemi aprovuar këtë të fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por është në papajtueshmëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në papajtueshmëri; nuk mund të dëshmojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e thjeshtë. Në qoftë se doni ta ndërpresim mbledhjen për një dëshmitar, e keni një kërkesë të cilën jeni të detyruar ta hidhni në votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam bërë një kërkesë në këtë komision për shpalljen në papajtueshmëri të dëshmitarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Përsëritja është mëmë e dijes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke lexuar? Do të vesh në SPAK? Çoje atje si dokument në SPAK, meqenëse je në SPAK edhe ti.

Belind Këlliçi – ... po, patjetër.

Madje e kam krenari që jam në SPAK me inceneratorin e Tiranës...

Antoneta Dhima – Çoje atje!

(Deputeti Këlliçi flet pa mikrofon.)

Ki durim!

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem!

(Debat në sallë)

Nuk flet. Ia kam dhënë 10 herë fjalën. Nuk flet, se ka zhurmë.

Lefter Gështhenja – Merreni fjalën.

Jorida Tabaku – Zoti Rama, ju lutem, zoti Spaho ju bëri disa pyetje.

Mund t'u përgjigjeni, ju lutem?

Artan Rama – E vetmja gjë që kam, është të përmbush arsyen pse jam thirrur dhe kam ardhur.

Dua që në momentin kur flas të dëgjohem. Kjo gjë nuk po ndodh, ndaj edhe kam një si ngurrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kaq kohë, personalisht...

Etjen Xhafaj – Është me vendim të ndërmjetëm... Dhe tani duhet respektuar ndonjë gjë në këtë histori, se po dalim komplet nga...

Dhe nuk ka nevojë fare për të bërtitur. Asnjëri nuk ka gjë personale me zotërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Dëgjojeni pra.

Etjen Xhafaj – Nuk ndryshon bota në qoftë se flet apo nuk flet këtu. Ne duhet të zbatojmë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë që është e shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, ne të ndarë e kemi mendjen!

(Debat në sallë)

Luçiano Boçi – Zoti Pëllumbi, ju bëni pagesa milionëshe sot për Klodian Zoton, sot që është në kërkim ai, dhe ndaloni gazetarin të japë një dëshmi, për një arsye që ju e gjykoni që është e rëndësishme?

Jepni miliona nga buxheti i shtetit...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është i shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe ju vazhdoni të jepni lekë, ndërkohë gazetarin nuk e lini të dëshmojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – Zbato Rregulloren dhe kaloje në votim pastaj.

Luçiano Boçi – Kaq, more!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Ku e ke në rregullore? Ma lexo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – Neni 16 “Thirrja për të dëshmuar”: “Thirrja e dëshmitarëve...

Luçiano Boçi – Ja, ta lexoj unë...

Etjen Xhafaj – ... bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

Fadil Nasufi – Thirrja e dëshmitarëve bëhet me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 17, pika 2: “Thirrja e dëshmitarëve bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Etjen Xhafaj – Po pra, por ne nuk e dimë.

Lefter Gështenja – Ne kemi marrë vendim për të thirrur ish-ministrin.

Ne interpretojmë ende...

Ky komision...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, keni një kërkesë nga ana ime për ta shpallur dëshmitarin në papajtueshmëri.

Edmond Spaho – E ke të gabuar.

Arben Pëllumbi – Po pra, kemi bërë një kërkesë për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, jeni duke shkelur...

Arben Pëllumbi – Këtë gjë e diskutuam.

Jorida Tabaku – ...ligjin.

Edmond Spaho – Ta lexoi zonja kryetare...

Arben Pëllumbi – Kemi bërë një kërkesë...

Edmond Spaho – ...interpretimin e Kuvendit në një rast të ngjashëm dhe Kuvendi, shërbimet juridike të tij, e kanë rrëzuar kërkesën e Arben Ristanit asokohe për përjashtimin e dëshmitarit.

Arben Pëllumbi – Po pra, është bërë një shkelje atëherë, të vazhdojë të bëhet edhe tani, thoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Nuk është bërë shkelje.

Arben Pëllumbi – Po si?

Edmond Spaho – Është interpretim juridik. Prandaj e thashë, ai interpretim juridik është shembull për më shumë seriozitet dhe profesionalizëm edhe nga stafi i Kuvendit që është vënë në dispozicion të këtij komisioni.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, meqenëse ju nuk po e merrni në konsideratë kërkesën time për shpalljen e papajtueshmërisë së dëshmitarit, unë e drejtoj kërkesën për të ndërprerë mbledhjen...

Edmond Spaho – Jo, nuk mund të interpretojmë sipas interesave të ngushta dhe partiake!

Arben Pëllumbi – ...deri në një moment tjetër.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, në shkelje të Rregullores dhe të ligjit, zoti Arben Pëllumbi më kërkoi të hedh në votim një kërkesë joligjore.

Lista e dëshmitarëve është miratuar, është rënë dakord, pra unë nuk hedh dot për votim një kërkesë joligjore. Ndërkohë, ai tani po kërkon që mbledhja të ndalojë dhe të mos vazhdojë.

Arben Pëllumbi – Të ndërpritet. Po, deri sa ta sqarojmë këtë çështje, unë nuk mendoj që mund të vazhdojmë.

Jorida Tabaku – Ne, fatkeqësisht, nuk i kemi votat në këtë komision. Ndërkohë, janë duke pritur katër dëshmitarë shumë të rëndësishëm për këtë komision, të cilët do të na japin informacion.

Unë kam vetëm një pyetje: pse ju djeg gjëja që do të thotë zoti Artan Rama?

Arben Pëllumbi – Shkelja e ligjit.

Jorida Tabaku – Çfarë problemi ka...?

Arben Pëllumbi – Shkelja e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Fjalën e ka kërkuar për procedurë zonja Denaj.

Arben Pëllumbi – Deri sa ne të jemi të qartë që nuk po e shkelim ligjin, unë kërkoj ndërprerjen e kësaj mbledhjeje, pra deri sa të jemi të qartë për këtë gjë.

Anila Denaj – Faleminderit, kryetare!

Në frymë të ligjit dhe të njohjes me dëshmitarët, në momentin kur vihemi përballë tyre, sikurse në rastin e mëparshëm, edhe në rastin konkret, me të gjithë respektin për ju dhe për çdo gazetar, ne nuk i njohim dëshmitarët më përpara, unë personalisht, por besoj edhe kolegët e tjerë dhe në momentin që hyjmë dhe shikojmë, vihemi në dijeni për informacione si në rastin e gazetarit të mëparshëm, ashtu edhe të gazetarit aktual dhe, për sa kohë ka një papajtueshmëri, në gjykimin tonë juridik, ky diskutim hidhet në votë.

Kjo nuk ka të bëjë me fjalën e lirë, në mënyrë absolute, sepse ne do të kemi edhe gazetar tjetër në dëgjuesë, dhe kjo nuk do të thotë që ne jemi kundër dëgjuesës së gazetarëve, por në frymë të ligjit për papajtueshmëri dhe për njohjen me këtë fakt tani, ne gjykojmë që ky komision i nderuar duhet ta marrë bazën juridike më të fortë sesa diskutimi që po bënit pak më parë me njëri-tjetrin.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Denaj, bazë juridike më të fortë sesa një vendim i Kryetarit të Kuvendit, unë nuk besoj që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një vendim i Kryetarit të Kuvendit për interpretimin e saj. Për precedencën në raste të ngjashme ju kam cituar tre raste të ngjashme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Jua kërkoj jo vetëm njerëzisht, por edhe politikisht, nëse jeni të interesuar të hedhim dritë në këtë aferë, siç thoni, të mos bëhemi mburojë politike e daljes së fakteve të rëndësishme.

Unë e kuptoj se çfarë po bëni me këtë dëshmitar dhe me dy të tjerët vijimësisht, në këtë komision disa dokumente të rëndësishme mungojnë.

Dëshmitarët që do të vijnë tani dhe më pas do t'i sigurojnë këtij komisioni dokumente tejet të rëndësishme që nuk i kanë sjellë institucionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe unë e kuptoj që ju doni ta pengoni këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj që doni ta pengoni këtë gjë, sepse kanë shkruar për atë gjë!

(Debat në sallë)

Kanë shkruar!

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, keni një kërkesë për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, më lini ta përfundoj logjikën!

Unë e kam thirrur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Boçi, një sekondë!

E kam thirrur zotërinë si dëshmitar, sepse ka shkruar për një leje koncesionare të dytë mbi inceneratorin e Elbasanit. Ia kam kërkuar Ministrisë së Mjedisit, nuk ma ka dhënë.

E kam thirrur dëshmitare zonjën Aleksandra Bogdani, sepse ka shkruar për një dosje hetimore të një aksidenti të zotit Arben Ahmetaj. Ia kam kërkuar ministrit të Drejtësisë, nuk e ka sjellë.

Unë, kur i kam kërkuar dëshmitarët, nuk i kam kërkuar vetë, kështu, nga dëshira, por kemi lexuar, kemi analizuar dosjet, prandaj i thërrasim këtu si dëshmitarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht. Tani, vjen këtu zëvendëskryetarja e komisionit dhe më thotë mua se çfarë do të thotë drejtoresha e ATRACO-s. Ajo e di se çfarë do të thotë kjo e fundit.

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

Po, sigurisht, se kanë shkruar shkrime.

Antoneta, lexo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se po përfundon!

Deputete – Joridë! Zonja Tabaku, “për ty”, jo “mi”. Të lutem!

Jorida Tabaku – Po pra, po, këto që kanë shkruar!

Arben Pëllumbi – Zonja Tabaku...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – ...publike. Ndaje, ndaje këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – ...zonja kryetare, ju nuk po e bëni mbylljen e mbledhjes.

Antoneta Dhima – Ato që kanë shkruar, janë publike. Ju po thoni që do të sillni prova të reja. Ku i keni?

Arben Pëllumbi – Antoneta!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Pëllumbi, pastaj ju.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, të lutem, unë ju bëra një kërkesë dhe ju jeni e detyruar të hidhni në votë kërkesën time. Nuk e morët në konsideratë kërkesën e parë për shpalljen e dëshmitarit në papajtueshmëri? Jeni e detyruar të merrni në konsideratë kërkesën time për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje ose ta hidhni menjëherë atë në votë. Kjo nuk diskutohet që është kështu.

Nuk kemi asgjë me dëshmitarin, por kemi të bëjmë me zbatimin e një procedure dhe mosshkeljen e ligjit. Deri sa ne të qartësohemi që jemi në mosshkelje të ligjit apo në shkelje të ligjit, unë kërkoj ndërprerjen e kësaj mbledhjeje.

Duhet ta hidhni në votë.

Jorida Tabaku – Fjalën e kanë kërkuar për procedurë zoti Boçi dhe pastaj zoti Nasufi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Atëherë, në të gjitha rastet kur ka diskutime për interpretimin e rregulloreve apo pasazheve të ligjeve, në komision vendos tradita parlamentare. Prevalon tradita parlamentare. Kështu zgjidhet, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

jo, mbi interpretimet thashë, interpretimet e ndryshme që bëhen qëndrojnë të dyja. Në raste të tilla merret në konsideratë një traditë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta them deri në fund.

Pra, merret në konsideratë tradita parlamentare dhe kësaj tradite, hap regjistrimet, jo pak më larg se në seancën e parafundit, i është referuar kryetari juaj i grupit tuaj parlamentar, sesi është zgjidhur çështja kur ka pasur diskutime ligjore. Edhe Mondit e di mirë, se ka pasur

debat për këtë gjë, por s'dua ta referoj këtu çështjen, se nuk dua të zgjatem, nuk është e rëndësishme.

Tradita parlamentare e pasqyruar nga Kryetarja e Kuvendit, na thotë që ne duhet të vazhdojmë me dëgjesën e dëshmitarit. Është shumë e thjeshtë. Ne kemi debatet tona juridike, dhe interpretimi juridik, s'po dalim mbi ligjin, se qëndrojnë të dyja vlerësimet, por prevalon tradita parlamentare. Është ajo që vendos. Sipas traditës parlamentare gazetari duhet të vazhdojë dëshminë e tij. Çfarë ka këtu për të diskutuar, për të vazhduar më gjatë? Marrim në konsideratë traditën parlamentare. Kur je i paqartë, vendos tradita, zoti Pëllumbi. Kur je i paqartë vendos tradita parlamentare dhe është e sanskionura, që ne do të vazhdojmë me dëgjesën e dëshmitarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Unë po flas, më vjen keq. Nuk dua të hyj në pjesën e edukatës, se ne nuk ju ndërpresim kur flisni.

Është e saknsionuar, vendos tradita parlamentare. I është referuar kryetari juaj i grupit parlamentar disa herë. Ne në komision kështu i zgjidhim çështjet dhe ju kështu i keni zgjidhur. Ne gjykojmë të ndjekim traditën parlamentare, e cila thekson sipas rasteve që solli zonja Tabaku të vazhdojmë me dëgjesën e dëshmitarit

Jorida Tabaku – Zoti Boçi, ju lutem. Unë e kam të pamundur ta menaxhoj mbledhjen kështu.

Atëherë, do të bëjmë 5 minuta pushim, që ta riduskojmë edhe një herë. Zoti Nasufi e mbyll diskutimin për këtë çështje dhe pastaj do të diskutojmë si do të vazhdojmë me dëshmitarët.

Zoti Nasufi, ju lutem dhe pastaj 5 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, këtë mbledhje nuk e ndërpresim. Zoti Pëllumbi, kemi dëshmitarët që kanë ardhur. Jo unë mendova se ju kërkonit pushim që ta diskutojmë. Jo, ju lutem, mos u bëni pengesë për mbledhjet e komisionit hetimor.

Zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Në gjithë debatin që po bëjmë, po duket sikur ne jemi kundër dëshmitarit konkret apo kundër...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ore ti, nuk të foli njeri. Çudi e madhe.

Po prit, more zotëri, ke folur sa ke dashur me zë, me mikrofon, pa mikrofon, nuk të ka ndërhyrë njeri.

Këtu po flasim në bazën e një rregulloreje. Neni 4 ka parimet e veprimtarisë dhe në pikën 2 thotë: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij hetimore, komisioni udhëhiqet nga parimet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, neni 4 i ligjit nr. 8891, datë 2. 05. 2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”. Pikërisht, këtë po kërkoj. Dhe në nenin 17, thirrja për të dëshmuar, në pikën 2 thuhet: “Thirrja e dëshmitarëve bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

Ndërsa, për sa i përket praktikës së drejtimit të mbledhjes nga ana juaj, për rregull ka procedurë, një nga krahu i minorancës, një nga krahu i maxhornacë dhe drejtohet mbledhja me rregulla, jo të flasë kush ka zë më shumë, pasion dhe emocion më shumë. Ne do të ishim të kënaqur që e gjithë magjia e mbylljes së këtij procesi hetimi të ishte te zotëria, po nuk kemi gjë me zotërinë, e kemi me procedurën ligjore që do të bëjmë. S’kemi gjë as me gazetarët. Shumë mirë që kanë pasur kurajën, kanë gërmuar dhe hedhin në vëmendjen e publikut probleme për të cilat ka ndjeshmëri publike. S’kemi lidhje me këtë, kemi lidhje me procedurën ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

I ke këtu të shkruara këtu

Edmond Spaho – Po shpikni praktika që nuk janë në asnjë vend të botës. Ne kemi të drejtë të pyesim këtu edhe të dënuar për këtë çështje, po qe se kanë dijeni për çështjen. Ne kemi të drejtë t’i thërresim dhe t’i dëgjojmë. Ju më thoni mua, se nuk duhet dëgjuar ai që ka shkruar për këtë! A jeni në terezi? Po thoni marrëzira, më falni që po ju drejtohem me të tilla terma.

Jorida Tabaku – Ju lutem, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Ne kemi të drejtë të pyesim edhe të dënuar për këtë çështje, në qoftë se ata kanë dijeni për çështjen.

(Debat pa mikrofon në sallë)

Jorida Tabaku – Ju lutem.

Zoti Këlliçi, jam duke folur unë. Unë edhe zoti Pëllumbi arritëm një dakordësi, që deri kur ta sqarojmë këtë çështje dhe t’i bindim palët se zoti Artan Rama mund të dëshmojë në komision, i kërkojmë zotit Rama të presë dhe dua të thërras dëshmitaren e radhës.

Dëshmitarja e radhës është zonja Aleskandra Bogdani.

U kërkoj ndjesë të gjithë dëshmitarëve, unë kam dëshirë që të gjithë specialistët e Partisë Demokratike, që janë në këtë komision bashkë me stafin e komisionit, të arrijmë një dakordësi për këta dëshmitarë. Zoti Rama, me shumë xhentilesë, priti, në fakt, ai ka qenë që në fillim të kësaj seanca, por që të mos pengojmë dëshminë, dua të vazhdojmë me dëshminë e radhës ndërkohë që sqarojmë këtë çështje.

Zonja Bogdani, dua t’ju lexoj rregulloren e brendshme të komisionit. Dëshmia juaj do të merret pas kryerjes së betimit dhe unë dua t’ju kujtoj që sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës

Penale, dëshmia e rreme në këtë komision dënohet me 2 deri në 6 vjet, Kodi i Procedurës Penale, neni 360 “Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit”.

Ju lutem, përsërisni pas meje në fund: “Betohe se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë.”

Aleksandra Bogdani – Betohe!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zonja Bogdani, ju lutem, bëni një prezantim për veten, kush jeni dhe çfarë keni shkruar për çështjen e inceneratorëve.

Aleksandra Bogdani – Unë jam Aleksandra Bogdani. Jam gazetare e rrjetit Ballkanik të gazetarisë investigative me qendër në Tiranë.

Në fakt, për inceneratorët ne kemi filluar të hulumtojmë dhe të shkruajmë që në vitin 2017, në rastin e Fierit, që kur pati protesta. Sigurisht, për shkak të interesit të lartë publik mbi këtë çështje, kemi vazhduar të hulumtojmë edhe në vazhdim, edhe me shkrime në kohët e fundit. Ato sigurisht vazhdojnë edhe aktualisht, por mendoj se shkrimet objekt për të cilat më keni ftuar, kanë qenë në shtator të vitit 2020, të cilat janë publikuar në portalin tonë.

Jorida Tabaku – Zonja Bogdani, i njihni ju shtetasit Klodian Zoti, Mirel Mërtiri dhe Stela Gugallja? A kanë komunikuar ndonjëherë me ju gjatë kohës kur keni shkruar për këtë temë?

Aleksandra Bogdani – Jo.

Jorida Tabaku – A kanë komunikuar me përfaqësues të medias suaj për shkrimet që ju keni publikuar për temën e inceneratorëve?

Aleksandra Bogdani – Jo. Ne mbasi kemi mbledhur të gjitha faktet e duhura për shkrimin, u kemi dërguar pyetje zotërinjve në fjalë, por nuk kemi marrë përgjigje.

Jorida Tabaku – Unë dua t’ju falënderoj, se investigimet që ju dhe rrjeti juaj keni bërë, jo vetëm për temën e inceneratorëve, kanë qenë shumë të plota dhe ne u kemi referuar herë pas here edhe në Kuvend. Ato kanë qenë profesionale, ashtu si edhe ato të zotit Rama, që ne shpresojmë ta dëgjojmë deri në fund të këtij komisioni. Unë kam dëshirë të na jepni disa informacione për shkrimin e parë që ju keni bërë për këtë temë dhe si filluat të denonconi këtë aferë korruptive.

Aleksandra Bogdani – Në fakt, shkrimi është publik dhe unë nuk jam dëshmitare, jam gazetare, që mbledh fakte, mbledh dokumente. Përmes ligjit për të drejtën e informimit janë mbledhur shumica e dokumenteve për këtë shkrim. Unë intervistoj njerëz, pra çfarë dua të shpjegoj këtu është se nuk mund të të dëshmoj në lidhje me atë që dëshmitarët e tjerë më kanë thënë mua. E gjithë puna ime është për të informuar publikun dhe në këtë rast shkrimet janë

publike, janë në faqen tonë të internetit, janë bërë pjesë e debatit publik, për një kohë shumë të gjatë, kështu që ndoshta nuk është nevoja të riprodhoj shkrimet që unë kam raportuar.

Jorida Tabaku – Në mënyrë specifike, unë i kam lexuar dhe disa prej tyre i kam këtu. Kam lexuar edhe njërin prej shkrimeve që është bërë objekt debati në interpelancën që kam pasur me zotin Damian Gjoknuri, ku është përfshirë në debat edhe zoti Arben Ahmetaj. Ju keni shkruar në lidhje me një aksident të ndodhur në autostradën Tabanicë - Kumanovë, rruga që lidh Serbinë me Maqedoninë e Veriut, dhe keni marrë një dosje hetimore ose informacione nga gjykata, të cilat ne ia kemi kërkuar edhe zyrtarisht edhe Ministrisë të Drejtësisë, që t'ia sjellë këtij komisioni, por deri më sot nuk i ka sjellë. Njëkohësisht, ju keni investiguar për lidhjen e dy personave me zotin Arben Ahmetaj.

Mund të na informoni se si e keni marrë këtë dosje hetimore?

Aleksandra Bogdani – Ne nuk kemi pasur dosjen hetimore. Ne kemi pasur vendim e gjykatës së Kumanovës, i cili, mesa mbaj mend, është i shtatorit të vitit 2017, pra i periudhës mbas një muaji e ca, pasi kishte ndodhur aksidenti në Maqedoni. Vendimi është marrë përmes ligjit për të drejtën e informimit. Pra, kolegët tanë në Maqedoni kanë bërë një kërkesë për të drejtë informimi dhe e marrë kanë këtë vendim nga gjykata e Kumanovës në rrugë zyrtare.

Jorida Tabaku – Po, vendimi i gjykatës së Kumanovës është i datës 13.07.2020 dhe në vendimin e gjykatës janë me iniciale emrat e të gjithë personave të përfshirë. Si arritët të zbuloni që ishin zotërinjtë, të cilët ju përmendi në shkrim?

Aleksandra Bogdani – Aksidenti ka qenë publik. Ka pasur raportime në media në lidhje me këtë gjë. Emri i Mirel Mërtirit nuk është i anonimizuar në atë vendim, sepse është kërkuar në lidhje me këtë person, por edhe nga kryqëzimi i fakteve, se është një punë rëndom që ne gazetarët bëjmë, pra, kryqëzimi i fakteve që kishin dalë më përpara, që ishin publikuar nga aksidenti, me vendimin e gjykatës, sigurisht që të çojnë te këta emra.

Jorida Tabaku – Edhe pas shkrimit tuaj, edhe në debatin publik që unë kam pasur me zotin Ahmetaj, ai e ka pranuar që ka qenë pjesë e këtij aksidenti, megjithëse këtu është me iniciale dhe janë një sërë njerëzish që janë me iniciale, përveç zotit Mirel Mërtiti, ashtu siç e cituat edhe ju, sepse për të bëhej kërkesa.

Unë do ia kaloj fjalën zotit Këlliçi, për dy pyetje, pastaj edhe zotit Pëllumbi.

Belind Këlliçi – Pikë së pari dua t'ju falënderoj ju, personalisht, edhe rrjetin investigativ BIRN, për punën e jashtëzakonshme që keni bërë në dhënien e një shembulli për të gjitha mediat e vendit, por edhe për të gjithë gazetarët investigativë, që duhet ta vrasin frikën dhe të mos bien pre, qoftë e shantazheve, qoftë e pagesave të kompanive të inceneratorëve, për reklama nëpër portale apo media të ndryshme.

Për të fat të keq, ne e kemi thënë dhe rithënë disa herë, kjo aferë nuk është vetëm ekonomike, por është një aferë që tërësisht është lidhur me censurën mediatike që i është bërë kësaj vjedhjeje skandaloze të taksave të qytetarëve shqiptarë.

Zonja Bogdani, unë dua të di nga ju, nëse ka diçka që ju doni ta thoni në këtë komision në lidhje me të gjitha hulumtimet që ju keni bërë, në lidhje me të gjithë shkrimet që ju keni bërë, ndonjë fakt që ju do të doni ta risillni në vëmendje, apo ta sillni në vëmendje në këto momente, që ende nuk mund ta keni bërë publik apo ndonjë dokument që e keni si risi. Unë i kam lexuar, besoj të gjithë në këtë komision i kanë lexuar, të gjitha shkrimet tuaja me shumë vëmendje, por dua të di nëse keni ndonjë qoftë informacion të ri apo ndonjë risi në lidhje me të të 3 inceneratorët, se ju nuk keni shkruar vetëm për Fierin, kam përshtypjen, keni shkrua për të 3 inceneratorët, nëse mund të na jepni diçka shtesë.

Faleminderit!

Aleksandra Bogdani – Në fakt, ta sqaroj edhe një herë punën tonë. Ne punojmë që të informojmë publikun dhe gjithçka që kam pasur në lidhje me këtë çështje është tashmë publike. Dokumentet që kanë shërbyer për të ndërtuar shkrimet tona janë të bashkangjitur me shkrimet në portalin tonë, mund t'i aksesojë kushdo aty. Shumica e dokumenteve janë marrë nga institucione zyrtare, po themi, raporte të Kontrollit të Lartë të shtetit, ekstrakte të QKB-së, hetime të mëparshme të prokurorisë lidhur me 3 kompanitë koncesionare, si dhe personat që lidhen me këto kompani koncesionare. Kështu që, unë gjithçka që kam pasur e kam mbledhur për të informuar publikun dhe siç e thashë, çdo gjë është publike. Kështu që, unë nuk kam ndonjë dokument shtesë ose informacion shtesë për ta ndarë me ju në këtë rast.

Jorida Tabaku - Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Bogdani, në veprimtarinë tuaj të gjatë publicistike në përgjithësi, por dhe në veçanti për këtë çështje, për të cilën jeni thirrur të dëshmoni sot këtu përpara këtij komisioni, keni pasur presion apo ndonjë ekran, apo fletë gazete, të cilat nuk ju janë vënë në dispozicion, për të nxjerrë ato dokumentet apo faktet, siç i mendoni ju, për t'ia bërë të qarta dhe të njohura publikut?

Aleksandra Bogdani – Neve gazetarëve, përgjithësisht, nuk na pëlqen të flasim për veten ose të bëhemi vetë lajmi. Kështu që në këtë rast, ka pasur goxha interesa që shkrimi të mos dilte, ka pasur një farë presioni, në lidhje me këtë gjë, edhe nga palët, të cilat i kemi kontaktuar për të marrë qëndrimin e tyre. Pra, ne donim që secili të kishte një zë në shkrimet tona. Ka pasur një padi për Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative, mbasi shkrimi u botua. Megjithatë, kjo është puna jonë, të hulumtojmë, ndonjëherë të këmbëngulim, të përdorim legjislacionin në fuqi, për të siguruar dokumente. Nuk ka qenë e thjeshtë, për hir të së vërtetës,

për t'i siguruar këto dokumente dhe shumë herë jemi detyruar të bëjmë ankesa te Komisioneri për të Drejtën e Informimit për vendime, që duhet të ishin dokumente publike, të cilat duhet të na viheshin në dispozicion vetëm me një kërkesë në mënyrë të thjeshtë. Ka qenë një punë e gjatë hulumtuese në këtë rast dhe janë përdorur të gjitha atotribute që ne na jep ligji për t'i aksesuar këto dokumente, por jo me lehtësi.

Arben Pëllumbi – Ju falënderoj!

Unë nuk vura në diskutim as impenjimin tuaj dhe as lodhjen që ju bëni, se nuk jeni thirrur për këtë, as ju dhe as rrjeti juaj. Ajo që unë ju pyeta është nëse ju, personalisht, në ushtrimin e detyrës suaj të gazetarit për të informuar me vërtetësi publikun, keni pasur presione të drejtpërdrejta për të mos i publikuar këto fakte? Jo, vështirësinë që mund të ndeshni për të marrë këto informacione dhe nuk po ju kërkoj se cilat janë burimet tuaj të informacionit, se edhe mund ta bëja edhe këtë pyetje. Pra, dua të di: a keni pasur ju, personalisht apo rrjeti juaj pengesa për të publikuar faktet?

Aleksandra Bogdani – E përmenda edhe më parë, në momentin kur ne u kemi dërguar pyetje ose kemi tentuar të intervistojmë dhe palën tjetër, na është thënë që do të paditeni dhe ne e dinim shumë mirë këtë gjë. Ne si gazetarë dhe media ku punojmë e dinim, se na është thënë fare qartë, pasi kur u bënim pyetje personazheve të përfshira për të na dhënë anën e tyre të historisë, për t'u mbrojtur në një farë mënyre, për të pasur fjalën e tyre në histori, vetëm sepse po i pyesnim na është thënë që, a e dini se do të paditeni, sepse gazetarët janë paditur. Thjesht siç e thashë, unë nuk kam shumë qejf të këmbëngul te kjo gjë, sepse është bërë tashmë pjesë e punës që s' duhet të ishte. Për t'iu përgjigjur në mënyrë direkte pyetjes suaj, po. Kur të kërcënojnë me padi, përpara se shkrimi të dalë, është një mënyrë për të të intimiduar dhe një mënyrë paraprake për censuruar informacionin.

Arben Pëllumbi – Pra, e gjithë ajo që ju e konsideroni presion, është fakti që, me sa duket, ju nuk e dini, se dikush në krahun tjetër, që mund të ndihet i cenuar nga ato që ju i quani “fakte”, ka të drejtën t'ju çojë në gjyq.

Aleksandra Bogdani – Thashë, kjo ka ndodhur përpara se të bëhej shkrimi. Sigurisht, gjithkush ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për probleme që mund të ketë ose për pretendime, por kjo gjë është bërë përpara se shkrimi të botohej.

Arben Pëllumbi – Pra, ju mendoni se në rast se dikush kërkon zbatimin e ligjit në interes të tij, ky quhet presion ndaj jush, për të mos publikuar faktet?

Aleksandra Bogdani – Unë mendoj se iu përgjigja pyetjes dhe këtu s'po jap më opinionë të tjera. Unë atë që mendoj e thashë. Pra, pati përpjekje për të censuruar, përpara se shkrimi të botohej dhe këtu s'ka asnjë të drejtë ligjore, sepse shkrimi nuk ishte botuar ende, kështu që...

Arben Pëllumbi – Meqenëse në këtë komision është aluduar se gazetarë të ndryshëm janë intimiduar, nuk kanë dashur të publikojnë, janë censuruar, në dijeninë tuaj dhe të rrjetit tuaj të gjerë investigativ, për hir të së vërtetës, a jeni në dijeni nëse ndonjë koleg juaji, i cili ka dashur të publikojë fakte, nuk është lejuar ta bëjë këtë gjë? Po ose jo.

Aleksandra Bogdani – Jo, nuk jam në dijeni.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Kaq kisha.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja Bogdani!

Në shkrimet tuaja ju keni zbërthyer skemën e bashkëpunimit të personave dhe të kompanive që ato krijojnë në vazhdimësi dhe unë dua një përshkrim të shkurtër jo në bazë të një shkrimi X apo Y, të mënyrës sesi ndodhi papritur metamorfoza e Albtech Energy nga një kompani që merrej me sahatet e ujit në Elbasan, u shndërrua në investitore nëpërmjet buxhetit të shtetit, jo me paratë veta, të veprave të tilla që përfshijnë inceneratorët, gjë e cila nuk ishte fare pjesë e aktivitetit të saj. Gjithmonë nëse e keni të mundur një gjë të tillë.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Rama – Kam bërë disa shkrime në lidhje me inceneratorët dhe kompanitë që kanë marrë përsipër ndërtimin e tyre. Një prej këtyre shkrimeve është objekt i një padie civile në gjykatë, ende nuk ka filluar si proces, është në fazën paraprake. Në lidhje me të njëjtën nevojë, mund të them diçka që në përgjithësi në llojin e gazetarisë që unë ushtroj, e cila ka të bëjë me hulumtimin, paditë, kryesisht ato civile që lidhen me dëmin e mundshëm të prezumuar që mund t'u shkaktohet kompanive, janë diçka normale, janë të natyrshme, madje në deontologjinë tonë të gazetarisë investigative ndonjëherë këto padi tregojnë deri diku shkallën e suksesit. Në përgjithësi kompanitë kërkojnë të rivendosin atë që ato e quajnë autoritet të humbur. Nuk është kjo padia e parë, unë kam pasur edhe padi të tjera civile, të cilat i kam fituar për shkak të punës që unë bëj dhe shkrimeve që kam bërë, mendoj se reputacioni është diçka që u takon si njerëzve, ashtu edhe kompanive, por është diçka që nuk fitohet në gjykatë, por duhet merituar.

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Ajazi, meqenëse e mori fjalën.

Besion Ajazi – Zonja kryetare, besoj se edhe nga përgjigjja e kolegut Rama, jemi të qartë se zoti Artani është në papajtueshmëri me statusin e dëshmitarit, e thotë edhe ligji neni 156, germa “ç”. Kështu që nuk është e udhës të vazhdojmë, në shkelje të Rregullores dhe të ligjit. Madje, zonja Kryetare, u bë e disata herë që unë, personalisht, por edhe kolegët e tjerë të maxhorancës jemi ndjerë se jeni duke drejtuar komisionin në një mënyrë joligjore, jo në bazë të Rregullores, dhe mos na detyroni që ta çojmë komisionin në atë hulli që nuk shkon, që të

kërkojmë edhe shkarkimin tuaj si kryetare e komisionit, sepse jeni në shkelje të Rregullores, në shkelje të ligjit dhe në shkelje të Kodit të Procedurës Penale.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Shalsi.

Zoti Shalsi, vetëm 30 sekonda, meqenëse m'u drejtua mua.

Zoti Ajazi, për sa kohë ne këtu jemi duke hetuar një aferë korruptive, që është shkelur ligji me të katërta këmbët dhe po flisni dhe po mbron kriminelë në kërkim, frikë nuk duhet të kem unë nga ligji, por duhet të kenë ata që mbrojnë korrupsionin dhe kriminelët.

Zoti Shalsi, fjala për ju.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ndoshta ka lindur një keqkuptim, them ndoshta. Unë gazetarin në fjalë e njoh prej vitesh, i vlerësoj përpjekjet e tij dhe, kur them prej vitesh, prej vitesh, ndoshta edhe kur nuk kemi rënë dakord në të kaluarën për pikëpamje të ndryshme, thashë që e çmoj aktivitetin e tij dhe besoj unë askush nga kjo ana këtej nuk e vë në dyshim dhe aq më pak doja të siguroja një nga kolegët deputetë që të mund çojmë nëpër mend të intimidojmë gazetarë. Duke thënë këtë, ndaj e konsideroj keqkuptim, ka një ligj, të cilit ne i referohemi, doja ta dëgjoja me shumë vëmendje, por kolegët e mi shtruan faktin e një konflikti civil. As zoti Pëllumbi, as zoti Ajazi dhe askush tjetër nuk vunë në dyshim faktin që të dëgjojmë, kemi dëgjuar dhe do t'i dëgjojmë. Thelbi është: a mund të pyetet si dëshmitar një individ i nderuar, i cili ndodhet në një konflikt civil, në rastin konkret një konflikt gjyqësor, për të cilin do të shprehet gjykata? Ky është thelbi i asaj që po themi dhe që duhet ta diskutojmë ndoshta edhe me shumë qetësi për të ndarë edhe pjesën e pushimit, për të parë mundësinë që, nëse ka papajtueshmëri me ligjin, siç po del edhe nga procedurat e kodit, edhe nga pika që iu referua kolegu, atëherë, jemi para këtij fakti: a mund të pyetet si dëshmitar një individ i nderuar, e theksoj, që ka një konflikt civil, pra ndodhet në një konflikt civil? Pastaj pjesa e asaj që ju thoni, jo korrupsioni po heton një rën apo tjetrën...

(Zoti Spaho flet pa mikrofon.)

Zoti Spaho, nuk kam ndërprerë asnjëherë njeri. Po e prezumoj atë që thoni ju sikur...

(Zoti Spaho flet pa mikrofon.)

Ne këtu mbështetemi mbi ligjin dhe mbi procedurat. A e thotë ligji që një person nuk mund të thërritet dëshmitar, nëse ka një konflikt civil?

Jorida Tabaku – Zoti Rama, që ta ndihmoj unë komisionin, a jeni marrë i pandehur nga organi i akuzës? A ju është komunikuar juve....

Artan Rama – Jo.

Jorida Tabaku – Ju është komunikuar ndonjë akuzë nga organi i akuzës?

Artan Rama – Jo.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Boçi, për procedurë.

Do të bëjmë 5 minuta pushim dhe do të diskutojmë me juristët.

Luçiano Boçi – Meqenëse zoti Ajazi i drejtoi pyetje zotit Rama, edhe unë kam një pyetje në lidhje me këtë akuzën që po hidhet si tymnajë këtu. Shkrimet tuaja i kam lexuar, zoti Rama, dhe ka shumë dokumente aty. Cilat mendoni se janë dokumentet...

Artan Rama – Nuk e kapa çfarë thatë, nuk, apo i keni lexuar?

Luçiano Boçi – I kemi.

I keni shoqëruar me publikimin e shumë dokumenteve. Cilat mendoni që janë dokumentet më sensitive, kontrata që ekziston midis Ministrisë së Energjisë dhe koncensionarit për shtyrjen e afatit 25-vjeçar, apo të tjerat? Cila ka qenë ajo kontratë që i dhemb?

Artan Rama – Në parim gjithçka, për të cilën unë vendos të bëj një shkrim, mendoj se është e rëndësishme, pastaj ju do të dëgjoni çfarë do të referoj mbështetur në fakte, ju mund ta gjykoni vetë; një gjykim, i cili mund të jetë ndryshe nga ai që unë mund të vlerësoj, por në përgjithësi gjithçka, që u përket shkrimeve të mia, mendoj se ka një interes të zgjeruar publik dhe ka një qëllim, i cili merret shumë kohë më parë se ju ta keni përfunduar shkrimin.

Jorida Tabaku – Pushim për anëtarët e komisionit dhe më pas do të diskutojmë pak me juristët dhe, zoti Rama, ju lutem, a mund të prisni jashtë dhe më pas do të rifillojmë mbledhjen?!

(Pas pushimit.)

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, do të rifillojmë mbledhjen!

I kërkoj stafit të komisionit që të thërresim zotin Artan Rama.

(Diskutime pa mikrofon.)

I kërkoj stafit të komisionit që të thërrasë deputetët për të filluar mbledhjen!

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë nuk kam nevojë për justifikim.

Zoti Pëllumbi, po ju pyes ju politikisht, si përfaqësuesi më i lartë, a do ta bojkotoni mbledhjen e komisionit, apo të vazhdojmë? Kaq është çështja! Uluni të vazhdojmë mbledhjen! Nuk jemi duke bërë shkelje ligjore.

(Diskutime pa mikrofon.)

Rendësi ka që të mos akuzohemi për korrupsion, sepse për kështu shkeljesh na çoni të gjithë në burg.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, meqenëse kemi një kuorum prezent për mbledhjen, dua që zoti Pëllumbi të jetë këtu, meqenëse kemi dakordësi që të jetë edhe zoti Pëllumbi!

Unë i mirëkuptoj qëndrimet politike që ka secila prej palëve tona, por, ju lutem, kemi rënë dakord që ky komision të vazhdojë punën. Keni vetëm 10 ditë kohë, tani, në qoftë se doni ta bllokoni, thoni që do ta bllokoni dhe ikim që të gjithë, por këtu ulur peng nuk na mbani dot.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk e kam filluar mbledhjen ende, sepse po ju pres ju. Nuk e kam filluar, pa pasur kuorumin.

Të nderuar kolegë, e fillojmë mbledhjen!

I kërkoj teknikës që të rifillojmë mbledhjen. Pas një pushimi të shkurtër, të dyja palët, sigurisht, u qëndrojnë mendimeve të tyre dhe bazës së tyre ligjore. Partia Demokratike insiston që ne do të vazhdojmë me pyetjen e dëshmitarëve. Bllokimi i këtij komisioni hetimor është i kotë. Askush nuk ka autoritetin dhe tagrin të dalë mbi vendimin e Kuvendit për të penguar punën e këtij komisioni. Zotëria, i cili është këtu prezent, është një gazetar, i cili pohoi se nuk është ngritur asnjë akuzë nga ana e institucionit të akuzës për të. Ashtu siç ka hedhur Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja padi për secilin prej nesh këtu, ka hedhur për të intimiduar edhe mediet. Unë këtë dua ta marr si një sinjal edhe për kolegët socialistë që ne nuk duhet të intimidohemi dhe duhet t'u dalim në krah medieve kurajoze.

Zoti Pëllumbi, kam 6 vjet që flas për këtë çështje dhe ju siguroj se ka pak media që flasin për këtë çështje. Ne duhet t'i mbështesim ato media. Dje e patë se çfarë buxheti marketingu kishte. Çfarë buxheti marketingu ka për medien? Unë kërkoj edhe një herë, bazuar mbi ligjin, bazuar mbi precedencën e krijuar në këtë parlament dhe në komisionet parlamentare për t'i dhënë fjalën kujtdo, që është i përfshirë sipas planit të hetimit, njëkohësisht edhe listës së dëshmitareve të miratuar së bashku propozoj që të vazhdoj me pyetjet për dëshmitarin.

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Pëllumbi, më pas zoti Spaho për procedurë.

Arben Pëllumbi – Zonja Kryetare, së pari, nuk duhet të bëni asnjë lloj insinuate që këtu dikush dëshiron t'i pengojë, t'i pezullojë punimet apo se ju doni t'i vazhdoni, kurse ne nuk duam të vazhdojmë. Nuk dua që askush të vazhdojë të bëjë insinuata, si pak më parë që të na etiketojë ne sikur mbrojmë atë apo këtë, sepse nuk dua të përdor termat që u përdorën këtu nga kolegët tanë të opozitës. Ajo që ne po themi, dhe nuk e gjetëm dakordësinë edhe gjatë seancës së pushimit, është që një dëshmitar, i cili ka një konflikt, nuk mund të jetë pjesë e dëshmisë në këtë komision. Unë nuk besoj se zotërinë e nderuar në fjalë e ka penguar kush deri më sot që ta thotë të gjitha mendimin e tij dhe ta shprehë publikisht atë mendim. Është lexuar nga ia që ka dashur të lexohet, vazhdon akoma të ketë mundësi që të publikojë dhe të bëjë, pra askush

atë nuk e intimidon në punën e tij. Ne këtu flasim vetëm për punën e këtij komisioni. Meqenëse ne nuk e gjetëm dakordësinë për faktin nëse duhet apo jo të dëshmojë zotëria, unë ju kërkoj që ta hidhni në votë nëse zotëria duhet të dëshmojë apo nuk duhet të dëshmojë.

Jorida Tabaku – Sipas rregullores së komisionit, dëshmia e çdo dëshmitari dhe përfshirja në listë e dëshmitarëve merret pa votë. Kemi rënë dakord për listën e dëshmitarëve, përfshirja në listë dhe çdo dëshmi merret pa votë. Në qoftë se ju doni të votoni kundër për diçka, sigurisht do të keni mundësi në fund për të votuar kundër edhe për raportin përfundimtar.

Zoti Spaho, fjala për ju.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Rama, që pranuat të vini në komision!

Si gazetar, ju keni kryer dy investigime në lidhje me inceneratorin e Elbasanit, një investigim për procedurat e ndjekura për hartimin e kontratës, dhënien e ofertës, shqyrtimin e saj, hartimin e kontratës deri në mbylljen dhe fillimin e punës për ndërtimin e inceneratorit dhe një të dytë që ka të bëjë me impiantin e prodhimit të energjisë elektrike dhe raportet e këtij impianti me pjesën tjetër të inceneratorit.

Unë dua t'ju pyes për të dyja çështjet, por le të mbarojmë me të parën për procedurën dhe më pas vazhdojmë me kontratën për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike. Në lidhje me procedurën, unë dua të dëgjoj nga ju që të më sqaroni në lidhje me emergjencën mjedisore në Elbasan. A ka pasur emergjencë mjedisore në Elbasan në periudhën kur është paraqitur oferta e pakërkuar? Nëse ka pasur emergjencë mjedisore, kush e ka shpallur?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju, nëse dëshironi të dëgjoni, dëgjoni, nëse nuk dëshironi, mund të ikni. Rrugën e keni të lirë. Nuk ka hedhje në votë për këtë çështje. Është marrë vendimi dhe do të vazhdojmë. Po të doni, dëgjoni; po të doni, ikni.

Faleminderit!

Mbi çfarë dokumentacioni është shpallur emergjenca mjedisore?

(Diskutime pa mikrofon.)

Më pas cilat janë efektet e emergjencës mjedisore në procedurën e mbylljes së kontratës? Pra, dua të di nëse nuk ka pasur emergjence mjedisore, si do të vazhdohej dhe, nëse ka pasur emergjence mjedisore, cila është rruga dhe procedura që ndiqet?

Dua të më sqaroni: nga investigimet që keni bërë ju, a ka dokumente të tilla për çështjen që unë flas? Këto dokumente a janë në përputhje me ligjin, mbi të cilin është organizuar aktiviteti i ndërtimit të inceneratorit në Elbasan? Më pas do të vazhdoj me çështjen e dytë.

Artan Rama – Jo, nuk ka pasur emergjencë mjedisore. Në vitin 2014... *(Diskutime pa mikrofon.)*

Jorida Tabaku – Ia kam dhënë fjalën zotit Rama, sapo të mbarojë zoti Spaho, do t'ia jap kolegut për procedurë.

Zoti Rama, fjala për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, nuk e jepni ju fjalën në këtë komision. Pas zotit Spaho do ta merrni fjalën për procedurë.

(Debat në sallë)

Edmond Spaho – ...një aferë ku janë vjedhur para shtetërore dhe janë pastruar para!

Arben Pëllumbi – ...nuk ka asnjë lloj problemi, le të thonë çfarë të duan.

Deputet – Kur nuk ka konflikt...

Deputet – Po pse të mos e lënë të flasë? Ç'konflikt ka, more?!

Jorida Tabaku – Ju lutem, se mund ta zgjidh unë!

Të nderuar kolegë, ju lutem më dëgjoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

(Debat në sallë)

Ju lutem!

Të nderuar kolegë, më lejoni, besoj e sqaroj këtë çështje, duke cituar dy dokumente zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë: “Zoti Arben Ristani, nënkryetar i Komisionit Parlamentar për hetimin e CEZ-it, i ka kërkuar Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Ilir Meta, në datën 09.12.2016, të përjashtojë”, pikërisht për të njëjtat arsye që ju thoni, “si dëshmitar zotin Taulant Balla”. Është këtu shkresa e drejtuar nga zoti Ristani.

Zoti Ilir Meta, asokohe, Kryetar i Kuvendit, pjesë e maxhorancës me Partinë Socialiste, pasi analizon të gjitha faktet dhe provat, po njëkohësisht edhe legjislacionin, thotë: “Në vlerësimin tim, të mbështetur edhe në vlerësimin e bërë nga Shërbimet e Kuvendit, ngritja, shqyrtimi dhe vendimmarrja në rastin e papajtueshmërisë së anëtarit të komisionit hetimor shterohen brenda komisionit hetimor përkatës dhe nuk gjykohet që ka konflikt interesi në rastin e kësaj pjesëmarrjeje”. Kjo është një shkresë zyrtare e Kuvendit nga ish-Kryetari i Kuvendit, bazuar mbi një kërkesë të bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për ta përjashtuar.

Besoj që këta precedentë ne i kemi ezauruar.

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Unë, të nderuar kolegë, ju lutem...

Edmond Spaho – Ky është një shembull që edhe specialistët e komisionit, që i kemi thirrur këtu për të na dhënë ndihmë të specializuar...

Jorida Tabaku – Të mos politizohen.

Edmond Spaho – ...të mbajnë qëndrime asnjëse dhe jo partiake.

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Ju lutem, ta përfundoj diskutimin, dhe pastaj do ta marrin fjalën kolegët.

(Deputetja Dhima ndërhyr pa mikrofon.)

Antoneta Dhima – ...askush nga ju.

Jorida Tabaku – Ju lutem!

Antoneta Dhima – Këtu jemi të gjithë për të zbatuar ligjin.

Jorida Tabaku – Zonjë, fjalën e jap unë!

Jam duke folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e jap unë në këtë komision.

Të nderuar kolegë, ne nuk duhet të kemi frikë nga fjala e gazetarëve. Duhet t'i mbrojmë gazetarët të flasin këtu. Le t'i lëmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është në konflikt interesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, problemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Këlliçi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Rama, ju lutem, mund të vazhdojmë me përgjigjen e pyetjeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho (off) – E more përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – ...i cili nuk është i drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një vendim jo i drejtë.

Të nderuar kolegë, ju lutem!

Zoti Pëllumbi, ju lutem, ju kam dëgjuar boll për procedurë!

Ju dhashë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka...

Zoti Pëllumbi, me gjithë respektin që kam për ju, një herë bëheni palë për të mbrojtur kriminelët në kërkim, një herë për kompanitë koncesionare...

Ju lutem, t'u japim fjalën gazetarëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zoti Rama, e keni fjalën ju.

(Debat në sallë)

Arben Pëllumbi (off) – Ne kemi një çështje ligjore për t'u zgjidhur. Nuk e zgjidhni dot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Belind Këlliçi – Jo.

(Diskutime në sallë)

Jorida Tabaku – Dëshmitari merret në dëshmi pa votim.

Arben Pëllumbi – E kemi marrë.

Jorida Tabaku – Dëshmitari nuk përjashtohet dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare, për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju kërkoj që t'ia japim fjalën zotit Artan Rama. Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e jap unë, pra, zoti Pëllumbi.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Kemi një kërkesë, pra, për papajtueshmërinë...

Jorida Tabaku – Antonela, ju nuk jeni sekretare personale e askujt...

(Kryetarja e komisionit i drejtohet pa mikrofon këshilltares së komisionit.)

...ju shkoni t'u flisni në vesh deputetëve.

Tani të flasim formalisht se jemi në komision.

Lefter Gështhenja – Mos është anëtare partie ajo.

Jorida Tabaku – Është duke dëshmuar zotëria... Tani, si suflerë të gjithë nga mbrapa...

Lefter Gështhenja – Mos është patronazhiste ajo. Mos është anëtare partie ndoshta.

Jorida Tabaku – Tani, mirë që e kemi kundër këtu gjysmën e qeverisë me radhë, e me gjykata me radhë, por edhe stafi i Kuvendit...

Ju lutem, secili të ruajë pozicionin e vet!

Na lejoni që zoti dëshmitar, zoti Artan Rama, të japë dëshminë e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëria nuk ka asnjë konflikt interesi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Rama, të lutem, vazhdoni.

Fadil Nasufi – A ka mundësi, për procedurë?

(Debat në sallë)

Besion Ajazi – ...këtu mbrapa, që nuk ka asnjë konflikt dhe do ta dëgjojmë me shumë kureshtje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Çfarë konflikti ka? Ndonjë kontratë biznesi me Mirel Mërtirin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, një sekondë! Ju lutem!

Ne kemi ministra në këtë komision që kanë dhënë leje koncesioni dhe nuk i përjashtoni, e më tregoni mua që paska konflikt interesi ai!

As i kam pyetur ndonjëherë anëtarët e këtij komisioni, hani dreka apo darka me Mirel Mërtirin? Keni konflikt interesi dhe merreni me gazetarët atje të cilët kanë folur prej gjashtë vjetësh për këtë çështje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare, nëse flasim për...

Antoneta Dhima – Nuk kemi ngrënë as dreka, as darka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – ...redaksi sa keni djegur ju, do të mbroni gazetarët tani.

Diskutimi nuk është fare për gazetarin, është diskutim për ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje...

(Deputeti Xhafaj flet pa mikrofon.)

Besion Ajazi – Ej, o Belind, gazetari...

Edmond Spaho – A e kuptoni...?

(Diskutime në sallë)

Jorida Tabaku – Zoti Rama, të lutem.

Edmond Spaho – A e kuptoni që ju është prishur karakteri?

A e kuptoni apo jo? Po vini karakteret tuaja në funksion të urdhrit të partisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...që ose ta prisni këtë seancë, ose nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa logjikë, pa argumente, në kundërshtim me të gjitha procedurat që janë ndjekur në Kuvend më përpara.

Mua do të më vinte turp po të veproja kështu...

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

...sepse jeni njerëz, jeni qytetarë me formim intelektual, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që po silleni në mënyrën më të papranueshme, vetëm e vetëm që t'i shërbeni Partisë që ai të mos flasë!

Antoneta Dhima – Nuk ka lidhje fare me partinë!

Edmond Spaho – Ju qofshi që keni frikë nga fjala e një gazetari për atë që e ka shkruar hapur, ka vënë kokën e tij në rrezik, është kërcënuar dhe ju i thoni: “Ke konflikt interesi!”, në një kohë kur asnjëri prej jush nuk e ka bërë atë. Përkundrazi, drejtues të rëndësishëm të maxhorancës, me Mirel Mërtirin, kanë ngrënë e kanë pirë, kanë udhëtuar në të njëjtën makinë! Dhe i thoni gazetarit që ka konflikt interesi.

Etjen Xhafaj – Dil e denoncoji të tëra!

(Debat në sallë)

Arben Pëllumbi – Zoti Spaho, askush këtu nuk ka asgjë me punën e nderuar të zotërisë. Ai zotëri nuk është penguar ta bëjë punën e tij, të cilën e ka bërë deri sot ashtu siç e ka gjykuar. I lumtë për punën që bën! Do të vazhdojë ta bëjë punën.

Ne po flasim vetëm për papajtueshmërinë e të qenit dëshmitar në këtë komision, nuk ka lidhje me detyrën e tij. Detyrën e tij është i lirë ta bëjë ai.

Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në papajtueshmëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po e prishni ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni 40 dëshmitarë. Për një dëshmitar doni të shkelni Rregulloren?

Ishim në padijeni kur është aprovuar lista. Le që zotëria nuk ka qenë fare në planin e hetimit kur e kemi aprovuar këtë të fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por është në papajtueshmëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në papajtueshmëri; nuk mund të dëshmojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e thjeshtë. Në qoftë se doni ta ndërpresim mbledhjen për një dëshmitar, e keni një kërkesë të cilën jeni të detyruar ta hidhni në votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam bërë një kërkesë në këtë komision për shpalljen në papajtueshmëri të dëshmitarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Përsëritja është mëmë e dijes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke lexuar? Do të vesh në SPAK? Çoje atje si dokument në SPAK, meqenëse je në SPAK edhe ti.

Belind Këlliçi – ... po, patjetër.

Madje e kam krenari që jam në SPAK me inceneratorin e Tiranës...

Antoneta Dhima – Çoje atje!

(Deputeti Këlliçi flet pa mikrofon.)

Ki durim!

Lefter Gështhenja – Zonja kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem!

(Debat në sallë)

Nuk flet. Ia kam dhënë 10 herë fjalën. Nuk flet, se ka zhurmë.

Lefter Gështhenja – Merreni fjalën.

Jorida Tabaku – Zoti Rama, ju lutem, zoti Spaho ju bëri disa pyetje.

Mund t'u përgjigjeni, ju lutem?

Artan Rama – E vetmja gjë që kam, është të përmbush arsyen pse jam thirrur dhe kam ardhur.

Dua që në momentin kur flas të dëgjohem. Kjo gjë nuk po ndodh, ndaj edhe kam një si ngurrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kaq kohë, personalisht...

Etjen Xhafaj – Është me vendim të ndërmjetëm... Dhe tani duhet respektuar ndonjë gjë në këtë histori, se po dalim komplet nga...

Dhe nuk ka nevojë fare për të bërtitur. Asnjëri nuk ka gjë personale me zotërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Dëgjojeni pra.

Etjen Xhafaj – Nuk ndryshon bota në qoftë se flet apo nuk flet këtu. Ne duhet të zbatojmë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë që është e shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, ne të ndarë e kemi mendjen!

(Debat në sallë)

Luçiano Boçi – Zoti Pëllumbi, ju bëni pagesa milionëshe sot për Klodian Zoton, sot që është në kërkim ai, dhe ndaloni gazetarin të japë një dëshmi, për një arsye që ju e gjykoni që është e rëndësishme?

Jpni miliona nga buxheti i shtetit...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është i shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe ju vazhdoni të jepni lekë, ndërkohë gazetarin nuk e lini të dëshmojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – Zbato Rregulloren dhe kaloje në votim pastaj.

Luçiano Boçi – Kaq, more!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Ku e ke në rregullore? Ma lexo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etjen Xhafaj – Neni 16 “Thirrja për të dëshmuar”: “Thirrja e dëshmitarëve...

Luçiano Boçi – Ja, ta lexoj unë...

Etjen Xhafaj – ... bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

Fadil Nasufi – Thirrja e dëshmitarëve bëhet me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 17, pika 2: “Thirrja e dëshmitarëve bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Etjen Xhafaj – Po pra, por ne nuk e dimë.

Lefter Gështhenja – Ne kemi marrë vendim për të thirrur ish-ministrin.

Ne interpretojmë ende...

Ky komision...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, keni një kërkesë nga ana ime për ta shpallur dëshmitarin në papajtueshmëri.

Edmond Spaho – E ke të gabuar.

Arben Pëllumbi – Po pra, kemi bërë një kërkesë për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, jeni duke shkelur...

Arben Pëllumbi – Këtë gjë e diskutuam.

Jorida Tabaku – ...ligjin.

Edmond Spaho – Ta lexoi zonja kryetare...

Arben Pëllumbi – Kemi bërë një kërkesë...

Edmond Spaho – ...interpretimin e Kuvendit në një rast të ngjashëm dhe Kuvendi, shërbimet juridike të tij, e kanë rrëzuar kërkesën e Arben Ristanit asokohe për përjashtimin e dëshmitarit.

Arben Pëllumbi – Po pra, është bërë një shkelje atëherë, të vazhdojë të bëhet edhe tani, thoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Nuk është bërë shkelje.

Arben Pëllumbi – Po si?

Edmond Spaho – Është interpretim juridik. Prandaj e thashë, ai interpretim juridik është shembull për më shumë seriozitet dhe profesionalizëm edhe nga stafi i Kuvendit që është vënë në dispozicion të këtij komisioni.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, meqenëse ju nuk po e merrni në konsideratë kërkesën time për shpalljen e papajtueshmërisë së dëshmitarit, unë e drejtoj kërkesën për të ndërprerë mbledhjen...

Edmond Spaho – Jo, nuk mund të interpretojmë sipas interesave të ngushta dhe partiake!

Arben Pëllumbi – ...deri në një moment tjetër.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, në shkelje të Rregullores dhe të ligjit, zoti Arben Pëllumbi më kërkoi të hedh në votim një kërkesë joligjore.

Lista e dëshmitarëve është miratuar, është rënë dakord, pra unë nuk hedh dot për votim një kërkesë joligjore. Ndërkohë, ai tani po kërkon që mbledhja të ndalojë dhe të mos vazhdojë.

Arben Pëllumbi – Të ndërpritet. Po, deri sa ta sqarojmë këtë çështje, unë nuk mendoj që mund të vazhdojmë.

Jorida Tabaku – Ne, fatkeqësisht, nuk i kemi votat në këtë komision. Ndërkohë, janë duke pritur katër dëshmitarë shumë të rëndësishëm për këtë komision, të cilët do të na japin informacion.

Unë kam vetëm një pyetje: pse ju djeg gjëja që do të thotë zoti Artan Rama?

Arben Pëllumbi – Shkelja e ligjit.

Jorida Tabaku – Çfarë problemi ka...?

Arben Pëllumbi – Shkelja e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Fjalën e ka kërkuar për procedurë zonja Denaj.

Arben Pëllumbi – Deri sa ne të jemi të qartë që nuk po e shkelim ligjin, unë kërkoj ndërprerjen e kësaj mbledhjeje, pra deri sa të jemi të qartë për këtë gjë.

Anila Denaj – Faleminderit, kryetare!

Në frymë të ligjit dhe të njohjes me dëshmitarët, në momentin kur vihemi përballë tyre, sikurse në rastin e mëparshëm, edhe në rastin konkret, me të gjithë respektin për ju dhe për çdo gazetar, ne nuk i njohim dëshmitarët më përpara, unë personalisht, por besoj edhe kolegët e tjerë dhe në momentin që hyjmë dhe shikojmë, vihemi në dijeni për informacione si në rastin e gazetarit të mëparshëm, ashtu edhe të gazetarit aktual dhe, për sa kohë ka një papajtueshmëri, në gjykimin tonë juridik, ky diskutim hidhet në votë.

Kjo nuk ka të bëjë me fjalën e lirë, në mënyrë absolute, sepse ne do të kemi edhe gazetar tjetër në dëgjuesë, dhe kjo nuk do të thotë që ne jemi kundër dëgjuesës së gazetarëve, por në frymë të ligjit për papajtueshmëri dhe për njohjen me këtë fakt tani, ne gjykojmë që ky komision i nderuar duhet ta marrë bazën juridike më të fortë sesa diskutimi që po bënit pak më parë me njëri-tjetrin.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Denaj, bazë juridike më të fortë sesa një vendim i Kryetarit të Kuvendit, unë nuk besoj që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një vendim i Kryetarit të Kuvendit për interpretimin e saj. Për precedencën në raste të ngjashme ju kam cituar tre raste të ngjashme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Jua kërkoj jo vetëm njerëzisht, por edhe politikisht, nëse jeni të interesuar të hedhim dritë në këtë aferë, siç thoni, të mos bëhemi mburojë politike e daljes së fakteve të rëndësishme.

Unë e kuptoj se çfarë po bëni me këtë dëshmitar dhe me dy të tjerët vijimësisht, në këtë komision disa dokumente të rëndësishme mungojnë.

Dëshmitarët që do të vijnë tani dhe më pas do t'i sigurojnë këtij komisioni dokumente tejet të rëndësishme që nuk i kanë sjellë institucionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe unë e kuptoj që ju doni ta pengoni këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj që doni ta pengoni këtë gjë, sepse kanë shkruar për atë gjë!

(Debat në sallë)

Kanë shkruar!

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, keni një kërkesë për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, më lini ta përfundoj logjikën!

Unë e kam thirrur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Boçi, një sekondë!

E kam thirrur zotërinë si dëshmitar, sepse ka shkruar për një leje koncesionare të dytë mbi inceneratorin e Elbasanit. Ia kam kërkuar Ministrisë së Mjedisit, nuk ma ka dhënë.

E kam thirrur dëshmitare zonjën Aleksandra Bogdani, sepse ka shkruar për një dosje hetimore të një aksidenti të zotit Arben Ahmetaj. Ia kam kërkuar ministrit të Drejtësisë, nuk e ka sjellë.

Unë, kur i kam kërkuar dëshmitarët, nuk i kam kërkuar vetë, kështu, nga dëshira, por kemi lexuar, kemi analizuar dosjet, prandaj i thërrasim këtu si dëshmitarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht. Tani, vjen këtu zëvendëskryetarja e komisionit dhe më thotë mua se çfarë do të thotë drejtoresha e ATRACO-s. Ajo e di se çfarë do të thotë kjo e fundit.

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

Po, sigurisht, se kanë shkruar shkrime.

Antoneta, lexo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se po përfundon!

Deputete – Joridë! Zonja Tabaku, “për ty”, jo “mi”. Të lutem!

Jorida Tabaku – Po pra, po, këto që kanë shkruar!

Arben Pëllumbi – Zonja Tabaku...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – ...publike. Ndaje, ndaje këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – ...zonja kryetare, ju nuk po e bëni mbylljen e mbledhjes.

Antoneta Dhima – Ato që kanë shkruar, janë publike. Ju po thoni që do të sillni prova të reja. Ku i keni?

Arben Pëllumbi – Antoneta!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Pëllumbi, pastaj ju.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, të lutem, unë ju bëra një kërkesë dhe ju jeni e detyruar të hidhni në votë kërkesën time. Nuk e morët në konsideratë kërkesën e parë për shpalljen e dëshmitarit në papajtueshmëri? Jeni e detyruar të merrni në konsideratë kërkesën time për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje ose ta hidhni menjëherë atë në votë. Kjo nuk diskutohet që është kështu.

Nuk kemi asgjë me dëshmitarin, por kemi të bëjmë me zbatimin e një procedure dhe mosshkeljen e ligjit. Deri sa ne të qartësohemi që jemi në mosshkelje të ligjit apo në shkelje të ligjit, unë kërkoj ndërprerjen e kësaj mbledhjeje.

Duhet ta hidhni në votë.

Jorida Tabaku – Fjalën e kanë kërkuar për procedurë zoti Boçi dhe pastaj zoti Nasufi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Atëherë, në të gjitha rastet kur ka diskutime për interpretimin e rregulloreve apo pasazheve të ligjeve, në komision vendos tradita parlamentare. Prevalon tradita parlamentare. Kështu zgjidhet, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...jo, mbi interpretimet thashë, interpretimet e ndryshme që bëhen qëndrojnë të dyja. Në raste të tilla merret në konsideratë një traditë...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Të lutem, ta them deri në fund.

Pra, merret në konsideratë tradita parlamentare dhe kësaj tradite, hap regjistrimet, jo pak më larg se në seancën e parafundit, i është referuar kryetari juaj i grupit tuaj parlamentar, sesi është zgjidhur çështja kur ka pasur diskutime ligjore. Edhe Mondit e di mirë, se ka pasur debat për këtë gjë, por s'dua ta referoj këtu çështjen, se nuk dua të zgjatem, nuk është e rëndësishme.

Tradita parlamentare e pasqyruar nga Kryetarja e Kuvendit, na thotë që ne duhet të vazhdojmë me dëgjuesën e dëshmitarit. Është shumë e thjeshtë. Ne kemi debatet tona juridike, dhe interpretimi juridik, s'po dalim mbi ligjin, se qëndrojnë të dyja vlerësimet, por prevalon tradita parlamentare. Është ajo që vendos. Sipas traditës parlamentare gazetari duhet të vazhdojë dëshminë e tij. Çfarë ka këtu për të diskutuar, për të vazhduar më gjatë? Marrim në konsideratë traditën parlamentare. Kur je i paqartë, vendos tradita, zoti Pëllumbi. Kur je i paqartë vendos tradita parlamentare dhe është e sanskionura, që ne do të vazhdojmë me dëgjuesën e dëshmitarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Unë po flas, më vjen keq. Nuk dua të hyj në pjesën e edukatës, se ne nuk ju ndërpresim kur flisni.

Është e saknionuar, vendos tradita parlamentare. I është referuar kryetari juaj i grupit parlamentar disa herë. Ne në komision kështu i zgjidhim çështjet dhe ju kështu i keni zgjidhur. Ne gjykojmë të ndjekim traditën parlamentare, e cila thekson sipas rasteve që solli zonja Tabaku të vazhdojmë me dëgjuesën e dëshmitarit

Jorida Tabaku – Zoti Boçi, ju lutem. Unë e kam të pamundur ta menaxhoj mbledhjen kështu.

Atëherë, do të bëjmë 5 minuta pushim, që ta riduskojmë edhe një herë. Zoti Nasufi e mbyll diskutimin për këtë çështje dhe pastaj do të diskutojmë si do të vazhdojmë me dëshmitarët.

Zoti Nasufi, ju lutem dhe pastaj 5 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, këtë mbledhje nuk e ndërpresim. Zoti Pëllumbi, kemi dëshmitarët që kanë ardhur. Jo unë mendova se ju kërkonit pushim që ta diskutojmë. Jo, ju lutem, mos u bëni pengesë për mbledhjet e komisionit hetimor.

Zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Në gjithë debatin që po bëjmë, po duket sikur ne jemi kundër dëshmitarit konkret apo kundër...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ore ti, nuk të foli njeri. Çudi e madhe.

Po prit, more zotëri, ke folur sa ke dashur me zë, me mikrofon, pa mikrofon, nuk të ka ndërhyrë njeri.

Këtu po flasim në bazën e një rregulloreje. Neni 4 ka parimet e veprimtarisë dhe në pikën 2 thotë: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij hetimorë, komisioni udhëhiqet nga parimet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, neni 4 i ligjit nr. 8891, datë 2. 05. 2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”. Pikërisht, këtë po kërkoj. Dhe në nenin 17, thirrja për të dëshmuar, në pikën 2 thuhet: “Thirrja e dëshmitarëve bëhet me vendim të ndërmjetëm”.

Ndërsa, për sa i përket praktikës së drejtimit të mbledhjes nga ana juaj, për rregull ka procedurë, një nga krahu i minorancës, një nga krahu i maxhornacë dhe drejtohet mbledhja me rregulla, jo të flasë kush ka zë më shumë, pasion dhe emocion më shumë. Ne do të ishim të kënaqur që e gjithë magjia e mbylljes së këtij procesi hetimi të ishte te zotëria, po nuk kemi gjë me zotërinë, e kemi me procedurën ligjore që do të bëjmë. S’kemi gjë as me gazetarët. Shumë

mirë që kanë pasur kurajën, kanë gërmuar dhe hedhin në vëmendjen e publikut probleme për të cilat ka ndjeshmëri publike. S'kemi lidhje me këtë, kemi lidhje me procedurën ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

I ke këtu të shkruara këtu

Edmond Spaho – Po shpikni praktika që nuk janë në asnjë vend të botës. Ne kemi të drejtë të pyesim këtu edhe të dënuar për këtë çështje, po qe se kanë dijeni për çështjen. Ne kemi të drejtë t'i thërresim dhe t'i dëgjojmë. Ju më thoni mua, se nuk duhet dëgjuar ai që ka shkruar për këtë! A jeni në terezi? Po thoni marrëzira, më falni që po ju drejtohem me të tilla terma.

Jorida Tabaku – Ju lutem, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Ne kemi të drejtë të pyesim edhe të dënuar për këtë çështje, në qoftë se ata kanë dijeni për çështjen.

(Debat pa mikrofon në sallë)

Jorida Tabaku – Ju lutem.

Zoti Këlliçi, jam duke folur unë. Unë edhe zoti Pëllumbi arritëm një dakordësi, që deri kur ta sqarojmë këtë çështje dhe t'i bindim palët se zoti Artan Rama mund të dëshmojë në komision, i kërkojmë zotit Rama të presë dhe dua të thërres dëshmitaren e radhës.

Dëshmitarja e radhës është zonja Aleskandra Bogdani.

U kërkoj ndjesë të gjithë dëshmitarëve, unë kam dëshirë që të gjithë specialistët e Partisë Demokratike, që janë në këtë komision bashkë me stafin e komisionit, të arrijmë një dakordësi për këta dëshmitarë. Zoti Rama, me shumë xhentilesë, priti, në fakt, ai ka qenë që në fillim të kësaj seanca, por që të mos pengojmë dëshminë, dua të vazhdojmë me dëshminë e radhës ndërkohë që sqarojmë këtë çështje.

Zonja Bogdani, dua t'ju lexoj rregulloren e brendshme të komisionit. Dëshmia juaj do të merret pas kryerjes së betimit dhe unë dua t'ju kujtoj që sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale, dëshmia e rreme në këtë komision dënohet me 2 deri në 6 vjet, Kodi i Procedurës Penale, neni 360 "Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit".

Ju lutem, përsërisni pas meje në fund: "Betohe se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë."

Aleksandra Bogdani – Betohe!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zonja Bogdani, ju lutem, bëni një prezantim për veten, kush jeni dhe çfarë keni shkruar për çështjen e inceneratorëve.

Aleksandra Bogdani – Unë jam Aleskandra Bogdani. Jam gazetare e rrjetit Ballkanik të gazetarisë investigative me qendër në Tiranë.

Në fakt, për inceneratorët ne kemi filluar të hulumtojmë dhe të shkruajmë që në vitin 2017, në rastin e Fierit, që kur pati protesta. Sigurisht, për shkak të interesit të lartë publik mbi këtë çështje, kemi vazhduar të hulumtojmë edhe në vazhdim, edhe me shkrime në kohët e fundit. Ato sigurisht vazhdojnë edhe aktualisht, por mendoj se shkrimet objekt për të cilat më keni ftuar, kanë qenë në shtator të vitit 2020, të cilat janë publikuar në portalin tonë.

Jorida Tabaku – Zonja Bogdani, i njihni ju shtetasit Klodian Zoti, Mirel Mërtiri dhe Stela Gugallja? A kanë komunikuar ndonjëherë me ju gjatë kohës kur keni shkruar për këtë temë?

Aleksandra Bogdani – Jo.

Jorida Tabaku – A kanë komunikuar me përfaqësues të medias suaj për shkrimet që ju keni publikuar për temën e inceneratorëve?

Aleksandra Bogdani – Jo. Ne mbasi kemi mbledhur të gjitha faktet e duhura për shkrimin, u kemi dërguar pyetje zotërinjve në fjalë, por nuk kemi marrë përgjigje.

Jorida Tabaku – Unë dua t'ju falënderoj, se investigimet që ju dhe rrjeti juaj keni bërë, jo vetëm për temën e inceneratorëve, kanë qenë shumë të plota dhe ne u jemi referuar herë pas here edhe në Kuvend. Ato kanë qenë profesionale, ashtu si edhe ato të zotit Rama, që ne shpresojmë ta dëgjojmë deri në fund të këtij komisioni. Unë kam dëshirë të na jepni disa informacione për shkrimin e parë që ju keni bërë për këtë temë dhe si filluat të denonconi këtë aferë korruptive.

Aleksandra Bogdani – Në fakt, shkrimi është publik dhe unë nuk jam dëshmitare, jam gazetare, që mbledh fakte, mbledh dokumente. Përmes ligjit për të drejtën e informimit janë mbledhur shumica e dokumenteve për këtë shkrim. Unë intervistoj njerëz, pra çfarë dua të shpjegoj këtu është se nuk mund të të dëshmoj në lidhje me atë që dëshmitarët e tjerë më kanë thënë mua. E gjithë puna ime është për të informuar publikun dhe në këtë rast shkrimet janë publike, janë në faqen tonë të internetit, janë bërë pjesë e debatit publik, për një kohë shumë të gjatë, kështu që ndoshta nuk është nevoja të riprodhoj shkrimet që unë kam raportuar.

Jorida Tabaku – Në mënyrë specifike, unë i kam lexuar dhe disa prej tyre i kam këtu. Kam lexuar edhe njërin prej shkrimeve që është bërë objekt debati në interpelancën që kam pasur me zotin Damian Gjijnuri, ku është përfshirë në debat edhe zoti Arben Ahmetaj. Ju keni shkruar në lidhje me një aksident të ndodhur në autostradën Tabanicë - Kumanovë, rruga që lidh Serbinë me Maqedoninë e Veriut, dhe keni marrë një dosje hetimore ose informacione nga gjykata, të cilat ne ia kemi kërkuar edhe zyrtarisht edhe Ministrisë të Drejtësisë, që t'ia sjellë këtij komisioni, por deri më sot nuk i ka sjellë. Njëkohësisht, ju keni investiguar për lidhjen e dy personave me zotin Arben Ahmetaj.

Mund të na informoni se si e keni marrë këtë dosje hetimore?

Aleksandra Bogdani – Ne nuk kemi pasur dosjen hetimore. Ne kemi pasur vendim e gjykatës së Kumanovës, i cili, mesa mbaj mend, është i shtatorit të vitit 2017, pra i periudhës mbas një muaji e ca, pasi kishte ndodhur aksidenti në Maqedoni. Vendimi është marrë përmes ligjit për të drejtën e informimit. Pra, kolegët tanë në Maqedoni kanë bërë një kërkesë për të drejtë informimi dhe e marrë kanë këtë vendim nga gjykata e Kumanovës në rrugë zyrtare.

Jorida Tabaku – Po, vendimi i gjykatës së Kumanovës është i datës 13.07.2020 dhe në vendimin e gjykatës janë me iniciale emrat e të gjithë personave të përfshirë. Si arritët të zbuloni që ishin zotërinjtë, të cilët ju përmendi në shkrim?

Aleksandra Bogdani – Aksidenti ka qenë publik. Ka pasur raportime në media në lidhje me këtë gjë. Emri i Mirel Mërtirit nuk është i anonimizuar në atë vendim, sepse është kërkuar në lidhje me këtë person, por edhe nga kryqëzimi i fakteve, se është një punë rëndom që ne gazetarët bëjmë, pra, kryqëzimi i fakteve që kishin dalë më përpara, që ishin publikuar nga aksidenti, me vendimin e gjykatës, sigurisht që të çojnë te këta emra.

Jorida Tabaku – Edhe pas shkrimit tuaj, edhe në debatin publik që unë kam pasur me zotin Ahmetaj, ai e ka pranuar që ka qenë pjesë e këtij aksidenti, megjithëse këtu është me iniciale dhe janë një sërë njerëzish që janë me iniciale, përveç zotit Mirel Mërtiti, ashtu siç e cituat edhe ju, sepse për të bëhej kërkesa.

Unë do ia kaloj fjalën zotit Këlliçi, për dy pyetje, pastaj edhe zotit Pëllumbi.

Belind Këlliçi – Pikë së pari dua t’ju falënderoj ju, personalisht, edhe rrjetin investigativ BIRN, për punën e jashtëzakonshme që keni bërë në dhënien e një shembulli për të gjitha mediat e vendit, por edhe për të gjithë gazetarët investigativë, që duhet ta vrasin frikën dhe të mos bien pre, qoftë e shantazheve, qoftë e pagesave të kompanive të inceneratorëve, për reklama nëpër portale apo media të ndryshme.

Për të fat të keq, ne e kemi thënë dhe rithënë disa herë, kjo aferë nuk është vetëm ekonomike, por është një aferë që tërësisht është lidhur me censurën mediatike që i është bërë kësaj vjedhjeje skandaloze të taksave të qytetarëve shqiptarë.

Zonja Bogdani, unë dua të di nga ju, nëse ka diçka që ju doni ta thoni në këtë komision në lidhje me të gjitha hulumtimet që ju keni bërë, në lidhje me të gjithë shkrimet që ju keni bërë, ndonjë fakt që ju do të doni ta risillni në vëmendje, apo ta sillni në vëmendje në këto momente, që ende nuk mund ta keni bërë publik apo ndonjë dokument që e keni si risi. Unë i kam lexuar, besoj të gjithë në këtë komision i kanë lexuar, të gjitha shkrimet tuaja me shumë vëmendje, por dua të di nëse keni ndonjë qoftë informacion të ri apo ndonjë risi në lidhje me të të 3 inceneratorët, se ju nuk keni shkruar vetëm për Fierin, kam përshtypjen, keni shkrua për të 3 inceneratorët, nëse mund të na jepni diçka shtesë.

Faleminderit!

Aleksandra Bogdani – Në fakt, ta sqaroj edhe një herë punën tonë. Ne punojmë që të informojmë publikun dhe gjithçka që kam pasur në lidhje me këtë çështje është tashmë publike. Dokumentet që kanë shërbyer për të ndërtuar shkrimet tona janë të bashkangjitur me shkrimet në portalin tonë, mund t'i aksesojë kushdo aty. Shumica e dokumenteve janë marrë nga institucione zyrtare, po themi, raporte të Kontrollit të Lartë të shtetit, ekstrakte të QKB-së, hetime të mëparshme të prokurorisë lidhur me 3 kompanitë koncesionare, si dhe personat që lidhen me këto kompani koncesionare. Kështu që, unë gjithçka që kam pasur e kam mbledhur për të informuar publikun dhe siç e thashë, çdo gjë është publike. Kështu që, unë nuk kam ndonjë dokument shtesë ose informacion shtesë për ta ndarë me ju në këtë rast.

Jorida Tabaku - Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Bogdani, në veprimtarinë tuaj të gjatë publicistike në përgjithësi, por dhe në veçanti për këtë çështje, për të cilën jeni thirrur të dëshmoni sot këtu përpara këtij komisioni, keni pasur presion apo ndonjë ekran, apo fletë gazete, të cilat nuk ju janë vënë në dispozicion, për të nxjerrë ato dokumentet apo faktet, siç i mendoni ju, për t'ia bërë të qarta dhe të njohura publikut?

Aleksandra Bogdani – Neve gazetarëve, përgjithësisht, nuk na pëlqen të flasim për veten ose të bëhemi vetë lajmi. Kështu që në këtë rast, ka pasur goxha interesa që shkrimi të mos dilte, ka pasur një farë presioni, në lidhje me këtë gjë, edhe nga palët, të cilat i kemi kontaktuar për të marrë qëndrimin e tyre. Pra, ne donim që secili të kishte një zë në shkrimet tona. Ka pasur një padi për Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative, mbasi shkrimi u botua. Megjithatë, kjo është puna jonë, të hulumtojmë, ndonjëherë të këmbëngulim, të përdorim legjislacionin në fuqi, për të siguruar dokumente. Nuk ka qenë e thjeshtë, për hir të së vërtetës, për t'i siguruar këto dokumente dhe shumë herë jemi detyruar të bëjmë ankesa te Komisioneri për të Drejtën e Informimit për vendime, që duhet të ishin dokumente publike, të cilat duhet të na viheshin në dispozicion vetëm me një kërkesë në mënyrë të thjeshtë. Ka qenë një punë e gjatë hulumtuese në këtë rast dhe janë përdorur të gjitha atotribute që ne na jep ligji për t'i aksesuar këto dokumente, por jo me lehtësi.

Arben Pëllumbi – Ju falënderoj!

Unë nuk vura në diskutim as impenjimin tuaj dhe as lodhjen që ju bëni, se nuk jeni thirrur për këtë, as ju dhe as rrjeti juaj. Ajo që unë ju pyeta është nëse ju, personalisht, në ushtrimin e detyrës suaj të gazetarit për të informuar me vërtetësi publikun, keni pasur presione të drejtpërdrejta për të mos i publikuar këto fakte? Jo, vështirësinë që mund të ndeshni për të marrë këto informacione dhe nuk po ju kërkoj se cilat janë burimet tuaj të informacionit, se edhe

mund ta bëja edhe këtë pyetje. Pra, dua të di: a keni pasur ju, personalisht apo rrjeti juaj pengesa për të publikuar faktet?

Aleksandra Bogdani – E përmenda edhe më parë, në momentin kur ne u kemi dërguar pyetje ose kemi tentuar të intervistojmë dhe palën tjetër, na është thënë që do të paditeni dhe ne e dinim shumë mirë këtë gjë. Ne si gazetarë dhe media ku punojmë e dinim, se na është thënë fare qartë, pasi kur u bënim pyetje personazheve të përfshira për të na dhënë anën e tyre të historisë, për t’u mbrojtur në një farë mënyre, për të pasur fjalën e tyre në histori, vetëm sepse po i pyesnim na është thënë që, a e dini se do të paditeni, sepse gazetarët janë paditur. Thjesht siç e thashë, unë nuk kam shumë qejf të këmbëngul te kjo gjë, sepse është bërë tashmë pjesë e punës që s’duhet të ishte. Për t’iu përgjigjur në mënyrë direkte pyetjes suaj, po. Kur të kërcënojnë me padi, përpara se shkrimi të dalë, është një mënyrë për të të intimiduar dhe një mënyrë paraprake për censuruar informacionin.

Arben Pëllumbi – Pra, e gjithë ajo që ju e konsideroni presion, është fakti që, me sa duket, ju nuk e dini, se dikush në krahun tjetër, që mund të ndihet i cenuar nga ato që ju i quani “fakte”, ka të drejtën t’ju çojë në gjyq.

Aleksandra Bogdani – Thashë, kjo ka ndodhur përpara se të bëhej shkrimi. Sigurisht, gjithkush ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për probleme që mund të ketë ose për pretendime, por kjo gjë është bërë përpara se shkrimi të botohej.

Arben Pëllumbi – Pra, ju mendoni se në rast se dikush kërkon zbatimin e ligjit në interes të tij, ky quhet presion ndaj jush, për të mos publikuar faktet?

Aleksandra Bogdani – Unë mendoj se iu përgjigja pyetjes dhe këtu s’po jap më opinionë të tjera. Unë atë që mendoj e thashë. Pra, pati përpjekje për të censuruar, përpara se shkrimi të botohej dhe këtu s’ka asnjë të drejtë ligjore, sepse shkrimi nuk ishte botuar ende, kështu që...

Arben Pëllumbi – Meqenëse në këtë komision është aluduar se gazetarë të ndryshëm janë intimiduar, nuk kanë dashur të publikojnë, janë censuruar, në dijeninë tuaj dhe të rrjetit tuaj të gjerë investigativ, për hir të së vërtetës, a jeni në dijeni nëse ndonjë koleg juaji, i cili ka dashur të publikojë fakte, nuk është lejuar ta bëjë këtë gjë? Po ose jo.

Aleksandra Bogdani – Jo, nuk jam në dijeni.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Kaq kisha.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja Bogdani!

Në shkrimet tuaja ju keni zbërthyer skemën e bashkëpunimit të personave dhe të kompanive që ato krijojnë në vazhdimësi dhe unë dua një përkthim të shkurtër jo në bazë të një shkrimi X apo Y, të mënyrës sesi ndodhi papritur metamorfoza e Albtech Energy nga një

kompani që merrej me sahatet e ujit në Elbasan, u shndërrua në investitore nëpërmjet buxhetit të shtetit, jo me paratë veta, të veprave të tilla që përfshijnë inceneratorët, gjë e cila nuk ishte fare pjesë e aktivitetit të saj. Gjithmonë nëse e keni të mundur një gjë të tillë

Aleksandra Bogdani – Nga të dhënat që mblodhëm, dokumentet dhe nga hetimet e mëparshme të prokurorive për kompanitë, të cilat më pas u përfshinë në historinë e insineratorëve, ajo që mund të konsiderohet mënyra si u operua ishte shumë e thjeshtë. Në qendër, të paktën nga të dhënat e mia, ka qenë kompania “Integrated Technology Services” dhe prej saj janë hapur kompani të tjera, të cilat ose janë përfshirë në negociata për të marrë kontrata koncesionare, ose kanë bërë ofertë të pakërkuar, si në rastin e Fierit dhe më gjerë. Pak a shumë kjo është.

Është një kompani ku të tre personazhet, të cilët më pas janë përfshirë në kontratat koncesionare, zoti Klodian Zoto, zoti Mirel Mërtiri dhe zonja Stela Gugallja, kanë pasur poste të ndryshme në kompaninë “Integrated Technology Services” dhe prej aty kanë aksesuar më pas kontratat koncesionare. Ajo që dihet dhe përmes dokumenteve, që besoj ju keni mundësi t’i mblidhni në institucione të tjera, del qartë që këto kompani nuk kanë pasur eksperiencë të mëparshme në menaxhimin e mbetjeve urbane.

Luçiano Boçi – Kam edhe një pyetje tjetër për mënyrën dhe shpejtësinë që u krijuan këto kompani. Për shembull, në rastin e Elbasanit më rezulton që, pasi bëhet kërkesa nga bashkia për një projekt teknik, merret miratimi nga ministria dhe një ditë më pas krijohet “Albtech Energy”. Kjo skemë e krijimit të kompanive, pasi parashikohen këto vendime, ka ndodhur vetëm në Elbasan apo kështu ka ndodhur edhe në Fier? Ju jeni marrë me rastin e Fierit dhe krijimin brenda ditës apo ditës së nesërme të kompanive të tilla.

Aleksandra Bogdani – Unë nuk e mbaj mend fiks kur është krijuar kompania në Fier, por me sa mbaj mend nga dokumentet që kam parë, oferta e pakërkuar është bërë nga një kompani tjetër dhe jo nga kompanitë fituese të koncesionit. Ato kanë pasur një studim fizibiliteti, i cili është përdorur më pas nga kompanitë që fituan koncesionin. Për ne si gazetarë këto procedura ngrenë sinjale për të parë më shumë, për të gërmuar se si ka mundësi që ka ndodhur në një kohë kaq të shpejtë ose praktikisht për të parë atë që do të duhet të ishte ana ligjore. Prokurimet për punët publike u jepen kompanive, të cilat kanë eksperiencë, plotësojnë kriteret dhe standardet e caktuara dhe në këtë rast kjo ka qenë shtysa jonë për të hulumtuar më tej në këtë histori, sepse, në fakt, kompanitë janë themeluar shumë afër hapjes së ofertave. Në rastin e Elbasanit nuk pati as hapje ofertash, me sa kam lexuar, ndërsa në rastin e Fierit, siç e thashë, oferta është bërë nga një kompani tjetër dhe pastaj koncesioni është fituar nga bashkimi i dy kompanive të tjera.

Luçiano Boçi – Nga hulumtimi juaj, koncesioni i dhënë i Elbasanit me negociim pa shpallje, si model në raport me atë çka parashikon ligji “Për koncesionet”, ju duket gjetje e duhur dhe a e keni hasur në investigime të tjera këtë mënyrë të dhënies së koncesionit apo është hera e parë dhe e fundit që është dhënë në Shqipëri një koncesion i tillë?

Aleksandra Bogdani – Me këtë pyetje duket sikur unë ftohem për të dhënë opinionet e mia, gjë që unë nuk do të doja ta bëja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të doja të përfshihesha në këtë.

Për sa i përket Elbasanit, procedura ka qenë me negociim dhe pa shpallje paraprake dhe, me aq sa unë e kam lexuar të zezë në të bardhë në ligj, sepse nuk jam juriste, nuk ishte një procedurë e parashikuar për koncesionin ose kontratat në fjalë.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj - E nderuar, shumë faleminderit për prezencën dhe komentet!

Unë pyeta pak më parë nëse ne e kemi pjesë të dosjes tonë të gjithë informacionin për vendimin e gjykatës të një shteti fqinj, që ju sapo thatë në fillim të fjalës suaj, dhe na rezulton që nuk e kemi. Kjo do të thotë se dokumenti që zonja kryetare na tregoi nuk është në dijeninë e të gjithë anëtarëve. Për sa kohë dëshmia juaj nuk do të mbështetet në prezencën fizike si dëshmitare okulare, që nuk ke qenë, atëherë do të duhet që neve të na vihet në dispozicion mënyra e marrjes së këtij informacioni dhe vetë dokumenti, sepse duhet që të gjithë ne të jemi në të njëjtën frymë të njohjes me dokumentin, të leximit të inicialeve dhe të kuptueshmërisë së dokumentit që ju bëtë fjalë në dëshmi, përtej faktit që është tjetër çështje gjykimi se si kjo ka lidhje me objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor me titullin e saj, që ka të bëjë me procedurat.

Faleminderit!

Aleksandra Bogdani – Kjo hyn te pjesa jonë etike e gazetarisë. Ne dokumentet i mbledhim për një qëllim shumë specifik, që është bërja me dije publikut, dhe ne e transmetojmë atë pikërisht për të informuar publikun. Për shkak të profesionit dhe kriterëve etike, unë nuk mund të dorëzoj dokumente këtu, por rruga e aksesimit është e qartë. Vendimi ndodhet në Gjykatën Themelore të Kumanovës, dhe ne e kemi marrë me kërkesë për të drejtën e informimit. Gjithashtu, vendimi ndodhet i bashkangjitur shkrimit në faqen tonë, kështu që mund ta aksesoni edhe aty besoj.

Anila Denaj – Dakord, por ne nuk jemi vendosur përpara të njëjtit dokument. Siç po e shikojmë të gjithë, ne nuk e kemi këtë dokument në dosje (pak më parë pyeta), që të kemi mundësinë të gjykojmë nëse ky dokument do të duhet të analizohet më tej apo do të duhet të

vlerësohet nëse inicialet janë apo jo. Nuk po hyj në përmbajtje, por po ngelem te forma. Për sa kohë ishte pjesë e dëshmisë, përtej të gjitha pyetjeve të tjera, mendoj që vlen edhe kjo kërkesë, përtej faktit që përsëri ngelet çështja nëse ky fakt është pjesë e një diskutimi për komisionin hetimor me këtë titull që ne thamë. Gjithë të tjerat janë çështje të hapura.

Jorida Tabaku – Për procedurë, mënyra se si ne procedojmë këtu nuk i takon zonjës Bogdani. Unë e thirra zonjën Bogdani pikërisht për këtë shkrim, të cilin e kam aksesuar nga shkrimi i tyre. Shkrimi ka qenë në maqedonisht, e kam përkthyer dhe e kam në një dokument Word. I kam kërkuar ministrit të Drejtësisë që të njëjtin dokument të na depozitojë me një shkresë zyrtare, por nuk e ka depozituar. Unë kam kërkuar dosjen e plotë të gjykatës (këtu është vetëm vendimi), kam marrë në internet shkrimin e zonjës (është dokument publik) dhe këtu pyeta si kemi ardhur në emrat e këtyre dy dëshmitarëve. Ky fakt është pranuar në interpelancën që unë kam pasur në Kuvend për këtë çështje edhe nga zoti Ahmetaj. Pastaj, administrohet apo jo si provë, kjo është gjë tjetër, sepse këtu po diskutojmë faktet publike.

Helidon Bushati – Ju jeni gazetare investigative, mbulon fusha të caktuara, keni bërë artikuj jo vetëm për këtë koncesion, por edhe për koncesionet e shëndetësisë, që janë shumë problematike. Pse jeni marrë pikërisht me këto tri koncesione të insineratorëve dhe jo me koncesionin e Ashtës, koncesionin e Moglicës apo atë Bënjës?

Aleksandra Bogdani – Kjo është shumë e thjeshtë. Puna jonë është të shikojmë ku shkojnë paratë e taksapaguesve. Këto janë koncesione me mbështetje buxhetore, prandaj ka një interes më të shtuar për ne si gazetarë për të hulumtuar në këto raste, duke iu përgjigjur interesit publik që në këtë rast janë paratë e taksapaguesve.

Helidon Bushati – Gazetarët investigativë kanë një precedent, sepse kanë bërë një President të Amerikës të japë dorëheqjen, rast unik, dhe, gjithashtu, janë numri më i madh i gazetarëve që marrin çmime “Pulitzer”. Si gazetare me eksperiencë në fushën investigative, a mund të më thoni, përveç mungesës së eksperiencës dhe mungesës së njoftimit të shpalljes së kontratës për insineratorin e Elbasanit, çfarë problematikash të tjera thelbësore shikoni ju te këto koncesione?

Aleksandra Bogdani - Unë nuk jam marrë në thellësi me kontratën e Elbasanit dhe me pjesën e procedurave, sepse nuk jam eksperte në atë fushë, ndaj nuk di sa mund ta ndihmoj komisionin në këtë pjesë. Kështu që, besoj se keni mjaftueshëm dokumente të procedurave dhe i keni aksesuar ato këtu për të krijuar një ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështhenja – Faleminderit, kolegë!

Duke ju falënderuar për punën fantastike që keni bërë si media, më duhet t’ju bëj një pyetje, meqenëse ne si komision akoma nuk e kemi këtë informacion. A keni dijeni për shtyrjen

e afatit të kontratës koncesionare të Elbasanit me 25 vjet, dhe nëse po, mund ta kemi në dispozicion dokumentin, sepse ne nuk e kemi?

Faleminderit!

Aleksandra Bogdani – Unë di që kontrata e Elbasanit duhet të kishte përfunduar dhe insineratori duhet t’i kishte kaluar bashkisë së Elbasanit. Nuk e di që kontrata është zgjatur me 25 vjet.

Jorida Tabaku – Po, zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Faleminderit, kryetare!

Zonja Bogdani, duke ju falenderuar për prezencën, shpjegimet dhe përpjekjet aspak të lehta në gazetarinë investigative, që nuk është aspak një profesion i lehtë në Shqipëri, kam një pyetje për kostot e këtyre insineratorëve. Në fakt, kam kërkuar informacion edhe nga institucionet qeveritare. Në dijeninë tuaj, kostot e impianteve si janë krahasuar me impiante të ngjashme në vende të tjera të Europës apo botës?

Aleksandra Bogdani – Unë jam gazetare që punoj në Shqipëri dhe nuk kam hulumtuar insineratorë të tjerë në vende të tjera, ndaj nuk e kam fare idenë e kostove të tyre. Për kostot e insineratorëve në vendin tonë mund të aksesoni një raport të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili bën një vlerësim të kostove të këtyre insineratorëve. Përfshirë koston e operimit, sipas këtij raporti, ata vlerësojnë që këto tri vepra mund t’u kushtojnë taksapaguesve rreth 430 milionë euro në 30 vjet, përfshirë edhe shpronësimet e tokës. Ky është vlerësimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, më tej nuk di të them.

Eduard Shalsi – Pra, nuk jeni në dijeni të ndonjë investigimi apo analize në lidhje me koston e investimit, jo koston operacionale?

Aleksandra Bogdani – Më fal, se nuk e kuptova pyetjen!

Eduard Shalsi – Për koston e impiantit e kam fjalën.

Aleksandra Bogdani - Kostoja e impiantit është në kontratë dhe me sa unë di investimi ka qenë i parashikuar në vlerën 128 milionë euro, të paktën për Tiranën.

Eduard Shalsi – Impianti i Elbasanit, në mos gaboj, ishte 21 milionë euro pa TVSH, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

21,6.

Pyetja ishte nëse ka ndonjë investigim sa kushton në vende të tjera një impiant i ngjashëm?

Aleksandra Bogdani – Nuk kam dijeni për një gjë të tillë.

Denis Deliu – Faleminderit, kryetare!

E nderuar gazetare!

Cilat ishin indiciet që ju çuan ju në marrjen e këtyre informacioneve? Në fushën time, unë jam ish-ushtarak, që një informacion të merret në konsideratë, duhet të merret nga të paktën tri burime të pavarura nga njëri-tjetri. A i keni marrë ju informacionet nga tre burime dhe pastaj i keni nxjerrë në media?

Faleminderit!

Aleksandra Bogdani – Indiciet janë ato që thashë dhe këto i vlerëson çdo redaksi normale, e vogël apo e madhe. Ajo shikon interesin publik pas vendimmarrjeve të caktuara politike dhe institucionale dhe në këtë rast interesi ishin paratë e taksapaguesve shqiptarë, si po shpenzohen dhe si janë zbatuar procedurat. Kjo është a-ja në gazetari.

Sa për burimet, në qoftë se e lexoni shkrimin, ka shumë më tepër se tre burime. Këtë përgjigje mund të jap në këtë rast.

Jorida Tabaku – Nëse nuk ka pyetje të tjera, unë dua ta falenderoj zonjën Bogdani për prezencën! Gjithashtu, dua t'u kujtoj kolegëve socialistë që zonja Bogdani deklaroi në këtë komision që rrjeti ku ajo punon është paditur nga Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja dhe ju nuk patët asnjë reagim. Reagimi që patët me zotin Artan Rama ose në raste të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E tha zonja në fillim të dëshmisë së saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo. Rrjeti ku unë punoj, tha, është paditur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

U kujtoj kolegëve socialistë trajtimin me dy standarde.

Faleminderit, zonja Bogdani për punën, angazhimin dhe guximin që keni pasur për të shkruar për këtë dhe për tema të tjera!

Faleminderit!

(Mungesë incizimi)

Kanë ardhur dëshmi shumë të rëndësishme të zotit Pëllumb Abeshi, Etleva Kondi, Lediana Karalliu, Bardhyl Çabiri dhe Serafin Papa, që është komisioni i koncesionit të insineratorit të Elbasanit. Dua të ftojme zotin Pëllumb Abeshi për ta dëgjuar në këtë komision.

Eduard Shalsi – Më fal, për procedurë!

U vura në dijeni që anëtarët e komisionit, Pëllumb Abeshi, Etleva Kondi, Bardhyl Çabiri, Serafin Papa dhe zonja Lediana Karalliu janë thirrur mbi një herë dhe janë marrë të pandehur në SPAK. Gjykoj që kjo e bën të papajtueshme thirrjen e tyre si dëshmitarë. Ky është

një fakt që e kanë nxjerrë edhe disa media. Të jenë të pandehur dhe njëkohësisht të thirren në komision ka një papajtueshmëri.

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, unë nuk kisha dijeni për këtë temë, por ma tha zoti Pëllumbi pak më përpara.

Kemi dy elemente shumë të rëndësishme.

E para, duhet që zotërinjtë të vijnë këtu e të na thonë që janë apo jo në hetim dhe për cilën çështje janë në hetim, sepse zotërinjtë nuk i kam thirrur vetëm për çështjen e insineratorit të Elbasanit. Një nga zotërinjtë është në komisionin e insineratorit të Tiranës, i cili nuk është në hetim dhe kam dëshirë ta dëgjoj nga ata. Zonja Etleva Kondi është përgjegjëse për dhënien e koncesionit të dytë për insineratorin e Elbasanit për lidhjen e energjisë për 25 vjet dhe dua ta pyes për këtë gjë, jo për çështjen që është nën hetim.

Kështu që, gjykoj t'i thërrasim, t'i dëgjojmë dhe nëse gjykoni që pjesa e parë e prezantimit të bëhet pa kamera, ne jemi të hapur ta bëjmë pa kamera, për të ruajtur zotërinjtë, meqë ata janë marrë të pandehur.

Eduard Shalsi – Mund të bëjmë vetëm dy minuta pushim?

Jorida Tabaku – Pse?

Eduard Shalsi – Siç e bëmë herën e parë, për të koordinuar për rastin konkret meqenëse çështja është akoma edhe më delikate dhe pastaj të vijojmë.

Jorida Tabaku – Patjetër. I lutem teknikës, dy minuta pushim dhe pastaj vijojmë!

(Ndërpritet mbledhja)

(Rifillon mbledhja)

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, faleminderit për pjesëmarrjen në këtë mbledhje të gjatë të komisionit hetimor!

Unë e deklaroj të mbyllur mbledhjen e komisionit dhe nesër njoftojmë mbledhjen e radhës për në orën 10:00.

MBYLLET MBLEDHJA